

RAPORTI I ZHVILLIMIT  
NJERËZOR NË SHQIPËRI  
1998



---

**Piktura ne Kopertine:**  
*Gazmend Leka: "Endrra te nje Nate Vere", 1993*  
*"Zogu i Paqes", 1994*  
*me mbeshtetjen e Galerise Kombetare te Arteve*

---

**Korrektimi:**  
*Virgil Muçi, Korrektues i versionit shqip*  
*William Schwab, Korrektues i versionit anglisht*

---

**Perkthyes:**  
*Valbona Bajraktari*

---

**Faqosja dhe shtypi:**  
**ALBDESIGN SH.P.K.**

---

**Copyright:**

*Materiali i ketij raporti nuk eshte objekt per copyright. Megjithate, permendja e autorese te Raportit Kombetar te Zhvillimit njerezor per Shqiperine, 1998, eshte e detyrueshme.*

*Opinionet e shprehura u perkasin autoreve te Raportit dhe nuk reflektojne opinionet e organizates se Kombeve te Bashkuara (UN) apo te Programit per Zhvillim te Kombeve te Bashkuara (UNDP).*

*Raporti Shqiptar i Zhvillimit Njerezor 1998 do te jete se shpejti i disponueshem ne menyre elektronike ne Rrjetin Nderkombetar te Internetit me kete adrese:*  
*<http://www.tirana.al/undp.html>*

*NOTE: Raporti u referohet zhvillimeve ne vend deri ne Maj 1998.*

# **RAPORTI I ZHVILLIMIT NJEREZOR SHQIPERI 1998**

---

*Grupi i eksperteve:*

**Dr. Ylli Çabiri, Kryetar**  
Milva Ekonomi, Piro Misha, Remzi Lani,  
Dr. Vasillaq Leno, Prof. Dr. Ylli Pango

---

---

*Per pjese te vecanta kontribuan:*

---

Prof.Dr.Aleks Luarasi,  
Andrea Stefani,  
Arben Çiço,  
Prof.Arben Puto,  
Dr.Arian Starova,  
Dr.Arjan Gjonçaj,  
Arjana Misha,  
Artan Hoxha,  
Dr. Artur Kasimati,  
Artur Pilkati,  
Besnik Mustafaj,  
Blendi Fevziu,  
Bujar Basha,

Diana Çuli,  
Enkelejda Tahiraj,  
Assist. Prof. Ermelinda Meksi,  
Fabian Schmidt,  
Fatos Lubonja,  
Godiva Rembeci,  
Assist.Prof. Gjergj Sinani,  
Irir Azizi,  
Ismail Kadare,  
Prof.Dr. Ismet Elezi,  
Dr.Lindita Xhillari,  
Lori Jeinkins,  
Dr.Kosta Bajraba,

Assist.Prof. Majlinda Bregu,  
Assist.Prof. Marta Muço  
Mero Baze,  
Prof.Dr. Rexhep Qosja,  
Dr.Stavri Llambiri,  
Dr.Shkelqim Cani,  
Shkelqim Ramadani,  
Assist.Prof. Valentina Zaçe,  
Vojsava Proгри,  
Virgijil Muçi,  
Ylljet Aliçkaj.

---

*Anekset u pregatiten nga:*  
Arjan Mene, Vojsava Proгри

---

*Koordinimi:*  
Vladimir Malkaj  
UNDP

Albi Greva  
UNDP

---

# PERMBAJTJA

---

## PERMBLEDHJE

---

### KAPITULLI I - KONCEPTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR

1.1. Zhvillimi njerëzor: Përzgjedhje apo Rastësi	11
1.2. Treguesi i Zhvillimit Njerëzor	14
<i>Treguesi bazë</i>	14
<i>Treguesi i shpërndarë</i>	14
<i>Treguesi i veçantë</i>	15
<i>Treguesi për Shqipërinë</i>	15
1.3. Raporti i Zhvillimit Njerëzor	16
<i>Temat e Raporteve Globale të Zhvillimit Njerëzor</i>	16

---

### KAPITULLI II - EKONOMIA, RRITJA DHE RENIA

---

2.1. Analiza e Treguesve Makroekonomikë	19
<i>Zhvillimet makroekonomike para krizës</i>	19
<i>Modeli Ekonomik: Një Debat i Hapur</i>	19
<i>Shfaqja e Krizës</i>	21
<i>Bankat - privatizim apo likuidim?</i>	23
<i>Ëndrra e Shkurtër e Piramidave</i>	23
2.2. Financat Shtetërore	26
<i>Defiçiti buxhetor</i>	26
<i>Mbështetja e Sektorëve Sociale</i>	28
<i>Financimi i huaj</i>	29
2.3. Ridimensionimi i Sektorit Publik	31
<i>Privatizimi</i>	31
<i>Privatizim i menjëhershëm apo më parë ristrukturim</i>	34
<i>Ndërmarrjet</i>	35
<i>Gjendja e ndërmarrjeve gjatë vitit 1997</i>	36
<i>Tregu i Punës dhe Papunësia</i>	37

---

### KAPITULLI III - KOHEZIONI SOCIAL

---

3.1. Tablo Sociale e periudhës 1991-1998	39
<i>Ndryshimet demografike</i>	39
<i>Urbanizim apo Mbipopullim</i>	40
<i>Emigracioni masiv</i>	41
<i>Integrimi i emigrantëve shqiptarë</i>	42
<i>Vonesa e emigracionit të kthyer</i>	43
3.2. Marrëdhëniet Sociale Ndërmjet Njerëzve	43
<i>Cilësia e Marrëdhënieve: konfliktuale apo solidarizuese?</i>	44
<i>Një hap prapa : Kthimi i së vjetrës</i>	44
<i>Krimi: Një sfidë e vështirë</i>	45
<i>Droga: në vend të grurit - cannabis</i>	47
<i>Kërcënimet e SIDA-s</i>	48

**3.3. Shtresëzimet e Reja të Shoqërisë Shqiptare 48**

**3.4. Shoqëria Civile 50**

<i>Arsimimi, Mundësia për t'u Edukuar</i>	50
<i>Familja</i>	53
<i>Martesa</i>	54
<i>Divorci</i>	54
<i>Si e Shpenzojnë Kohën Familjet Shqiptare</i>	55
<i>Gruaja : Rruga e mundshme drejt progresit</i>	56
<i>Prostitucioni</i>	57
<i>Shoqëria Civile në një Vend të Armatosur</i>	58
<i>Rinia, Kriza e Besimit për të Ardhmen</i>	60
<i>Arti dhe Kultura: Zhvillime Kontradiktore</i>	62

---

**KAPITULLI IV - TRANZICION I VËSHTIRË**

---

**4.1. Histori e Shkurtër e Shtetit Shqiptar 65**

*Monarki apo Republike?* 66

**4.2. Pluse dhe Minuse te Tranzicionit Politik 66**

**4.3. Shqipëria në Kontekstin Ballkanik 68**

*Demokracia dhe stabiliteti* 68

*Ligji, Zbatimi i tij dhe Kushtetuta* 70

*Partitë dhe Klasat Politike* 71

*Zgjedhjet: Tradita e dy të tretave* 72

*Misioni ALBA* 73

*Të Drejtat e Njeriut* 74

*Media: Mbijetesë e vështirë* 75

*Kriza e Institucioneve: Shpërbërja e Shtetit* 79

*Sfida e Çarmatimit* 80

**4.4. Decentralizimi i Pushtetit Lokal 81**

---

**KAPITULLI V - DEBAT I HAPUR**

*Vendi i Kallashnikoveve. A ekziston Shqipëria Tjetër?* 89

---

**ANEKS - TE DHENA STATISTIKORE**

---

**3.3. Shtresëzimet e Reja të Shoqërisë Shqiptare 48**

**3.4. Shoqëria Civile 50**

<i>Arsimimi, Mundësia për t'u Edukuar</i>	50
<i>Familja</i>	53
<i>Martesa</i>	54
<i>Divorci</i>	54
<i>Si e Shpenzojnë Kohën Familjet Shqiptare</i>	55
<i>Gruaja : Rruga e mundshme drejt progresit</i>	56
<i>Prostitucioni</i>	57
<i>Shoqëria Civile në një Vend të Armatosur</i>	58
<i>Rinia, Kriza e Besimit për të Ardhmen</i>	60
<i>Arti dhe Kultura: Zhvillime Kontradiktore</i>	62

---

**KAPITULLI IV - TRANZICION I VËSHTIRË**

---

**4.1. Histori e Shkurtër e Shtetit Shqiptar 65**

*Monarki apo Republike?* 66

**4.2. Pluse dhe Minuse të Tranzicionit Politik 66**

**4.3. Shqipëria në Kontekstin Ballkanik 68**

*Demokracia dhe stabiliteti* 68

*Ligji, Zbatimi i tij dhe Kushtetuta* 70

*Partitë dhe Klasat Politike* 71

*Zgjedhjet: Tradita e dy të tretave* 72

*Misioni ALBA* 73

*Të Drejtat e Njeriut* 74

*Media: Mbijetesë e vështirë* 75

*Kriza e Institucioneve: Shpërbërja e Shtetit* 79

*Sfida e Çarmatimit* 80

**4.4. Decentralizimi i Pushtetit Lokal 81**

---

**KAPITULLI V - DEBAT I HAPUR**

*Vendi i Kallashnikoveve. A ekziston Shqipëria Tjetër?* 89

---

**ANEKS - TE DHENA STATISTIKORE**

---

# TABELAT

Tabela 1 - Rendiça sipas Treguesit të Zhvillimit Njerezor	15	
Tabela 2 - Ju, apo dikush që ju njihni, a pësuar humbje parash në skemat piramidë?		24
Tabela 3 - Financimi i Deficitit të Shtetit (në % ndaj PBB)	26	
Tabela 4 - Te Ardhurat Buxhetore (në % ndaj PBB)	26	
Tabela 5 - Privatizimi në Vitë sipas Bleresve	35	
Tabela 6 - Të Dhëna Kryesore mbi Ndërmarrjet Private	35	
Tabela 7 - Madhësia e Ndermarrjeve sipas Tipit	36	
Tabela 8 - Treguesit demografikë për periudhën 1990-1996	39	
Tabela 9 - Përdorimi i kohës nga çiftet me dhe pa fëmijë (mosha e bashkëshorteve nga 18-44 vjeç)		56
Tabela 10 - Rezultatet e Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 1996	72	
Tabela 11 - Rezultatet e Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 1997	74	
Tabela 12 - Rezultatet e Zgjedhjeve për Pushtetin Lokal	82	
Tabela 13 - Buxheti për Pushtetin Lokal	83	
Tabela 14 - Ndarja administrative dhe popullsia	84	
Tabela 15 - Popullsia Mesatare Vjetore - (në mijë)	90	
Tabela 16 - Levizja Natyrore e Popullsisë	90	
Tabela 17 - Zgjatja Mesatare e Jetes (në vitë)	91	
Tabela 18 - Popullsia dhe Forcat e Punës - (në mijë)	91	
Tabela 19 - Punësimi	91	
Tabela 20 - Punësimi Gjithsej sipas Klasifikimit NACE	91	
Tabela 21 - Papunesia e Regjistruar, Papunesia Afatgjate dhe Niveli i Papunesisë		92
Tabela 22 - Pagesa e Papunesisë, Paga Minimale Zyrtare dhe Pensionet - (në lekë)		92
Tabela 23 - Ndryshimi Mesatar Vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Pagës në Sektorin Publik - (në %)		92
Tabela 24 - Pensioni Mujor i Pleqerisë - (në lekë)	92	
Tabela 25 - Familjet që Përfitojnë Ndihmë Ekonomike - (në mijë)	92	
Tabela 26 - Familjet që Përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas Prefekturave - (në mijë)		93
Tabela 27 - Evolucionit i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Grupet e tij Kryesore - Rritja vjetore (në %)		93
Tabela 28 - Institucionet e Arsimit	93	
Tabela 29 - Edukatorët, Mesuesit dhe Pedagoget - (në numër)	93	
Tabela 30 - Nxenes dhe Studente të Regjistruar - (në numër)	94	
Tabela 31 - Tregues të Arsimit	94	
Tabela 32 - Produkti i Brendshëm Bruto sipas Degeve Kryesore të Ekonomisë - (Në milion lekë)		94
Tabela 33 - Struktura e Degeve në Krijimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) - (në %)		95
Tabela 34 - Rritja Vjetore e Produktit të Brendshëm Bruto sipas Degeve (në %)		95
Tabela 35 - Bilanci i Buxhetit të Shtetit - (në milion lekë)	95	
Tabela 36 - Bilanci i Pagesave - (në milion USD)	96	
Tabela 37 - Tregues të Sherbimit Spitalor	96	

<i>Tabela 38 - Tregues te Sherbimit Spitalor pa Shtreter</i>	96
<i>Tabela 39 - Tregues te Sherbimit Preventiv</i>	97
<i>Tabela 40 - Kurset e Kembimit te Lekut me Monedhat e Huaja - (Mesatarja e periudhës)</i>	97
<i>Tabela 41 - Bilanci i Energjise Elektrike - (ne milion kwh)</i>	
<i>Tabela 42 - Mjete te Transportit Rrugor</i>	97
<i>Tabela 43 - Transporti Ajror Nderkombetar</i>	97
<i>Tabela 44 - Indeksi i Kostos ne Ndertim (ne %) - Tremujori I, 1993 = 100</i>	98
<i>Tabela 45 - Qarkullimi i Mallrave ne Tregetine e Jashtme - (ne milion leke)</i>	98



# Raporti i zhvillimit njerezor per Shqiperine PERMBLEDHJE

## Kapitulli I Koncepti i Zhvillimit Njerezor

Pas ndryshimeve demokratike të viteve 91-92 Shqipëria u fut më në fund në radhën e vendeve të cilat kanë zgjedhur si qëllim të tyre thelbësor zhvillimin e shoqërisë në funksion të nevojave dhe interesave të njeriut. Në këtë rrugë të re, të gjatë më pak se një dekadë, megjithë arritjet e mëdha në fushën e lirisë e të drejtave të njeriut, nuk ka qënë e mundur të shmanget spontaniteti, gjë që ka sjellë, si rrjedhojë, dëmtimin e zhvillimit njerezor. Kështu, psh, duke vlerësuar tejmasë pikërisht atë që u ka munguar më shumë gjatë viteve 1945-1992, lirinë, shqiptarët kanë cënuar ose pakësuar drejtime të tjera të zhvillimit tyre.

Ndotja e dëmtimi i mjedisit, shkatërrimet e mëdha gjatë vitit 1997, nënvlehtësimi i arësimimit e edukimit e mbivlerësimi i fitimit ekonomik, kanë qënë disa dukuri të një zhvillimi rastësor, spontan, ne dem të vetë interesave të njerëzve. Prandaj është koha që raporti midis elementit spontan e të vetëdijshëm në zhvillimin njerezor të shoqërisë shqiptare të përmirësohet dukshëm. Një Program Kombëtar i Zhvillimit Njerezor do të ishte i domosdoshëm për këtë qëllim.

Aktualisht Treguesi i Zhvillimit Njerezor e radhit Shqipëri në vendin e 105 ndërmyjet 175 vendeve.

## Kapitulli II Ekonomia, Rritja dhe Rënia

Në vitet 1992-1996, ekonomia shqiptare iu nënshtua një politike ekonomike stabilizuese të detyruar nga kriza e thellë e trashëguar nga regjimit i mëparshëm. Ndonëse jo i bazuar në një model tërësisht të përcaktuar në këto vite zhvillimi ekonomik në Shqipëri, pati ndihmën e Fondit Monetar Ndërkombëtar e të Bankës Botërore. Rritja e ndjeshme e prodhimit dhe ulja e stabilizimi i inflacionit ishin dy tregues të rëndësishëm makroekonomikë. Ndryshime pësoi edhe struktura e PBB (rënia e prodhimit industrial e rritja e atij bujqësor) dhe e forcave të punës (emigracioni e papunësia u shfaqën si dukuri të reja).

Këto parametra optimiste deri në mesin e vitit 1996 ia lanë vendin krizës së thellë ekonomike të viteve 1997-1998. Problemet e pazgjidhura të privatizimit e të reformës së sistemit financiar, dukuritë e korrupsionit në shërbimet publike, prapambetja e sistemit bankar, përhapja e dukurisë së investimeve masive të popullit me firma të dyshimta piramidale (FMN e BB evidentuan se popullsia shqiptare humbi rreth 1.2 miliard dollarë amerikanë në firma piramidale) dhe mosreagimi i Qeverisë në kohë e duhur, evazioni fiskal, mangësi të ndryshme institucionale, mungesa e përvojës së njerëzve në problemet financiare (e shoqëruar me psikologjinë e pasurimit të shpejtë) etj., janë disa nga shkaqet e kësaj krize. Megjithatë kjo analizë sapo ka filluar. Karakteristika themelore të krizës u bënë rritja e inflacionit (17-18%) deficieti buxhetor (12% ndaj PBB-se), rënia e rritjes ekonomike (nga 13.3% në 1995, me 7% me 1997) dhe humbja e parave të popullsisë në skemat piramidale. Në gjysmën e dytë të vitit 1997 filloi përsëri puna për ringritjen e ekonomisë, por parashikimet janë ende jooptimiste se ajo do të dalë shpejt nga kriza. Megjithë masat e marra nga qeveria, deficieti buxhetor, papunësia mungesa e investimeve të huaja të nevojshme, evazioni fiskal etj. mbeten pengesa edhe për një kohë të papërcaktuar. Kështu për shembull papunësia gjatë vitit 1998 është rritur mesatarisht 4-5,000 vetë në muaj, dhe është aktualisht një problem social shumë i ndjeshëm. Një nga rrugët e rëndësishme të rigjallërimit të ekonomisë shqiptare është vazhdimi i ristrukturimit të sektorit publik, nëpërmjet privatizimit të ndërmarreve të mëdha strategjike. Përgjithësisht përvoja shqiptare ka tregues se privatizimi i shpejtë, përpara ristrukturimit të ndërmarreve ka qënë rruga më e mirë.

## Kapitulli III Kohezioni Social

Gjatë viteve 1991-1998 në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime të mëdha demografike ku spikatin ritmi negativ i rritjes së popullsisë, migracioni nga fshati në qytet e nga periferia drejt kryeqytetit, emigracioni

masiv dhe ulja e lindjeve. Si rrjedhojë e lëvizjeve të brendshme të popullsisë është krijuar kontraditë midis lirisë së lëvizjes së njerëzve dhe mundësive ekonomike për përballimin e saj. Riurbanizimi e mbipopullimi janë problemet kryesore që ndeshin autoritetet lokale sot në Shqipëri.

Emigracioni i shqiptarëve jashtë vendit ka ritme më të larta se në të gjitha vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore (3 herë më të larta se ritmet mesatare të emigrimit në kohën e sotme).

Emigracioni për shumë arsye vlerësohet si një nga rrugët kryesore për përballimin e jetesës. Pjesa më e madhe e emigrantëve janë vendosur në Greqi e Itali dhe shumica prej tyre janë ilegale. Integrimi i emigrantëve shqiptarë në këto vende është i dobët, për shkak të ndryshime ndër të cilat edhe imazhi i keq i krijuar emocionalisht prej mediave vendase.

Tipare të marrëdhënieve sociale ndërmjet shqiptarëve janë ende konfliktualiteti, dhe agresiviteti. Klima e ashpër e luftës politike, problemet e shumta ende të pazgjidhura plotësisht, mungesa e vetëdijes për shtetin e së drejtës, tradita e zakoneve të vjetra, armatosja masive e popullsisë në vitin 1997, agresiviteti e gjuha e ashpër e shtypit partiak, dobësitë e institucioneve juridike, kanë ndikuar që shoqëria shqiptare të jetë ende larg atij niveli të marrëdhënieve ku mbizotëron mirëkuptimi, prirja për marrëveshje me tjetrin dhe toleranca, besimi te institucionet e ligjit e të drejtësisë.

Shoqëria shqiptare tani njeh një shtresëzim të ri ku dallohen borgjezia e re e pasuruar shpejt, fshatarët, punëtorët, pjesa më e madhe e të cilëve synon drejt emigrimit, nëpunësit, pronarët e tregtarët e vegjël dhe emigrantët. Bie në sy mungesa e një klase të mesme të konsoliduar që do të ishte faktor i stabilitetit social e politik të vendit.

Në Shqipëri ende nuk mund të plotësohen siç duhet nevojat për arësim, jo vetëm për mungesë mjetesh financiare, por edhe për mungesë të një strategjie kombëtare të zhvillimit të arsimit. Një problem serioz janë pagat shumë të ulta të arsimtarëve të të gjitha niveleve, dhe mungesa e informacionit të nevojshëm në dispozicion të tyre. Megjithatë në vitet 90-të u arritën ndryshime pozitive në arsim si: ç'ideologjizmi i edukimit, modernizimi i lëndëve dhe i mënyrës së të mësuarit.

Edhe familja shqiptare i është nënshtruar shumë ndryshimeve ku bie në sy zvogëlimi i numrit të pjesëtarëve dhe rritja e pavarësisë së tyre ndaj njeri tjetrit. Raportet martesë-divorc kanë pësuar ndryshime të pakta ku dallohen rënia e divorceve. Ka lindur një formë e re familjeje: bashkëjetesa pa martesë ligjore. Megjithëse është rritur liria e gruas në

shoqërinë shqiptare, sot vërehet një lloj largimi i saj nga jeta shoqërore e politike, si pasojë e papunësisë ose rëndimit të punës (gjë që vërehet te gratë fshatare). Prostitucioni është një plagë e dhimbshme për femrën dhe shoqërinë shqiptare (në Evropë prostitujnë rreth 30 mijë femra shqiptare).

Ekziston një lëvizje e gruas në Shqipëri e cila shkon drejt masivizimit dhe konsolidimit. Ajo përfshihet në dy grupe kryesore: shoqatat e pavarura të grave dhe grupimet e grave brenda partive politike.

Në Shqipëri ka ende probleme që flasin për ekzistencën e një shoqërie civile ende te pakonsoliduar. Shoqëria shqiptare vuan pasojat e zhdukjes së shpejtë të kolektivizimit të skajshëm të regjimit të mëparshëm komunist, gjë që ka krijuar një dobësim të ndjeshëm të ndjenjës së komunitetit, pa të cilën nuk mund të ketë shoqëri civile, por vetëm shoqëri politike. Sidoqoftë, viti i krizës tregoi se ka embrione të fuqishme të shoqërisë civile shqiptare, të cilat po zhvillohen shumë nën ndikimin e organizatave jo qeveritare (OJQ).

Si vend me popullsi të re në moshë, Shqipëria ndjen më fort probleme të tilla si papunësia e mungesa e mjeteve për shfrytëzimin e hapësirës për inisiativë të lirë. Kjo ka bërë që të vërehen shenjat e një krize besimi të rinisë në të ardhmen.

Arti dhe kultura shqiptare ndodhen përpara sfidash të mëdha. Nga një anë ato kanë mungesa mjetesh, nga ana tjetër është rritur vetëdija e shumë njerëzve se arti dhe kultura kanë rol shumë të rëndësishëm për jetën shpirtërore të shoqërisë. Pavarësisht nga kjo në Shqipëri ka një jetë të pasur artistike kulturore.

## **Kapitulli IV** **Tranzicioni i vështirë**

Historia e shtetit shqiptar fillon që prej shekullit XII. Pas pushtimeve të gjata shekullore, shteti shqiptar rilind në vitin 1912 pas çlirimit nga perandoria osmane. Pas 50 viteve të një regjimi të hekurt të tipit stalinian në vitin 1991 në Shqipëri vendoset pluralizmi politik disi më vonë se sa në vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore.

Periudha e tranzicionit demokratik në Shqipëri ka qënë më e vështirë dhe më e gjatë nga parashikimet. Ngjarjet e vitit 1997 bënë që ky tranzicion të zgjatet më tej. Megjithatë vështirësia e tranzicionit shqiptar lidhet me shumë specifika të Shqipërisë në krahasim me vendet e tjera postkomuniste. Sidoqoftë transformimet politike e ekonomike në Shqipëri kanë hedhur hapa të dukshëm përpara. Shqipëria ka legjislacion të përparuar, sistem të bazuar në ndarjen e pushteteve, shtyp të lirë,

opinion publik aktiv për nevojën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut etj.

Zhvillimi i shoqërisë demokratike shqiptare është i lidhur ngushtë me zhvillimet e stabilitetit e rajonit Ballkanik. Lufta në Bosnje dhe agresioni serb në Kosovë sot, kanë penguar një fluks normal investimesh të huaja në Shqipëri. Përgjithësisht, pa stabilitet në këtë rajon nuk mund të ketë as zhvillim normal e të shpejtë në Shqipëri.

Në vitet 1990-1998 në Shqipëri janë bërë përpjekje të mëdha për zbatimin e ligjit, por ende ka probleme të pavarësisë së sistemit gjyqsor, të korrupsionit, të nivelit juridik të gjykatësve e qytetarëve. Ende nuk është arritur konsensusi për miratimin e Kushtetutës, dhe vendi qeveriset nga një Kushtetutë e përkohshme e miratuar në vitin 1991.

Skema e politikës shqiptare dominohet prej dy partive politike kryesore: Partisë Demokratike e Partisë Socialiste, midis të cilave ka polarizim të dukshëm. Partitë e tjera janë më të vogla e të ndara në dy grupe. Në grupin e parë hyjnë partitë në koalicion me Partinë Socialiste që fitoi në zgjedhjet e fundit parlamentare të Qershorit 1997: Aleanca Demokratike, Partia Socialdemokrate, Partia Agrare dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia e Unitetit Kombëtar. Në grupin tjetër të njohur me emrin "Bashkimi për Demokraci" hyjnë Partia Demokratike, Bashkimi Demokrat, Bashkimi Liberal, Partia Lidhja e Legalitetit dhe Partia Demokristiane.

Karakteristikë e zgjedhjeve shqiptare është lëvizja e madhe elektoratit sa majtas djathtas, gjë që flet për një shoqëri ende të pastabilizuar politikisht.

Viti 1997 ashtu si viti 1991 ishte vit i shpërbërjes së shtetit e institucioneve nepërmjet anarkisë. Kjo dukuri në Shqipëri ndoshta është refleks historik i armiqësisë së shqiptarëve ndaj institucioneve të shteteve pushtuese.

## **Kapitulli V** **Debat i hapur**

Kriza e pranverës 1997 në Shqipëri ka ngjallur komente e arsytetime nga më të ndryshme, debati rreth të cilave vetëm sapo kanë filluar. Ato do të mbeten edhe për një kohë të gjatë në fokusin e interesit të studiuesve e analistëve të problemeve shoqërore. Disa intelektualë shqiptarë e quajne krizen revolucion të vonuar demokratik, të tjere një shpërthim zemërimi të verbër i shkaktuar nga humbja e parave e i përzier me lloj lloj nostalgjisht të vjetra komuniste, të tjere e krahasojnë me puçin e ushtarakëve të goditur prej reformes demokratike. Këto dhe mendime të tjera që ekzistojnë, shërbejnë si pikënisje dhe rxisin një

debat të hapur për këtë krizë.

Cilado qofshin shkaqet e asaj që ndodhin në Shqipëri, përfundimet e disa analistëve që e shohin Shqipërinë vetëm si "vendin e kallashnikovëve", "te boat people" dhe "skemave piramidale", janë dukshëm të nxituara e të gabuara. Përtej krizës së vitit 1997, përtej ndjenjës së mosbesimit të krijuar te vetë shqiptarët, përtej anarkisë e dhunës ekziston Shqipëria tjetër, Shqipëria kulturore, qytetërimi shqiptar i krijuar shekuj më parë e i pa prekur prej perandorive që dëshën ta zhduknin.

# KAPITULLI 1

## KONCEPTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR

### 1.1. Zhvillimi njerëzor: Përzgjedhje apo Rastësi

Për një kohë të gjatë që përshkon shumë shekuj dhe, sidomos, duke u nisur prej fillimeve të Rilindjes Evropiane e zhvillimit të shoqërisë industriale, në filozofi dhe në shkencat shoqërore, me përjashtime të pakta, të gjithë mbronin idenë se rritja ekonomike dhe zhvillimi i shkencës e teknikës do të krijonin automatikisht edhe një zhvillim të përgjithshëm shoqëror e individual. Përballë madhështisë së tempujve të lashtë, ndërtesave të sundimtarëve, kështjellave të mbretërve dhe më vonë, revolucionit industrial e rritjes galopante të pasurisë, inteligjenca njerëzore do të ishte gjithnjë e më pak e aftë të shihte koston njerëzore të këtij zhvillimi, skllavërinë, tjetërsimin dhe degradimin fizik e moral të brezave të panumërt të njerëzimit. Me kohë kjo ide filloi të pësojë erozion deri sa u fut ideja e re, sipas të cilës ndryshimet e shumëllojshme që ndodhin në shoqëri si dhe progresi që realizohet në fushat e ndryshme të saj përbëjnë zhvillim kur mbartin me vete edhe zhvillimin e njeriut, bëhen në emër të njeriut dhe prej vetë njerëzve. **Thelbi i këtij koncepti të ri është se zhvillimi kryhet përreth njeriut, ndërsa sipas konceptit të vjetër, njeriu vërtitej rreth zhvillimit.** Koncepti i ri (relativisht i ri sepse në formën e përjashtimeve të lartpërmendura, ai është shfaqur më parë te filozofët e lashtësisë) njihet sot si **koncepti i zhvillimit njerëzor**.

Koncepti i ri i zhvillimit njerëzor u paraqit nga UNDP në Raportin Global të Zhvillimit njerëzor, i cili u botua për herë të parë në vitin 1990. Ky koncept është fokusuar në punimet e disa konferencave ndërkombëtare të viteve të fundit, si në

Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillim, në Rio 1992, në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut, në Vjenë, në vitin 1993, në Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë e Zhvillimin, në Kajro, në vitin 1994 dhe në Samitin Botëror për Zhvillimin Social, në Kopenhagen, në vitin 1995. Në deklaratën e Samitit të Kopenhagës bëhet thirrje për ta vënë njeriun në qendër të zhvillimit, për të siguruar barazi mundësish midis brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm, si dhe për përdorim të kujdesshëm të mjedisit.

Koncepti i zhvillimit njerëzor duket i vështirë për t'u mbërthyer në kornizat e një përkufizimi klasik logjik sepse ai asnjëherë nuk mund të shpjegohet në mënyrë të plotë. Ndaj dhe synohet që zhvillimi njerëzor të shqyrtohet nëpërmjet analizës së aspekteve të ndryshme të tij ose nëpërmjet treguesve të tij.

**Zhvillimi njerëzor paraqet dy aspekte thelbësore: aftësinë për zhvillim dhe mundësinë për ta realizuar atë.** Përderisa thelbi i zhvillimit njerëzor nënkupton zhvillimin e njeriut në emër të njeriut dhe prej vetë njeriut, atëherë doemos do të shtrohen pyetjet: Ç'afësi ka njeriu për zhvillimin e vetvetes? Ç'mundësi ka ai për t'u vetëzhvilluar? Nuk mund të ketë zhvillim njerëzor nëse njerëzit do të kishin aftësi, por jo mundësi ose anasjelltas, do të kishin mundësi por jo aftësi. Çfarë zhvillimi mund të pritet për një njeri, i cili do të ishte i talentuar në një fushë, i shkolluar, aktiv, por i papunë dhe pa kurrëfarë tjetër pasurie? E njëjta gjë mund të vihej në dyshim për një njeri që ka mundësi ekonomike, ligjore, familjare, por është i pashkolluar. Hamendjet e lartpërmendura nuk nënkuptojnë mohimin e plotë të zhvillimit njerëzor, por tregojnë se ndërmjet aftësive dhe mundësive duhet

*Zhvillimi njerëzor paraqet dy aspekte thelbësore: aftësinë për zhvillim dhe mundësinë për ta realizuar atë.*

*Zhvillimi  
njerëzor kërkon  
që çdo individ të  
ketë mundësi të  
barabarta  
zgjedhjeje me të  
tjerët.*

të ekzistojë një raport i ekuilibruar dhe se mungesa e këtij ekuilibri nuk mund të mos dëmtojë zhvillimin njerëzor.

Historia e njerëzimit ka vënë në dukje një numër të madh parametrash ose treguesish të aftësisë dhe mundësisë së zhvillimit brenda një shoqërie, të cilët duhen marrë në lidhje të ngushtë e të ndërvarur me njëri - tjetrin. Midis tyre mund të veçohen disa tregues:

**Liria e njeriut** është një element tepër i rëndësishëm i zhvillimit njerëzor. Zgjerimi i saj ka të bëjë drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mundësive të njerëzve për zhvillimin e tyre, me zgjerimin e mundësive të përzgjedhjeve që bëjnë njerëzit gjatë veprimtarisë që kryejnë për vetveten. Liria nënkupton lirinë e ndërjegjes, të shprehjes dhe të veprimit.

**Barazia.** Zhvillimi njerëzor kërkon që çdo individ të ketë mundësi të barabarta zgjedhjeje me të tjerët. Aspekte mjaft domethënëse të barazisë janë barazia ndërmjet burrave e grave, si dhe barazia midis brezave të tanishëm e të ardhshëm, ku ende mbetet shumë për t'u bërë. Realizimi i barazisë së shanseve kushtëzohet me një politikë të veçantë sociale prej shteteve për të ndihmuar shtresat me mundësi më të pakta.

**Rritja ekonomike** është kusht themelor i zhvillimit njerëzor, sikundër edhe ky është kusht për rritjen ekonomike. Një prej detyrave kryesore që i vënë vetes shtetet pjesëmarrëse në Samitin e Kopenhagës ishte çrrënjësia e varfërisë, që ende është shumë e lartë në botë. **Pa siguruar jetesën materiale, mirëqenien fizike të njeriut nuk mund të flitet për lloje të tjera veprimtarish.**

**Edukimi dhe informimi** janë treguesit që lidhen më ngushtë me aftësitë e njerëzve për t'u zhvilluar e për të vepruar. Dija e bën më të organizuar dhe aktive jetën e njeriut, kurse zgjedhjet e tij më të lira, të vullnetshme e spontane.

**Mjedisi e Shëndeti.** Sot në botë po flitet përherë e më shumë për krizë ekologjike, megjithë përpjekjet që janë bërë e bëhen për ta kapërcyer atë. Ky shqetësim global për mjedisin lidhet me rolin që ai ka për bazën e ekzistencës së vetë njeriut e shoqërisë njerëzore. Prandaj për të ruajtur këtë bazë të jetës njerëzore e për të siguruar zhvillimin njerëzor,

mjedisi duhet mbrojtur prej të gjitha veprimtarive që prishin drejtpeshimin natyrë - mjedis - njeri. Faktor kryesor në prishjen e drejtpeshimit mjedis - njeri është veprimtaria ekonomike, e cila për këtë arsye duhet t'i nënshtrohet parimeve të shkencës ekologjike. Ndotja e mjedisit lidhet edhe me dëmtimin e shëndetit të njeriut, i cili është padyshim baza e ekzistencës njerëzore. Zhvillimi njerëzor kërkon krijimin e kushteve që mjedisi e shëndeti të mbrohen prej shoqërisë.

**Familja** është njohur në Samitin e Kopenhagës si njësi themelore e shoqërisë, e cila luan rol kyç në zhvillimin njerëzor e shoqëror. Si e tillë ajo duhet forcuar. Qëndrueshmëria e saj kërkon përkrahjen shumëformëshe të shtetit.

**Qëndrueshmëria** e zhvillimit njerëzor përcaktohet si ruajtje për brezat e ardhshëm të nivelit të arritur e të zgjerimit të shanseve për brezin e tanishëm. Këtu duhen futur ruajtja e institucioneve, e vlerave kulturore, shoqërore dhe politike.

**Pjesëmarrja** në veprimtaritë e ndryshme shoqërore përbën një faktor të rëndësishëm për zhvillimin njerëzor. Veprimtaritë politike, kulturore, ekonomike, edukative fetare etj., e vendosin njeriun në rolin e realizuesit të zhvillimit të vetvetes, prandaj sa më e gjerë dhe racionale të jetë pjesëmarrja aq më shumë zhvillohet njeriu në vetvete.

Duke trajtuar këta tregues mund të themi se zhvillimi njerëzor është pjesërisht produkt i përzgjedhjeve të njerëzve, pjesërisht produkt i rastësisë. Sa më shumë i studion shoqëria treguesit e zhvillimit njerëzor, sa më shumë eksploron hapësira të reja në to, aq më shumë rriten mundësitë e përzgjedhjeve nëse veprohet në bazë të këtyre treguesve. Megjithatë, përderisa koncepti i zhvillimit njerëzor, si njohje në tërësi, nuk mund të eksplorohej deri në fund, përderisa jo të tërë njerëzit ndodhen në të njëjtat kushte kundrejt mundësive të përzgjedhjes, përderisa edhe çdo njohje (pra edhe treguesit aktualë të lartpërmendur) është relative për nga saktësia, atëherë zhvillimi njerëzor real është edhe produkt i rastësisë.

Pavarësisht nga ky konkluzion, dija e grumbulluar për zhvillimin njerëzor, fryt i shumë mendjeve të shquara, sado e papërsosur qoftë, mund dhe duhet të

shërbejë si orientim për veprim, përballë problemeve të shumta e të ndërlikuara të shoqërisë së sotme.

Zhvillimi i shoqërisë shqiptare në mënyrë të natyrshme është produkt i këtij bashkëveprimi të elementëve spontanë e të vetëdijshëm, si kur gjykohet në përgjithësi për periudhën 1991-1998, pas transformimeve thelbësore politike, ekonomike dhe shoqërore, ashtu edhe kur gjykohet në veçanti për zhvillimin njerëzor gjatë vitit 1997. Prandaj po kaq natyrshëm shtrohet edhe pyetja se, në ç'raport janë përzgjedhja dhe rastësia në zhvillimin njerëzor shqiptar gjatë këtyre viteve dhe ç'aspekte të veçanta spikatin në të?

Shqipëria mbërriti në këto transformime pas një periudhe të gjatë izolimi brenda një sistemi veçanërisht totalitar, ku njeriu ishte vetëm një fasadë e zhvillimit. Megjithatë në këtë sistem në dukje gjithçka ishte thellësisht e planifikuar nga njerëzit dhe për njerëzit, zhvillimi ishte plotësisht spontan dhe mundësitë për ta realizuar ishin tejet të kufizuara. Modeli i shtetit demokratik perëndimor që filloi të ndërtohet në Shqipëri, ashtu si në të gjithë vendet ish-komuniste të Evropës Qendrore e Lindore, synoi të vendosë realisht në qendër njeriun. Në Shqipëri, përzgjedhja, dmth elementi i vetëdijshëm, mori përparësi ndaj rastësisë apo elementit spontan. Kjo përcaktohet, midis të tjerash, të paktën nga dy argumente veçanërisht të dukshëm:

*I pari* lidhet me faktin se Shqiptarët e zgjedhën me vetëdije të plotë shtetin demokratik që kanë sot dhe janë të ndërgjegjshëm e shprehin vendosmëri për zhvillimin e tij, pra të tipit të shtetit që synon zhvillimin njerëzor.

*I dyti* lidhet me bindjen dhe vetëdijen e dukshme të shqiptarëve se shtetin demokratik do ta ndërtojnë e përsosin jo të vetmuar, por në bashkëpunim të afërt me vendet e përparuara demokratike, ndaj edhe nëpërmjet këtij bashkëpunimi, ata do të jenë të integruar në përzgjedhjen e tyre, pra do të jenë përgjithësisht po aq fort të vetëdijshëm e po aq pak spontanë e të rastësishëm, sa ç'është edhe ky grupim i madh shtetesh demokratike.

Megjithatë, në realitet, shmangiet nga këto argumente për një zhvillim të përzgjedhur njerëzor duket se nuk do të

jenë të rralla për rastin e Shqipërisë, çka mund të përfaqësojë edhe një dukuri të veçantë për zhvillimin njerëzor në Shqipëri. Kështu, **ndër parametrat e mundësive të zhvillimit njerëzor si liria, barazia, rritja ekonomike, edukimi e informimi, mjedisi e shëndeti, familja, qëndrueshmëria etj., shqiptarët vlerësojnë sidomos lirinë, pikërisht atë që u ka munguar për më shumë se gjysmë shekulli nën regjimin totalitar.** Madje në emër të saj shpesh herë kanë cënuar ose pakësuar mundësitë e tjera. Në ngjarjet tragjike të gjysmës së parë të vitit 1997 në emër të lirisë së veprimit e të iniciativës individuale u godit rritja ekonomike dhe qëndrueshmëria. Shkatërrimet, vjedhjet e shpërdorimet e përmasave të mëdha bënë që të tejkalohet liria e brezit të sotëm në dëm të brezit të kaluar, i cili kishte dhënë ndihmesën e vet në ndërtimin e atyre që u shkatërruan e u shpërdoruan, si edhe të brezit të ardhshëm, i cili ka të drejtë të gëzojë çdo arritje të brezit paraardhës.

Gjithashtu, në emër të lirisë në Shqipëri filloi të shpërfilltet skajshëm mjedisi, ndaj dhe shkatërrimi i mjedisit e ndotja e tij është kthyer në një problem tejet shqetësues. Ai shfaqet në forma të ndryshme: ndërtime pa respektuar asnjë kriter urbanistik dhe pa leje nga shteti, prishje e parqeve, dëmtime masive të pyjeve, ndotje të ujrave të lumenjve etj., por e përbashkëta e këtyre formave është se ato të gjitha mbështeten në mendësinë se kjo është pjesë e iniciativës së lirë, si edhe një mënyrë që njerëzit të përfitojnë diçka nga ajo që u është marrë për 50 vjet. Këtu nuk bëhet fjalë për raste të veçanta, por për një mentalitet masiv, i cili, përballë pafuqisë ose pamundësisë së shtetit për ta ndaluar, po shndërrohet në një dukuri spontane, që shoqëron zhvillimin njerëzor shqiptar në këtë periudhë tranzicioni.

Një aspekt tjetër i ndërveprimit të përzgjedhjes dhe rastësisë është shpërpjesëtimi ndërmjet rritjes ekonomike dhe edukimit e informimit të njerëzve. Është e kuptueshme që në rastin e Shqipërisë gjetja e zgjedhjeve individuale ekonomike për të siguruar jetesën përfaqëson një përzgjedhje parësore dhe një shqetësim absolut. Por, kjo mendësi po e kapërcen individin dhe në mënyrë

*Shqiptarët vlerësojnë sidomos lirinë, pikërisht atë që u ka munguar për më shumë se gjysmë shekulli nën regjimin totalitar.*

***Treguesi i  
Zhvillimit  
Njerëzor ofron  
një alternativë  
për matjen e  
progresit relativ  
shoqëror dhe  
ekonomik të një  
vendi, i cili ka  
prirje të matet  
vetëm me anë të  
Prodhimit të  
Brendshëm Brut  
(PBB).  
Treguesi është  
një sintezë e tri  
komponentëve  
bazë të zhvillimit  
njerëzor:  
jetëgjatësisë,  
diturisë dhe  
standartit të  
jetesës.***

graduale e të padukshme po shndërrohet në një dukuri me përmasa shqetësuese për gjithë shoqërinë shqiptare. Thëksi vihet në mënyrë spontane të rritja ekonomike, e cila duke mos ecur si duhet, bën që të forcohet edhe më tej ky spontanitet. Ndërsa edukimi e informimi, dy faktorë tepër të rëndësishëm të zhvillimit, kanë filluar të lihen disi mënjanë dhe, nëpërmjet mungesës së debatit shoqëror e politik dhe peshës së vogël në buxhetin e shtetit, gati - gati mendohet se nuk është dhe aq e nevojshme që të përfshihen politika të posaçme për edukimin dhe informimin sepse rritja ekonomike sjell vetiu rritjen e interesit për dije dhe informim. Në mënyrë të pashmangshme pasojat e kësaj mënyre spontane zhvillimi do t'i ndjejnë brezat e ardhshëm.

Parametrat e zhvillimit njerëzor nuk mund të jenë njëlloj të fokusuar në politikën e zhvillimit që ndjek një shtet. Prandaj edhe thekset do të vihen, ku më shumë ku më pak, te njeri apo tjetri parametër. Ajo që ka rëndësi është shmangia sa më shumë e rastësisë, pra përzgjedhja e parametrave, duke u bazuar në vetëdijen e krijuar prej studimit të nevojave të zhvillimit të vendit. Në bazë të kësaj mendësie, edukimi dhe informimi duhet të jenë elementë parësorë të zhvillimit njerëzor shqiptar, sado që gjendja ekonomike imponon shtrëngesa, si në nivelin e të ardhurave të familjes, ashtu edhe në nivelin e buxhetit të shtetit dhe e shtyn drejt kursimit. Ajo çka investohet në edukim vërtet 'nuk duket', është afatgjatë, nuk sjell menjëherë 'dobi ekonomike', por nuk duhet harruar se 'qytetarët e këqinj' të sotëm në një masë të madhe janë edhe "fëmijët e keqedukuar të djeshëm".

Një hap i rëndësishëm për të përmirësuar raportin midis përzgjedhjes dhe rastësisë në zhvillimin njerëzor shqiptar do të ishte hartimi i një Programi Kombëtar të Zhvillimit Njerëzor, ku të përfshihet një vizion sa më afatgjatë i nevojave dhe masave për një zhvillim të vetëdijshëm njerëzor për vitet që vijnë. Ky do të krijonte mundësi për një përzgjedhje universale, që i tejkalon interesat e tanishme të një brezi dhe për më tepër ngrihet mbi debatet e përditshme politike, të cilat, nga ana e tyre

do të mund të përmirësonin mënyrën e zbatimit të kësaj strategjie kombëtare zhvillimi dhe efektshmërinë e asaj që do të zbatohet.

## **1.2. Treguesi i Zhvillimit Njerëzor**

### ***Treguesi bazë***

Treguesi i Zhvillimit Njerëzor ofron një alternativë për matjen e progresit relativ shoqëror dhe ekonomik të një vendi, i cili ka prirje të matet vetëm me anë të Prodhimit të Brendshëm Brut (PBB). Ai nisët nga koncepti se matja e zhvillimit njerëzor vetëm nëpërmjet vlerës së PBB, i cili është një tregues makroekonomik, nuk përfaqëson sa duhet kompleksin e faktorëve socialë që ndikojnë dhe e pasqyrojnë këtë zhvillim. Prandaj është ndërtuar ky tregues i ri, i cili bën të mundur të gjendet një masë e përbashkët për realitetet e ndryshme shoqërore dhe ekonomike. Kjo krijon mundësi të bëhen krahasime të vlefshme të përvojave të vendeve të ndryshme në zhvillimin njerëzor.

Treguesi është një sintezë e tri komponentëve bazë të zhvillimit njerëzor: jetëgjatësisë, diturisë dhe standartit të jetesës. Dallimi midis vlerës minimale dhe maksimale të këtij Treguesi është 1 dhe, sa më afër vlerës 1 të jetë ky Tregues, aq më i madh është edhe progresi i arritur nga një vend në zhvillimin njerëzor.

Marrja në konsideratë vetëm e tri komponentëve lidhet thjesht me vështirësinë e sigurimit të të dhënave statistikore për aspekte të tjera të zhvillimit shoqëror. Ky kufizim është edhe objekt i kërkimeve të mëtejshme që bëhen për të përqasur më shumë vlerën e Treguesit me realitetin e një vendi. Deri më sot këto kërkime kanë dhënë rezultate të kënaqshme për llogaritje me komplekse që kanë për bazë ndarjen në grupe brenda një vendi ose specifikat e zhvillimit të një vendi të caktuar.

### ***Treguesi i shpërndarë***

Një tregues i përgjithshëm për një vend, i llogaritur me parimet dhe metodat e

mësipërme, mund të fshehë faktin që brenda vendit grupe të ndryshme njerëzish kanë nivele të ndryshme zhvillimi. Prej këtej ka dalë nevoja e llogaritjes së treguesve të shpërndarë, duke përdorur të dhënat që i përkojnë secilit prej grupeve dhe duke e trajtuar çdo grup si të ishte një vend i veçantë. Në ndarjen në grupe mund të merren në konsideratë ndarjet administrative-gjeografike, rurale-urbane, gjinia, etniciteti.

Përdorimi i treguesit të shpërndarë ndihmon për të nxjerrë në pah pabarazitë e dukshme ndërmjet rajoneve, sekseve, zonave rurale dhe atyre urbane, si edhe ndërmjet grupeve etnike. Edhe pse pabarazitë midis grupeve mund të jenë të njohura, vënia e tyre në dukje nëpërmjet një treguesi shkakton në mënyrë të

pashmangshme debate teknike, politike dhe sociale. Në këtë mënyrë ndikohet në orientimin e politikave dhe aksioneve konkrete drejt zvogëlimit të pabarazive të identifikuar. Ky mund të ishte një nxitës i mirë për ristrukturimin e shpenzimeve publike në dobi të grupeve më pak të favorizuar, treguesi i të cilëve rezulton me vlerë më të vogël.

### *Treguesi i veçantë*

Çdo vend karakterizohet edhe nga veçoritë dhe përparësitë e tij të zhvillimit njerëzor. Marrja e tyre në konsideratë nëpërmjet shtesës së komponentëve përkatës në llogaritjen e treguesit të zhvillimit njerëzor, do ta pasqyronte zhvillimin e vendit më realisht se treguesi

### **Treguesi për Shqipërinë**

Në rastin e Shqipërisë, në shumicën e raporteve që merren me analiza të zhvillimit janë përdorur si tregues bazë për nivelin e zhvillimit të vendit të ardhurat për frymë. Ndërsa Treguesi i Zhvillimit Njerëzor nuk është llogaritur për mungesë të të dhënave të plota e të nevojshme statistikore dhe se ende nuk është institucionalizuar nevoja e përshtatjes të kësaj metodike llogaritjeje, e cila do të çonte në mbledhjen sistematike të të dhënave dhe llogaritjen e publikimin periodik të Treguesit. Një përpjekje për llogaritjen e këtij Treguesi është bërë nga UNDP në Raportin Global të Zhvillimit Njerëzor të vitit 1998 me metoda jo të drejtpërdrejta, duke u mbështetur në të dhëna statistikore të vitit 1995, të publikuara nga institucione të ndryshme ndërkombëtare. Sipas kësaj llogaritjeje, Treguesi rezulton të ketë vlerën 0.656 dhe e rendit Shqipërinë në rendin e 105 midis 175 vendeve.

*Tabela 1 - Renditja sipas Treguesit të Zhvillimit Njerëzor*

101	MONGOLI
102	UKRAINE
103	TURKMENISTAN
104	UZBEKISTAN
<b>105</b>	<b>SHQIPERI</b>
106	KINE
107	NAMIBI
108	GJEOGJI
109	KIRGISTAN



**Raportet  
Kombëtare të  
Zhvillimit  
Njerëzor kanë  
filluar të  
publikohen në  
vitin 1990 dhe  
sot në këtë  
nismë janë  
përfshirë mbi 80  
vende.**

i llogaritur në bazë të tri komponentëve të paraqitur më sipër. Prandaj çdo vend përzgjedh komponentë shtesë ose e rrit numrin e variabëlve në komponentët bazë. Nëpërmjet kësaj metode mund të bëhet e mundur të monitorohen edhe ndryshimet afatshkurtëra të zhvillimit njerëzor, të cilat është vështirë të dalin në pah vetëm nëpërmjet komponentëve të tillë si jetëgjatësia dhe arsimimi, që ndryshojnë ngadalë.

### 1.3. Raporti i Zhvillimit Njerëzor

Raportet Kombëtare të Zhvillimit Njerëzor kanë filluar të publikohen në vitin 1990 dhe sot në këtë nismë janë përfshirë mbi 80 vende. Në bazë të tyre janë përgatitur nga UNDP Raporte Globale të Zhvillimit Njerëzor. Për çdo vit Raportet kanë pasur një tematikë të përcaktuar dhe një mesazh të zgjedhur për t'i komunikuar

publikut. Të tetë Raportet e publikuara deri më sot kanë ushtruar ndikimin e tyre ndaj çështjeve të zhvillimit global dhe kanë nxitur dialogun e debatin për problemet më themelore që shqetësojnë zhvillimin njerëzor, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, duke dhënë edhe rezultate të drejtpërdrejta në përshtatjen e politikave më të drejta e më të qëndrueshme, si dhe në riorientimin e shpërndarjes së burimeve financiare. Ato kanë shërbyer, gjithashtu, si një mjet i rëndësishëm nxitës dhe ndihmues për institucionet e shoqërisë civile, përfshirë Organizatat Jo Qeveritare, por edhe si referenca për institucione akademike dhe shkencore.

Në Shqipëri janë botuar dy Raporte të Zhvillimit Njerëzor Kombëtar për vitin 1995 dhe 1996. Raporti i vitit 1997 nuk u përgatit për shkak të ngjarjeve politike të atij viti.

Raporti i vitit 1995 përmban informacione praktike për ata që merren me planifikimin e zhvillimit, me hartimin e politikave dhe me analiza të sektorëve që lidhen me zhvillimin njerëzor në

### Temat e Raporteve Globale të Zhvillimit Njerëzor

Prej publikimit të parë në vitin 1990, Raportet janë fokusuar çdo vit në tema të ndryshme dhe kanë dhënë mesazhe të ndryshme.

Tema e Raportit të vitit 1990 ishte **konceptimi dhe matja e zhvillimit njerëzor**. Raporti përcaktonte konceptin e zhvillimit njerëzor, fusi Treguesin e Zhvillimit Njerëzor si një mase të tij, si dhe ofroi një numër treguesish të zhvillimit njerëzor.

**Financimi i zhvillimit njerëzor** ishte tema e Raportit të vitit 1991. Çështja kryesore e ngritur është se mungesa e dëshirës politike dhe jo pamundshëria e burimeve është pengesa më e madhe për zhvillimin njerëzor. Raporti përvijoi rrugët se si mund të rristrukturoheshin buxhetet kombëtare e ndihmat dhe për të caktuar më tepër burime financiare për zhvillimin njerëzor.

Raporti i vitit 1992 u fokusua në **dimensionin ndërkombëtar të zhvillimit njerëzor**. Raporti arriti në përfundimin se, në rast se bota e industrializuar nuk hap dyert e saj për tregti me vendet në zhvillim, si dhe për transferimin e kapitaleve dhe migracionin, pabarazia ndërkombëtare do të rritet dhe zhvillimi njerëzor nuk mund të bëhet i mundur.

**Pjesëmarrja e njerëzve** ishte tema e Raportit të vitit 1993. Raporti tregoi se si rritja e papunësisë e pengon pjesëmarrjen e vetë njerëzve në zhvillimin njerëzor. Ai gjithashtu analizoji rëndësinë e një qeverisjeje të decentralizuar dhe rolin e institucioneve të shoqërisë civile, sidomos të OJQ-ve.

Eshtë siguria e njerëzve dhe jo siguria e territoreve aspekti më i rëndësishëm për zhvillimin njerëzor. Ky ishte mesazhi i Raportit të vitit 1994, tema e të cilit ishte **siguria njerëzore**. Raporti u përpoq gjithashtu të identifikojë dividendin e paqes prej uljes së shpenzimeve ushtarake dhe se si mund të përdoret për forcimin e zhvillimit njerëzor.

Mesazhi kryesor i dhënë në Raportin e vitit 1995 ishte se zhvillimi është në rrezik në qoftë se nuk bëhet njerëzsh për të dyja gjinitë. Raporti me temë kryesore **gjinitë dhe zhvillimi njerëzor**, konkludoi që ishte arritur progres në krijimin e afësive, por jo të mundësive të grave.

Tema e Raportit të vitit 1996 ishte rritja ekonomike për zhvillimin njerëzor. Ai theksoi, në rast se rritja nuk administrohet si duhet, ajo mund të çojë në humbje të vendeve të punës në vend të hapjes së tyre, ajo mund të jetë e ashpër në vend që të zbusë varfërinë dhe e pandjeshme në vend që të jetë gjithëpërfshirëse. Raporti arriti në përfundimin se nuk ka lidhje automatike ndërmjet rritjes ekonomike dhe zhvillimit njerëzor, dhe kjo lidhje mund të arrihet vetëm nëpërmjet drejtimit të kujdesshëm të politikave.

**Varfëria njerëzore** është tema e raportit të vitit 1997. Raporti nënvizon faktin se varfëria është shumë dimensionale dhe varfëria njerëzore është më e madhe se varfëria e të ardhurave. Raporti bëri një vështrim mbi dinamikën e varfërisë dhe shqyrton fytyrën e ndryshueshme të varfërisë. Ai gjithashtu ofroi edhe një plan për çrënjësjet e varfërisë në shekullin e 21.

Shqipëri. Ky Raport jep dhe argumenton mesazhe pragmatike e optimiste, si tranzicioni drejt demokracisë në Shqipëri nuk ka kushte për kthim mbrapa, se faza e emergjencës është kapërcyer dhe vendi është futur në fazën e zhvillimit, dhe se konceptet e mentaliteti i së shkuarës vazhdojnë të ndikojnë dukshëm ndaj nivelit të arritjeve në të gjitha fushat.

Raporti i vitit 1996 thekson se populli është vënë në qendër të procesit të transformimit të shpejtë politik, ekonomik e social të mjedisit shqiptar dhe se arritjet në këtë proces kanë mundur të zbutin disi pasojat negative të transformimit. Megjithatë, elementë thelbësorë që sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm njerëzor, si zbutja e varfërisë, krijimi i vendeve të punës dhe përmirësimi i nivelit të jetesës, janë llogaritur si përparësi të ngutshme, që kërkojnë hartimin e programeve dhe zbatimin e tyre të shpejtë.

# KAPITULLI 2 EKONOMIA. RITJA DHE RENIA

## 2.1. Analiza e Treguesve Makroekonomikë

### *Zhvillimet makroekonomike para krizës*

Rezultatet në rritjen e PBB-se, në uljen e inflacionit dhe në vendosjen e kontrollit ndaj deficitit buxhetor në Shqipëri, pas aplikimit të programit të stabilizimit, deri në vitin 1996 ishin pozitive. Ato u konsideruan një përvojë e suksesshme edhe nga studiuesit dhe institucionet

financiare ndërkombëtare. Politika të mirëfillta të stabilizimit makroekonomik në kuadrin e një programi më të plotë e koherent filluan në Shqipëri veçanërisht mbas mesit të vitit 1992. Përpjekjet e para, deri në mes të vitit 1993, u përkushtuan më së shumti stabilizimit të situatës emergjente makroekonomike. Programi ekonomik afat-mesëm 1993-96, pati një natyrë mjaft të qartë stabilizuese. Në Shqipëri ky program u imponua për arsye të krizës së thellë të trashëguar nga sistemi i mëparshëm.

*Rezultatet në rritjen e PBB-se, në uljen e inflacionit dhe në vendosjen e kontrollit ndaj deficitit buxhetor në Shqipëri, pas aplikimit të programit të stabilizimit, deri në vitin 1996 ishin pozitive. Ato u konsideruan një përvojë e suksesshme edhe nga studiuesit dhe institucionet financiare ndërkombëtare.*

### *Modeli Ekonomik: Një Debat i Hapur*

A ka pasur një model të përcaktuar të zhvillimit ekonomik në Shqipëri gjatë tranzicionit?

Shqipëria ishte nga vendet e fundit që hyri në rrugën e shndërrimeve ekonomike. Megjithatë diskutimet teorike të ekonomistëve të vendeve në tranzicion, por edhe të mbarrë hotës, ajo çka u ofrua këtyre vendeve si model teorik zhvillimi për të realizuar kalimin historik dhe unik të ekonomive të centralizuara në ekonomi tregu ishte gjithësi një eksperiment. Megjithatë, strategjitë e shpallura u përkisnin modeleve të ndryshme teorike të zhvillimit kapitalist, nga ekonomitë liberale në ato të rregulluara e sociale.

Për të u shkrua e u diskutua gjërësisht sidomos në vitet e para të reformave. Diskutimi më i madh teorik përfshinte fillimisht jo vetëm përmbajtjen, por edhe shpejtësinë dhe sekuençat e këtyre ndryshimeve. Megjithatë diversitetin e mendimeve, në funksion të kushteve fillestare, traditës dhe trashëgimisë ekonomike e politike, si dhe rezultateve të para, secili nga vendet e tranzicionit përcaktoi gradualisht rrugën, strategjitë dhe taktikat e modelit që ai parapëlqente të zbatonte. Disa herë këto modele u përshatën e disa herë ato u qëndruan besnik ideve fillestare.

Sigurisht që reformistët më të përparuar patën edhe ide e praktika më të qarta në përcaktimin e modeleve të zhvillimit, pavarësisht nga problemet ekonomike korrente ose të cilat ata u ndeshën. Për fat të keq, në këtë proces, Shqipëria nuk qëndroi në pararojë. Kjo për shumë arsye. Kushtet e vështira fillestare të reformës përcaktuan masa të kushtëzuara ekonomike. Ajo çka u trashëguar në fushën ekonomike dhe institucionale ishte e papërfillshme dhe më së shumti pengesë për ndryshimet e pritshme. Tradita e diskutimeve teorike në fushën e politikave ekonomike nuk ofronte shumë opsione të vlefshme në kushtet kur mendimi ekonomik, tradicionalisht ose nuk ishte përfillur ndonjëherë, ose ishte ndryshuar totalisht. Eksperiencat në përcaktimin e strategjive dhe modeleve të zhvillimit ekonomik kapitalist ishin mjaft e vogël, si pasojë e mbylljes së shkajshme 50 vjeçare. Të gjitha këto, si dhe mungesa e kulturës politike demokratike bëri që debati lidhur me përcaktimin e një modeli të përshatshëm zhvillimi që Shqipëria do të duhej të ndiqte në rrugën e transformimeve, pothuajse të mungonte.


Edhe pse me ndihmën e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore janë miratuar programe afatshkurtra e afatmesme zhvillimi, përsëri debati se cilin model të zhvillimit ekonomik po përpiqemi të zbatojmë në afatin e gjatë, mbetet i hapur. Sigurisht që kjo mungesë pengon qartësinë e veprimeve në afatin e shkurtër, shpesh duke shkaktuar ndryshime e orientime të reja në funksion të interesave ekonomike të castit e, sidomos, në funksion të rritjes së kredibilitetit publik dhe legjitimitetit të forcave të ndryshme politike.

Figura 1 - Rritja Vjetore e PBB-se ne %




Burimi: INSTAT

Figura 2 - Inflacioni sipas viteve



Burimi: INSTAT

Figura 3 - Deficiti i Buxhetit të Shtetit dhe PBB-ja (ne mln leke)



Burimi: INSTAT

Rezultatet e para të një programi të tillë u shfaqën te përmirësimi i treguesve makroekonomikë. Prodhimi pati një rritje të ndjeshme: rritja e tij vjetore nga - 28% në vitin 1991 arriti në 13.3% në vitin 1995. Po kështu, inflacioni u ul nga 226% në vitin 1992 në 7.8% në vitin 1995.

Karakteristikë e fillimit të stabilizimit në vitin 1992, i cili nga të dhënat duket se vazhdoi të mbizotëronte deri në vitin 1995, është se u mbështet në kontrollin e stabilitetit të çmimeve, duke përdorur shtrëngimin monetar, fiskal dhe të kreditit, por më së shumti, nëpërmjet stabilizimit të shpenzimeve buxhetore, uljes së ritmeve të rritjes së tyre dhe kontrollit rigoroz të

drejtëpërdrejtë të kredisë për ekonominë nga Banka e Shqipërisë.

Një ristrukturim tepër ambicioz i ekonomisë u krye në më pak se pesë vjet. U përmbysën raportet midis pjesëve përbërëse të Prodhimit të Brendshëm Brut: kontributi i prodhimit industrial nga 37.2% në vitin 1990, në vitin 1996 arriti në 12.5%; ndërsa kontributi i bujqësisë u rrit nga 40.2% në 1990 në 52.8% në 1996.

Kjo rënie e prodhimit industrial u shoqërua me ndryshime po kaq të mëdha edhe në strukturën e forcave të punës dhe të punësimit. Ndërsa punësimi në industri ra në mënyrë drastike nga afro 22% në vitin 1991 në afro 8% në vitin 1996, në

*Ajo që vërtet ishte një sukses për reformën ekonomike shqiptare dhe që u konsiderua si e tillë nga institucionet*

**Figura 4 - Kontributi në PBB**

Burimi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kooperimit dhe Tregëtisë



aktivitetin bujqësor dhe atë të shërbimeve u evidentua një rritje, por jo me ato nivele që të mund të kompensonte rënien në industri. Kështu u shfaqën dy dukuri të reja, emigracioni dhe papunësia: kjo e fundit arriti nivelin e saj më të lartë në vitin 1993, afro 22% të forcave të afta për punë.

### Shfaqja e Krizës

Viti 1996 përkoi me dy fushata elektorale të kushtueshme. Duket se kjo ndikoi në dobësimin e ndjekjes konsekuente të programit ekonomik, ndërkohë që diskutimi publik i politikave ekonomike dhe rezultateve të tyre, u orvat më fort të krijonte iluzionet e një aktiviteti ekonomik shumë të suksesshëm dhe të një shoqërie pa probleme të mëdha

ekonomike. Ajo që vërtet ishte një sukses për reformën ekonomike shqiptare dhe që u konsiderua si e tillë nga institucionet ndërkombëtare, nuk u trajtua si pjesë e një procesi që do të kishte uljet dhe ngritjet e veta e që duhej ndjekur në dinamikë, por si një sukses politik. Problemet ende të pazgjidhura apo edhe të diskutueshme si privatizimi, reforma e sistemit financiar e ajo institucionale, nuk u debatuan me transparencën e duhur, gjë që do të mund të siguronte një përfshirje sa më të gjerë të publikut në debat. Faktor i rëndësishëm i krizës u bë edhe korrupsioni i përfolur në shërbimet publike, sistemi i paqartë ligjor kundër tij dhe kundër aktiviteteve ilegale e informale në përgjithësi. Shtratin e ngrohtë për aktivitetet ilegale, veçanërisht për kontrabandën, e ushqeu edhe gjendja politike dhe ekonomike e

*ndërkombëtare, nuk u trajtua si pjesë e një procesi që do të kishte uljet dhe ngritjet e veta e që duhej ndjekur në dinamikë, por si një sukses politik.*

**Rasti i transformimeve në Shqipëri tregoi se sa e rëndësishme është të realizohen njëherësh me transformimin ekonomik edhe transformimet e duhura institucionale.**

rajonit. Reagimi i pamjaftueshëm i shtetit për të minimizuar këto fenomene, si edhe për të kuptuar dhe thënë të vërtetën mbi investimet në firma të dyshimta piramidale ushqyen pakënaqësi te njerëzit, e cila u bë e pranishme në fund të vitit 1996 dhe u rrit e u intensifikua në muajt e parë të vitit 1997.

Probleme të tjera qëndrojnë, gjithashtu, në rrejtjet e situatës dramatike ekonomike në fillim të vitit 1997. Baza e dobët ekonomike e trashëguar, sistemi i prapambetur bankar, mungesa e plotë e tregut të kapitaleve dhe institucionet e pazhvilluara ndikuan në acarimin e krizës. Një imponim shumë i dobët i reformës fiskale dhe një administratë e dobët taksash ndikoi fuqishëm në keqësimin e gjendjes buxhetore. Papunësia u rrit me shpejtësi: në vitin 1996 rezultoi 12.3 % ndërsa më 1997 rreth 14.9 %. Në kushtet e një varfërie të madhe, kur të ardhurat vjetore për frymë më 1996 arrinin vetëm 85.600 lekë, transformimi ekonomik shqiptar u shfaq si një nga tranzicionet më të dhimbshme të vendeve ish-komuniste.

Kriza ekonomike, që kulmoi në fillim të vitit 1997, u karakterizua së pari nga përkeqësimi i shpejtë i treguesve ekonomikë, duke filluar pas mesit të vitit 1996 dhe që vazhdoi gjatë vitit 1997. Gjatë vitit 1996 inflacioni kërcëu përsëri në nivelet 17-18 % ndërsa deficiti i buxhetit zuri rreth 12% të PBB-së nga rreth 7% në vitin 1994, duke shfaqur brishtësinë e ekonomisë. Nga ana tjetër, në fund të vitit 1996 vendi u ndodh përpara një situatë larg ekuilibrave makroekonomikë, por u duk qartë se edhe baza mikroekonomike e reformës kishte njaft probleme. Në këtë mënyrë transformimet reale dhe suksesi i reformës ekonomike në Shqipëri nuk u shoqëruan nga një reformë e thellë dhe serioze institucionale. Ndryshimet institucionale të shumëpritura përfshinin një kushtetutë të re, institucione të reja, si dhe zbatimin e rregullave bazë të drejtimit të shoqërisë, por ato presupozonin gjithashtu edhe ngritjen e funksionimit të një sistemi të ri taksash, të një sistemi bankar eficient, të krijimit dhe rregullimit të tregjeve nëpërmjet legjislativitetit, institucioneve përkatëse, etj. Duke mos pasur traditën e një demokracie të zhvilluar

dhe aq më pak të një ekonomie tregu, rasti i transformimeve në Shqipëri tregoi se sa e rëndësishme është të realizohen njëherësh me transformimin ekonomik edhe transformimet e duhura institucionale.

Inercia e gjatë e një politike restriktive stabilizimi dhe, sidomos, kufizimi i fortë i niveleve të kreditimit të ekonomisë nuk krijuan hapësira të favorshme për zhvillimin e vrullshëm të tregjeve ndaj dhe u shfaqën ndikime të kundërta nga ato që pritëshin. Kërkesa agregate rezultoi e rritur artificialisht, kundrejt rritjes së prodhimit, duke rezultuar në rritjen e pambështetur të konsumit. Veçanërisht i ulët mbeti komponenti i investimeve publike, i cili zuri vetëm 5.9% të PBB-së në vitin 1996. Nga ana tjetër, komponenti formal i kursimeve ra ndjeshëm duke u orientuar pothuajse totalisht në sektorin informal, të ardhurat e të cilat në formën e interesave të larta shkonin kryesisht për konsum. Ndërkaq investimet e huaja direkte rezultuan rreth 300 mln USD për periudhën 1991 - 1996, ndërsa investimet në sektorin joformal financiar arritën në rreth 1.2 mlrd USD.

Gjatë vitit 1996 privatizimi u ngadalësua derisa u ndërpre krejt më 1997. Rritja ekonomike gjatë 1996 ra në 9.1% në krahasim me 13.3% të raportuar për 1995, ndërsa për vitin 1997 u shënua një rënie drastike duke arritur në -7%. Nga ana tjetër të dhënat e llogarisë korrente dhe të bilancit tregtar treguan një deficit të mëtejshëm: gjatë vitit 1996 llogaria korrente rezultoi me një deficit gati 9 herë më të rritur se më 1995, e barabartë me 107.2 milionë USD, ose pak më e vogël se deficiti i përmbledhur për periudhën 1992 - 1995. Ndërkaq viti 1997 rezultoi të jetë edhe më deficitar: deficiti prej afro 270 milion dollarë është sa shuma e të gjithë periudhës 5 vjeçare 1992 - 1996. Monedha vendase u zhvlerësua me më shumë se 30% brenda tre muajve të parë të vitit 1997.

Së dyti, kriza ekonomike u karakterizua nga një krizë financiare e lidhur me ndërprerjen e aktivitetit të firmave dhe shoqatave huamarrëse. Investimi i publikut shqiptar në shkallë të gjerë në këto firma, të cilat qëllitën pothuajse të gjitha kursimet e qytetarëve shqiptarë brenda e

## **Bankat - privatizim apo likuidim?**

Reforma e sistemit bankar e në tërësi atij financiar në Shqipëri u zhvillua me hapa tepër të ngadaltë. Pasojat e kësaj vonese u pasqyruan ndjeshëm edhe në krijimin e terrenit për zhvillimin e aktiviteteve të huamarrjes.

Alternativa e drejtë shtruar për zgjidhje gjatë vitit 1997 e në vazhdim është ristrukturimi tërësor e i shpejtë i veprimtarisë së sistemit bankar, si dhe fillimi i punës për ngritjen e një sistemi financiar efikas, i cili, nga njëra anë do të mobilizojë e administrojë në mënyrë efikase dhe të sigurt kursimet e qytetarëve dhe biznesit, ndërsa nga ana tjetër do të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë nëpërmjet kreditimit dhe shërbimeve bankare.

Problemet aktuale lidhen sa me nevojën për rregullimin e duhur ligjor për funksionimin dhe ngritjen e kapaciteteve për mbikqyrjen e sistemit bankar e atij financiar, aq edhe me transformimin e bankave të nivelit të dytë, sot për sot në pronësi të shtetit.

Praktika e viteve të fundit ka treguar se ngritja e një sistemi të mirë bankar kërkon para së gjithash të përsoset legjislacioni që rregullon aktivitetet në këtë sektor. Në janar të vitit 1998 është miratuar ligji i ri për Bankën e Shqipërisë dhe së shpejti pritet të miratohet edhe ai për Sistemin Bankar, ligje që do të përbëjnë një bazë më të mirë për ndërtimin e funksionimin bashkëkohor të një sistemi bankar kryesisht privat në një të ardhme jo të largët. Për më tepër, me mbështetjen edhe të institucioneve ndërkombëtare, po punohet për rregullimin dhe ngritjen e institucioneve të tjera financiare jo fitimprurëse, që mundësojnë kreditimin e vogël për ato shtresa të popullsisë, që objektivisht nuk kanë plotësisht mundësi për t'u mbështetur nga sistemi bankar.

jashtë vendit, u bë faktori kryesor katalitik që nxiti dhe përshpejtoi krizën e përgjithshme të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare. Karakteristika kryesore e tregut informal të kreditit ishte përdorimi masiv i normave të larta e të pajustificuara ekonomikisht të interesit. Pavarësisht nga luhatjet që kanë shfaqur normat e interesit për depozitat dhe kreditë në sektorin bankar nga 1991 në 1995, krahasuar me ato të sektorit informal të kreditit ato kanë qenë rreth 5-6 herë më të ulta.

Përpjekjet për ta bërë sistemin bankar ende mjaft i pranishëm për sa i përket pronës në sistemin bankar, sikundër tashmë është e qartë që kjo prani duhet të pakësohet sa më shumë të jetë e mundur. Rrugët e këtij transformimi përmbajnë specifika për vende e rrethana të ndryshme, specifika që lidhen me nivelin sotëm të zhvillimit të këtij sektori, me gjendjen konkrete të bilanceve të bankave etj. Gjendja e bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Shqipëri ka shtruar për zgjidhje dilemën: privatizim apo likuidim? Ndërsa procesi i privatizimit konsiderohet zgjidhja finale, nga diskutimet dalin argumenta pro dhe kundër procesit të likuidimit, sikurse edhe pranohet se ristrukturimi dhe pastrimi i bilanceve negative të tyre përpara privatizimit do të përbënte një zgjidhje pozitive për situatën. Në praktikën shqiptare u ndërmor në fillim të vitit 1998 akti i thithjes së Bankës Tregtare Agrare (BTA) nga Banka Kombëtare, si një rrugë e mundshme për të mos thelluar gjendjen e rënduar financiare të BTA, si dhe për t'i hapur rrugë vazhdimit të ristrukturimit e privatizimit të sistemit bankar.

### ***Ëndrra e Shkurtër e Piramidave***

Institucione si FMN dhe Banka Botërore deklaruan vitin e kaluar se vlera nominale e parave të humbura nga popullsia shqiptare në skemat piramidale është ekuivalente me atë të rreth 1.2 miliardë dollarë amerikanë, vlerë kjo e barabartë me gjysmën e PBB-së të realizuar nga ekonomia shqiptare gjatë vitit 1996. Ky fenomen kompleks u shfaq në Shqipëri si një ëndërr e besueshme nga shumica e njerëzve dhe analizat ekonomike, politike e sociale për të sapo kanë filluar.

Në asnjë shtet tjetër të lindjes apo të perëndimit nuk është parë një rrënim i tillë i shkaktuar nga përmbysja e skemave piramidale. Dhe ishik pikërisht këto përmasa të pazakonta të piramidave, një

## VROJTIM Nr. 1

Tabela 2


Ju, apo dikush që ju njihni, a pësuar humbje parash në skemat piramidë?

	Perqindja Mesatare	Pergjigje Gjithsej
Jo	22 %	323
Po	78 %	1,169

ndër faktorët kryesorë që e shtynë më pas shtetin në buzëhumnerën e kolapsit dhe të konfliktit civil. Me fillimin e tranzicionit ekonomik, nisi të shfaqet edhe tregu financiar joformal. Krahas disa qindra kambistëve të palicensuar, pjesë e këtij tregu u bënë edhe disa firma, të cilat në vitet 1993-1994 nisën të huamarrin para nga publiku i gjerë duke ofruar interesa 4-5% në muaj. Asnjëra nga këto kompani nuk kishte licencë bankare që t'iu lejonte të grumbullonin depozita. Ndonëse nuk shërbyen si ndërmjetës për kalimin e parave nga publiku në kreditimin e sektorit privat, këto kompani shfrytëzuan në interes të tyre dobësinë e sistemit bankar duke thithur një pjesë mirë të kursimeve të familjeve, si dhe të ardhurave nga emigracioni.


Në fakt këto firma u shtuan si

Figura 5 - Kush ishte përgjegjës për humbjen e parave tuaja në skemat piramidale?



Burimi: ORT, 1997

Figura 6 - Gjëndja e Depozitave



Burimi: Ministria e Financave



kërpurdhat pas shiut dhe ato, apo degë të tyre i gjeje thuajse në çdo rreth të vendit duke kryer haptazi operacione financiare. Viti 1996 shënon edhe momentin kur natyra e tregut jo zyrtar financiar fillon të ndryshojë me shpejtësi, si rrjedhojë e konkurrencës së ashpër që shpërtheu mes firmave. Disa firma të reja hynë në treg duke ofruar interesa më të larta se të parat, 8-10 % në muaj. Në tremujorin e tretë të vitit 1996 disa prej tyre ofruan edhe deri 40-50 % interes në muaj.

S'ka asnjë dyshim se mungesa e përvojës së publikut në çështjet financiare, si dhe psikologjia e pasurimit të shpejtë që pushtoi shumë njerëz, kanë luajtur një rol të dorës së parë në lulëzimin e piramidave. Por toleranca e shtetit e shfaqur për vite me radhë ndaj ketij aktiviteti të paligjshëm është një dukuri thuajse absurde, shkaqet e së cilës kanë mbetur ende të pashpjeguara tërësisht. Skemat piramidale u zhvilluan aq shumë sa nuk mund të mos shiheshin. Në sportelet e tyre rreshtoheshin çdo ditë turma njerëzish për të derdhur apo tërhequr para. Krahas kësaj, kishte patur raste firmash apo individësh të denoncuar edhe nga shtypi, që pasi kishin grumbulluar para nga publiku sipas formulës fajde ishin larguar jashtë shtetit në drejtim të paditur.

Ndërkaq, ndoshta për herë të parë në historinë e skemave piramidale u vu re lidhja e tyre me sistemin bankar. Mjaft kompani hapën llogari rrjedhëse edhe në bankat shtetërore të nivelit të dytë ku derdhnin milionat e mbledhura nga publiku. Kjo lidhje e fajdeve me sistemin bankar shkaktoi një rritje galopante të depozitave pa afat, veçanërisht në vitin 1996.

Interesat e ofruara u ngjitën mjaft lart duke tejkaluar disa herë shifrën e pritshme të inflacionit: në vitin 1996 ato ishin rreth 8 herë më të mëdha se në vitin 1991 dhe rreth 3 herë më të mëdha se në vitin 1995. Megjithatë, nuk pati asnjë reagim ndaj përqëndrimit të pazakontë të masës së parave në pak duar, përqëndrim që po trondiste disa nga treguesit kryesorë makroekonomikë.

Për herë të parë FMN e shpalli qëndrimin e vet kundër piramidave vetëm në fund të vitit 1996, atëherë kur e keqja

ishte akumuluar dhe pritej vetëm shpërthimi i saj. Gjithsesi, dinamika e paralajmërimeve të institucioneve ndërkombëtare financiare për rrezikun e fajdeve nxjerr në pah edhe mungesën e aftësisë së shtetit për të vepruar. Me paditurinë, heshtjen, pakujdesinë, si edhe korrupsionin e vet, shteti lejoi që fajdet të përfshijnë në vorbullën e interesave jo ligjore një pjesë të konsiderueshme të familjeve shqiptare në të gjithë zonat e vendit. Në vitin 1996 ishte shumë e vështirë t'iu shpjegoje qindramijë njerëzve se ato që deri dje qenë pjesë integrale e mrekullisë shqiptare, befasisht ishin shndërruar në varr të saj.

Në fillim të vitit 1997 të gjitha skemat pezulluan pagesat ndaj kreditorëve. Pikërisht në këtë moment Qeveria ndërmori hapin e parë, duke ngrirë llogaritë bankare të dy fondacioneve, Populli e Xhaferrit. Shumat e bllokua u rikthyen publikut duke i shlyer mesatarisht me 50 % të parave të depozituara në këto fondacione. Njëherazi, me qëllim të parandalonte zbrazjen e llogarive bankare nga skemat e tjera, Banka e Shqipërisë kufizoi tërheqjet ditore nga çdo llogari bankare në masën 300 mijë dollarë amerikanë. Këto masa të vonuara nuk e shmangën dot katastrofën.

Katastrofa e skemave piramidale rrënoi thuajse të gjithë treguesit makroekonomikë të stabilizuar me mundim nëpërmjet një politike të shtërnguar monetare e fiskale. Ekonomia shqiptare u detyrua të ripërballet me të njëjtat probleme që shtroheshin para saj në fillim të viteve 90. Prodhimi ra ndjeshëm ndërkohë që inflacioni u ngjit në kuotat më të larta.

Ndërsa presin të marrin diçka nga paratë e humbura, shqiptarët e varfër kujtojnë me hidhërim se si me paratë e tyre 'Gjallica' sponsorizonte me 1 milionë dollarë spektaklin e bukurisë 'Miss Europa' të zhvilluar në Tiranë; kur 'Vefa' paguante 450 mijë dollarë vetëm për një reklamë, që shqiptarët të shihnin në garat FORMULA UNO katër gërmat e emrit të saj; kur 'Xhaferrit' paguante 400 mijë dollarë që ylli i dikurshëm i futbollit argjentinas Kempes të zbriste në qytetin e vogël të Lushnjës për të drejtuar një skuadër modeste futbollit.

***S'ka asnjë dyshim se mungesa e përvojës së publikut në çështjet financiare, si dhe psikologjia e pasurimit të shpejtë që pushtoi shumë njerëz, kanë luajtur një rol të dorës së parë në lulëzimin e piramidave.***

**Tabela 3 - Financimi i Deficitit te Shtetit (në % ndaj PBB)**

	1993	1994	1995	1996	1997	1998 (estimated)
Defiçiti total	13.8	11.3	10.3	11.9	12.7	13.7
Financuar nga Burime të Brendshme	9.3	7.1	6.7	10.5	10.6	6.4
Financuar nga Burime të Huaja	4.5	4.2	3.6	1.4	2.1	7.3

*Burimi: Ministria e Financave*

Tashmë Shqipëria po ndeshet me problemin e "çmontimit" të skemave piramidë. Një nga aktet e para të Parlamentit të krijuar në qershor të vitit 1997 ishte miratimi i ligjit për caktimin e revizorëve dhe administratorëve të huaj për realizimin e

**Tabela 4 - Te Ardhurat Buxhetore (në % ndaj PBB)**

Të ardhurat Buxhetore	1995	1996	1997
Të ardhura gjithsejt	23.4	18.3	16.9
Të ardhura Tatimore gjithsejt nga të cilat:			
Të ardhura nga Doganat	13.2	2.7	10.7
	2.7	9.7	2.6

*Burimi: Banka e Shqiperise*

transparencës së këtyre skemave dhe në zbatim të tij u kontraktua një kompani e huaj. Në mars 1998 kjo kompani përfundoi fazën e parë të transparencës në pesë firmat më të mëdha, të cilat kanë kryer edhe investime dhe aktivitet tregtar. Shifrat e publikuara edhe në shtyp, treguan se asnjë nga këto kompani nuk ka vlerën e duhur të asetëve për të paguar detyrimet. Vlera e pasurive të patundshme të regjistruar nga kompanitë rezultoi shumë më e ulët se vlera reale maksimale që mund të merret nga shitja e këtyre pasurive. Njëherazi revizorët e huaj konstatuan se asnjëra nga këto kompani nuk ka rrjedhje të nevojshme mjetesesh likuide për të paguar borxhet. Ato do të përpiqen të shpjegojnë se ku kanë shkuar milionat që shqiptarët derdhen verbërisht në kërkim të një pasurimi të shpejtë. Pritet që të shpjegojnë gjithashtu nëse në odisenë e piramidave shqiptare kanë luajtur ndonjë rol veprimtaritë ekonomike ilegale, sikundër janë pastrimi i parave apo format e ndryshme të kontrabandës.

## 2.2. Financat Shtetërore

### Defiçiti buxhetor

Bazën e të ardhurave të buxhetit të shtetit e përbëjnë të ardhurat tatimore. Zvogëlimi i ndjeshëm i tyre në 2 vjetët e fundit, si dhe rritja e shpenzimeve, kanë bërë që defiçiti buxhetor të rritet dukshëm duke arritur në nivelin e vitit 1993.

Duke u nisur nga ndryshimet e mëdha që solli reforma strukturore e ekonomisë në periudhën e tranzicionit, si edhe nga roli mjaft i rëndësishëm që vazhdon të luajë shteti në ekonominë shqiptare, masat për uljen e defiçitit buxhetor kanë marrë rëndësi të veçantë. Ato kanë synuar krijimin e një sistemi financiar funksional, zbatimin e reformave në sektorët e burimeve njerëzore, rishikimin e përparësive në shpenzimet buxhetore dhe përmirësimin e menaxhimit. Si rezultat i këtyre masave, defiçiti u ul

**Bazën e të ardhurave të buxhetit të shtetit e përbëjnë të ardhurat tatimore.**

ndjeshëm deri në vitin 1995, por i ndikuar nga kriza u përkeqësua, dhe në vitin 1998 parashikohet të jetë përsëri në nivelin e vitit 1993.

Kriza e vitit 1997 çoi në ngadalësimin e aktiviteteve ekonomike, inflacion të lartë, zhvlerësim të madh të lekut dhe keqësim të mëtejshëm të defiçitit fiskal. Për pasojë, në periudhën 1996 - 1997 u vu re një ulje e mëtejshme e të ardhurave gjithsejt, veçanërisht e të ardhurave tatimore; këto të fundit u zvogëluar nga rreth 13 % e PBB në rreth 9.7 % të saj.

Ndryshimi i gjendjes së burimeve kryesore të të ardhurave buxhetore lidhet me përmirësimin e kushteve të sigurisë publike, si një element që ndikon drejtpërdrejt në mbledhjen e taksave. Mbështetja financiare nga komuniteti ndërkombëtar është bërë një faktor thelbësor për krijimin e një force anti-kontrabandë dhe krijimin e një reference për vlerësimin doganor. Gjithashtu është siguruar një asistencë e gjerë teknike në fushën e administrimit tatimor dhe doganor.

Për ta bërë më eficient sistemin tatimor, duke filluar nga janari 1998 është rritur kufiri për pagimin e TVSH-së në bizneset me qarkullim jo më të vogël se 5 milionë lekë në vit, është krijuar një zyrë për 200 tatimpaguesit më të mëdhenj, ndërsa për tatimpaguesit me qarkullim vjetor më të vogël se 2 milion lekë janë vendosur tarifa fikse.

Për racionalizimin e sistemit të taksave Kuvendi Popullor hoqi akcizat për alkoolin dhe e zhvendosi atë mbi pijet alkoolike, si dhe vendosi parapagimin e akcizave për cigaret dhe pijet alkoolike. Duke filluar nga shtatori i vitit 1997 është zbatuar një paketë masash, nga të cilat më e rëndësishmja është ndryshimi i TVSH-së nga 12.5 % në 20 %. Në këtë paketë përfshihen edhe rritja e disa taksave kombëtare, ndryshimi i tatimit mbi të ardhurat vetjake, rritja e çmimit tavan për nënproduktet e naftës. Me këto masa parashikohet që brenda vitit 1998 të ardhurat tatimore të arrijnë në rreth 14 % të PBB-së, duke e ngritur nivelin total të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit në rreth 22 % të PBB-së nga 16.9 % që u realizuan në vitin 1997.

Nevoja për zvogëlimin e defiçitit buxhetor ka shtruar nevojën e vazhdimit të reformës në sektorin e burimeve njerëzore. Pas një viti të vështirë si viti 1997, reforma administrative ka filluar të jetë e thellë në vitin 1998. Deri tani është bërë shkurtimi i parë i numrit të punonjësve të administratës publike dhe ky numër parashikohet të arrije deri në 15.000 vetë brenda vitit 1998, duke rritur mundësitë për një pagesë relativisht më të mirë për pjesën tjetër të punonjësve. Synohet të rritet efektiviteti i shpenzimeve kapitale nëpërmjet programimit më të mirë të tyre duke kombinuar elementet afatmesëm të programimit me ata afatshkurtër. Praktika e hartimit të një programi tri vjeçar për investimet publike do të ndihmojë me siguri edhe në gjetjen e mjeteve dhe instrumentave të nevojshëm për hartimin e planit vjetor të buxhetit. I është kushtuar vëmendje zbatimit të programeve e projekteve publike në mënyrë sasiore e cilësore, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të monitorimit të tyre dhe fuqizimit të njësive menaxhuese të projekteve, si edhe lidhjes më të mirë të shpenzimeve kapitale me ato korrente, nëpërmjet programimit të njëkohshëm të këtyre dy lloj shpenzimeve.

Gjithashtu, janë marrë një sërë masash për planifikimin më të mirë dhe rritjen e efektivitetit të atyre investimeve kapitale që bëhen tërësisht me burime të brendshme. Për këtë gjatë vitit 1997 dhe pjesës së parë të vitit 1998 është bërë vlerësimi i gjendjes së investimeve publike në tërë sektorët kryesorë të ekonomisë dhe është hartuar Programi i Investimeve Publike 1998-2001, që i përgjigjet më mirë prioriteteve të ekonomisë shqiptare, me synim mbështetjen me përparësi të ndërhyrjeve për stabilizimin pas krizës dhe krijimin e infrastrukturave bazë të nevojshme për një zhvillim normal e të qëndrueshëm ekonomik. Që në fillim të vitit 1997 u përcaktuan nevojat për përmirësime në sistemin aktual të administrimit të shpenzimeve publike. Filloi puna përgatitore për ndryshime të rëndësishme në ligjin organik të buxhetit, i cili është parashikuar të përfundojë në mes të vitit 1998, si dhe është parashikuar të përfundojë edhe ndryshimi në


***Programi i Investimeve Publike 1998-2001, që i përgjigjet më mirë prioriteteve të ekonomisë shqiptare, me synim mbështetjen me përparësi të ndërhyrjeve për stabilizimin pas krizës dhe krijimin e infrastrukturave bazë të nevojshme për një zhvillim normal e të qëndrueshëm ekonomik.***

klasifikimin buxhetor, i cili do ta bëjë këtë sistem edhe më bashkëkohor. Përmirësimi i teknologjisë së informacionit është një synim tjetër i rëndësishëm që do t'i shërbejë përsosjes së sistemit të menaxhimit të shpenzimeve publike. Pjesë e rëndësishme e këtij programi është edhe krijimi i një sistemi rregjistrimi të të dhënave të financimeve të huaja dhe përmirësimi i funksioneve të Thesarit.

### **Mbështetja e Sektorëve Sociale**

Në periudhën 1994-1997 vihet re një rritje rreth 2 herë e totalit të shpenzimeve sociale. Shkaku kryesor është rritja e shpenzimeve për sigurime shoqërore, të cilat zënë peshën kryesore të shpenzimeve. Megjithë domosdoshmërinë për mbajtjen në një nivel të ulët të defiçitit buxhetor, shpenzimet për politikën e përkrahjes sociale vazhdojnë të mbeten parësore. Si rezultat i reformave dhe përpjekjeve për përmirësimin e legjislacionit fiskal, një pjesë gjithnjë e më e madhe e popullsisë ka nevojë për mbështetje sociale. Prandaj edhe për vitin 1998 përparësi në këto shpenzime parashikohet t'i jepet zbatimit të politikave aktive të angazhimit të të papunëve dhe personave përfitues të ndihmës ekonomike në punë publike, duke siguruar kështu të ardhura më të mëdha për personat në nevojë.

**Figura 7 - Shpenzime sociale për vitet 1994-1997 (në milion lekë)**




Burimi: Ministria e Financave

Për të njëjtën periudhë shpenzimet për shëndetësinë dhe arsimin kanë mbetur pothuajse të pandryshueshme.

Dëmet e shumta të shkaktuara nga kriza e vitit 1997 krijuan mjaft probleme për sistemin shëndetësor. Në gjendjen e tanishme kërkesa parësore janë :

- Garantimi i shërbimeve bazë shëndetësore, duke zburuar disnivelin midis shërbimeve shëndetësore dhe nevojave të popullsisë;
- Rritja e kapacitetit të Institutit të Sigurimeve Shëndetësore me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e mekanizmave të rinj të pagesës;
- Privatizimi i kontrolluar i shërbimit shëndetësor;
- Përmirësimi i menaxhimit dhe i drejtimit;

**Figura 8 - Shpenzimet në fushën Arsimit dhe të Shëndetësisë 1994-1997**



Burimi: INSTAT


Në sektorin arsimor, përveç eliminimit të dëmeve materiale, kërkesa parësore janë :

- Përmirësimi i drejtimit të punës nëpërmjet thjeshtëzimit të strukturave administrative në sektorin arsimor;
- Kualifikimi i mësuesve dhe përmirësimi i programeve;
- Administrimi më i efektshëm i burimeve publike dhe sigurimi i burimeve të tjera nga kontribute të brendshme dhe donatorë të tjerë.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i botimit dhe shtimi i tirazhit të teksteve shkollore.

### **Financimi i huaj**

Bazën e buxhetit të investimeve publike e përbën financimi i huaj. Në periudhën 1991-1994 ky financim i disbursuar ishte afro 14 herë më i madh se financimi i brendshëm. Më pas, deri në vitin 1996, ky raport ka ardhur duke u zvogëluar, për shkak të rritjes së vazhdueshme të burimeve të brendshme dhe stabilizimit të disbursimit të financimit të huaj në vlera më të vogla. Ky raport ka ndryshuar përsëri në vitin 1997, pasi për shkak të krizës, financimi i brendshëm është zvogëluar rreth dy herë ndërsa disbursimi i financimit të huaj është më i vogël se mesatarja e viteve të mëparshme. Në vlera totale, për gjithë periudhën 1991-1997, financimi nga burimet e brendshme rezulton rreth 286 milion USD. Gjithashtu, janë shpenzuar edhe afro 1.27 miliard USD financime të huaja, kundrejt rreth 1.8 miliard USD të angazhuar nga donatorët.

**Figura 9**  
**Angazhimet e Financimit te Huaj sipas Donatoreve**




Burimi: DEDAC

Donatorët kryesorë shumëpalësh të Shqipërisë janë Bashkimi Europian dhe Banka Botërore ndërsa donatorët kryesorë dypalësh janë Italia, SHBA dhe Gjermania. Pjesën kryesore të ndihmës së huaj e zë financimi i projekteve të zhvillimit, ku më të suksesshëm janë projektet e investimeve në infrastrukturën rrugore dhe më pak të suksesshëm janë projektet e kreditimit të sektorit privat, veçanërisht në sektorin bujqësor. Ndihma ushqimore dhe humanitare zë, gjithashtu, një pjesë të rëndësishme, rreth 22 %, gjë që lidhet me nevojat e mëdha për të siguruar mbijetesën e popullatës në dy vitet e para të tranzicionit, kur pothuajse i gjithë prodhimi vendas ishte i bllokuar.

**Donatorët kryesorë shumëpalësh të Shqipërisë janë Bashkimi Europian dhe Banka Botërore ndërsa donatorët kryesorë dypalësh janë Italia, SHBA dhe Gjermania.**

**Figura 10 - Angazhimet e Financimit te Huaj sipas Tipit te Financimit**



Burimi: DEDAC

Ndarja e ndihmës së huaj sipas sektorëve nuk ka qenë e njëjtë. Përparësi i është dhënë atyre sektorëve që lidhen drejtpërdrejt me stabilizimin e treguesve makroekonomikë, si dhe me përballimin e varfërisë.

Kështu, financimi për të mbështetur bilancin e pagesave dhe zbutjen e varfërisë zë rreth gjysmën e financimit të përgjithshëm. Ndër sektorët e tjerë, rreth 15 përqind është financuar transporti, ku përfshihen kryesisht ndërtimi ose rikonstruktimi i infrastrukturave rrugore dhe portuale. Sektorët sociale, si shëndetësia dhe arsimi, zënë rreth 6 % të financimit të huaj, me objekt rehabilitimin e infrastrukturave spitalore e ambulatorie dhe shkollave, rritjen e cilësisë dhe futjen e metodave të reja, si dhe përmirësime rrënjësore në mënyrën e administrimit.

Pas analizës së pasojave të krizës së vitit të kaluar në një konferencë të posaçme


donatorësh, e cila u mbajt në Romë në korrik të vitit 1997, iu dha prioritet financimit të menjëhershëm të sektorit të Administratës Publike, për të mbështetur sigurimin e rendit publik, plotësimin e kuadrit ligjor dhe për të garantuar progresin e reformës së administratës publike, veçanërisht të pushtetit lokal, në të cilat progresi gjatë viteve të tranzicionit u konsiderua fare i pamjaftueshëm.

**Figura 11 - Angazhimet e Financimit të Huaj sipas Sektoreve**



Burimi: DEDAC

**Figura 12 - Financimi Total i Angazhuar për Administratën Publike (në mln USD)**



Burimi: DEDAC

### 2.3. Ridimensionimi i Sektorit Publik

#### Privatizimi

Ligji themelor i privatizimit u miratua nga Parlamenti Shqiptar në gusht të vitit 1991. Ai përcaktonte parimet kryesore të shndërrimit të pronësisë dhe lejonte një hapësirë të gjerë në drejtim të metodave që do të ndiqeshin në kryerjen e këtij transformimi: si ankandi, tenderi, shitja direkte, shpërndarja e lirë e aksioneve dhe çdo metodë tjetër e konsideruar e përshtatshme për këtë proces. Procedurat konkrete të vlerësimit dhe privatizimit të objekteve dhe ndërmarrjeve janë detajuar në një numër të konsiderueshëm

vendimesh dhe udhëzimesh të Këshillit të Ministrave.

Etapat ku ka kaluar procesi i privatizimit në Shqipëri ngjajnë me ato në të cilat kaloi procesi i privatizimit dhe në vendet e tjera në tranzicion. Këto janë:

- Privatizimi i njësive të vogla
- Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha kryesisht nëpërmjet programit të privatizimit masiv.


**Privatizimi i njësive të vogla u krye me shpejtësi të madhe, duke bërë që në vitin 1992, 75% e rrjetit të tregtisë dhe njësive të shërbimeve të transferoheshin në pronarët private.** Këto njësi të privatizuara ishin dyqanet e shitjes me pakicë, restorante, magazina si dhe njësi të vogla të pavarura prodhimi. Statistikat e privatizimit regjistrojnë 30.199 objekte të vogla, makineri e pajisje të privatizuara deri në mars të vitit 1997. Gjatë periudhës korrik 1993 deri në prill 1997, kur procesi i privatizimit u ndërpre për shkak të krizës, janë privatizuar 11.504 objekte e ndërmarrje të vogla e të mesme. Rreth 32% e tyre janë privatizuar në favor të punonjësve, rreth 23% janë privatizuar nëpërmjet të drejtës së parablerjes nga ish-pronarët e truallit, ndërsa pjesa tjetër në favor të investitorëve të ndryshëm.

**Tabela 5 - Privatizimi ne Vite sipas Bleresve**

Viti	Pronarë të rinj				Numri				Objekteve
	Punonjës		Shtetas Shqiptarë		Të huaj		Ish-pronarë		
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	
Korr - Dhjet 1993	1,520	46.5	1,360	41.6	24	0.7	364	11.1	3,268
1994	1,103	39.7	905	32.6	6	0.2	761	27.4	2,775
1995	736	25.2	1,420	48.6	1	0.0	767	26.2	2,924
1996	335	14.9	1,210	53.8	2	0.1	701	31.2	2,248
Jan - Prill 1997	20	6.9	116	40.1	-	0.0	153	52.9	289
<b>Totali</b>	<b>3,714</b>	<b>32.3</b>	<b>5,011</b>	<b>43.6</b>	<b>33</b>	<b>0.3</b>	<b>2,746</b>	<b>23.9</b>	<b>11,504</b>

Burimi: Agjencia Kombëtare e privatizimit dhe Projekti GTZ

**Figura 13 - Privatizimi sipas Blerësve**



Burimi: Ministria e Privatizimit



Fillimisht, teknikat e përdorura në privatizim kanë qenë ankandit dhe shitja e drejtpërdrejtë. Kjo e dyta është përdorur në rastin e shitjeve të punonjësit, në rastin e privatizimit në favor të ish-pronarit të truallit, apo kur janë favorizuar kërkesa të veçanta, me vendim të Bordeve të Privatizimit të krijuara në të gjitha rrethet e vendit, të cilat funksionuan prej majit 1993 deri në mesin e vitit 1995. Investitorët e huaj, megjithëse të dëshirueshëm, nuk kanë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces. Në të vërtetë, kuadri ligjor dhe nënligjor që lidhet me procesin e privatizimit, bën një trajtim të barabartë, si për investitorët shqiptarë ashtu dhe për ata të huaj. Investitorët e huaj kanë parapëlqyer të hyjnë në marrëdhënie pronësie me pronarët privatë sesa me shtetin.

Në Shqipëri ndërmarrjet iu nënshtuan një copëzimi të vazhdueshëm duke ndryshuar jo vetëm në numër, por edhe në varësi e në emërtime. Ky evoluim nuk u evidentua siç duhej, duke e bërë të vështirë gjykimin se ç'pjesë e pasurisë shtetërore rezultonte e privatizuar në periudha kohe të caktuara. Nga statistikat ekzistuese rezulton se nga 2.396 ndërmarrje shtetërore të regjistruara në fund të vitit 1993, deri në mars 1997, 29.5% e tyre janë plotësisht me pronësi shtetërore, 17.61 % me pronësi mikse dhe 52.84 % janë transferuar në pronësi të subjekteve private. Në vlerë tabloja paraqitet ndryshe. Mbështetur në kriteret e vlerësimit të vitit 1993, rreth 58 % e vlerës së ndërmarrjeve është ende shtetërore, rreth 22 % është në pronësi mikse dhe rreth 20 % e vlerës së ndërmarrjeve rezulton plotësisht e privatizuar. Duke analizuar raportin shtet privat në pronësinë mikse, rezulton se 13% e saj është private ndërsa pjesa tjetër ende shtetërore.

Programi i privatizimit masiv filloi në prill të vitit 1995, kur u përcaktuan struktura dhe kërkesat e këtij programi, oferta e ndërmarrjeve që do t'i nënshtroheshin procesit të transformimit, si dhe mekanizmi mbi bazën e të cilit do të bëhej shpërndarja e aksioneve nga shteti tek aksionerët privatë. Shpërndarja u parashikua të bëhej në 2 këste. Nga kësti i parë janë shpërndarë 14.8 miliard lekë

bono privatizimi, të cilat i përfitoi popullsia qytetare mbi 18 vjeç e ndarë në 3 grup-mosha, dhe ka ende 2.8 miliard bono privatizimi të shpërndara. Nga kësti i dytë janë shpërndarë afro 37 miliard lekë bono privatizimi, ndërsa priten të shpërndahen edhe 18.6 miliard lekë bono si pjesë e këtij kësti. Gjithashtu, prej gushtit të vitit 1994 janë hapur pranë Bankës së Kursimeve llogari për ish të përndjekurit politikë, të cilat arrijnë vlerën 17.5 miliard lekë. Sipas të dhënave të mësipërme shuma totale e lekëve dhe bonove të privatizimit e parashikuar të përdoret në procesin e privatizimit është 90.7 miliard lekë.

Programi i Privatizimit masiv shënon 97 shoqëri aksionere të privatizuara plotësisht apo pjesërisht, shumica e të cilave nga sektori i ndërtimit, sektori i industrisë mekanike si dhe nga industria e lehtë dhe ushqimore. Gjithashtu u privatizuan paketat kryesore të 10 shoqërive të tjera aksionere në favor të një investitori nëpërmjet metodës së ankandit. Ndër këto shoqëri, vetëm tre janë shoqëri që bëjnë pjesë në grupin e shoqërive të konsideruara strategjike dhe konkretisht shoqëritë e shpërndarjes së energjisë elektrike të qyteteve Shkodër, Vlorë e Elbasan, të cilave iu privatizua 30 % e kapitalit.

Për të ndihmuar në kryerjen e modelit të privatizimit, po të marrim në konsideratë statistikat e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, deri tani në privatizimin masiv dhe në privatizimin e vogël dhe të mesëm janë përdorur vetëm afro 16 % e sasisë së bonove e të lekëve të privatizimit, ndërkohë që janë privatizuar 107 shoqëri aksionere dhe shumë ndërmarrje të vogla e të mesme, të copëzuara fillimisht apo jo. **Mungesa e një faze të domosdoshme përgatitore, prishja e ekuilibrit ndërmjet kërkesës dhe ofertës në privatizimin masiv, si dhe një punë e pamjaftueshme për ndërgjegjësimin publik, janë disa nga arsyt e vlerës së ulët të bonove dhe lekëve të privatizimit në treg, e cila aktualisht është rreth 3 % e vlerës fillestare.**

Programi i privatizimit masiv e gjen justifikimin kryesor në kontributin e punës së brezave për krijimin e pronës shtetërore.

***Kuadri ligjor dhe nënligjor që lidhet me procesin e privatizimit, bën një trajtim të barabartë, si për investitorët shqiptarë ashtu dhe për ata të huaj. Investitorët e huaj kanë parapëlqyer të hyjnë në marrëdhënie pronësie me pronarët privatë sesa me shtetin.***

Sigurisht që është e pamundur për të matur saktësisht ndihmesën e gjithsecilit në krijimin e kësaj pasurie. Është kjo arsyeja që bonot e privatizimit u ndanë mbi bazën e grup moshave për qytetarët mbi 18 vjeç. Pavarësisht se në këtë proces përfituan bono rreth 1.2 milion qytetarë shqiptarë, vetëm 22.000 prej tyre i përdorën në mënyrë të drejtpërdrejtë në privatizimin e shoqërive aksionere.

### *Privatizim i menjëhershëm apo më parë ristrukturim*

Përvoja shqiptare ashtu si dhe ajo e vendeve të tjera në tranzicion, provoi se përgjigja është në favor të së parës. Në Shqipëri u bënë përpjekje të inicimara dhe financuara nga Banka Botërore për të institucionalizuar ristrukturimin me anë të krijimit dhe funksionimit të një Agjencie Shtetërore të Ristrukturimit të Ndërmarrjeve, por këto përpjekje nuk patën suksesin e pritshëm, për shkak të kontradiktës ndërmjet qëllimit dhe objektivave të caktuara për t'u realizuar nga një institucion ristrukturimi nga njëra anë, dhe ndërmarrjeve me tregues të këqinj që u zgjodhën si objekt i këtij ristrukturimi, nga ana tjetër.

Një nga detyrat e vështira dhe me rëndësi kombëtare shtruar për zgjidhje është privatizimi i sektorëve me rëndësi strategjike për ekonominë. Duke patur parasysh natyrën e këtyre sektorëve, gjendjen ekonomike - financiare, pozitën monopol në treg të shumë prej tyre, mënyrën e organizimit, që është larg së qënuri konformi mënyrës së organizimit të një shoqërie private, kuadrin e përgjithshëm ligjor ende të pakompletuar mirë, ky proces parashikohet të jetë mjaft kompleks dhe i vështirë. Një nga vështirësitë kryesore është nevoja që kanë këto ndërmarrje për ristrukturim teknologjik, ndërkohë që shteti nuk zotëron as fuqinë financiare dhe as njohuritë e motivacionin e nevojshëm për ta kryer këtë ristrukturim në mënyrën e duhur. Mbështetur në këtë vizion, moskryerjen në përgjithësi të ristrukturimit teknologjik nga ana e shtetit përpara privatizimit do ta kompensonte një metodë dhe teknike rezultative privatizimi e tillë, që i jep përparësi gjetjes së pronarit më të mirë midis atyre që do të jepin garanci të mjaftueshme për të përballuar investimet e nevojshme për ristrukturimin teknologjik.

Duke reflektuar ndaj problemeve të së kaluarës dhe duke vlerësuar faktin se është koha për të hyrë në një fazë të re të privatizimit dhe pikërisht, në atë të privatizimit të sektorëve strategjike, Kuvendi Popullor Shqiptar ka miratuar në mars të vitit 1998, Ligjin për Privatizimin e Sektorëve me Rëndësi të Veçantë për

Ekonominë, si edhe strategjinë e privatizimit të këtyre sektorëve. 1. Rritja e eficiencës ekonomike. 2. pakësimi i harrës buxhetore. 3. dobësimi i pozitës monopol të tyre nëpërmjet liberalizimit. 4. krijimi i një mjedisi konkurrues, ku këta sektorë do të jenë të aftë për të konkurruar në mënyrë të ndershme, janë disa nga objektivat kryesorë të këtij ligji. Gjithashtu, ky ligj shprehet se të gjithë sektorët e rëndësishëm së veçantë janë të privatizueshëm, duke bërë që privatizimi të mos jetë qëllim në vetvete, por nëse konkludohet se privatizimi është zgjidhje optimale për objektivat e vëna për sektorin apo shoqërinë, ligji hap rrugë për të vepruar. Privatizimi i sektorëve si telekomunikacioni, nafta dhe gazi, industria e kromit, uji, portet, aeroportet etj., fillimisht do të kryhet duke gjetur një investitor strategjik, zgjedhja e të cilit do të jetë mbi bazën e kriterëve të përcaktuar me ligj të veçantë për secilin sektor. Investitori strategjik do të privatizojë me para në dorë paketën kryesore, madhësinë e së cilës do të rezultojë nga negociimi me të. Më tej do të veprohet me pjesën tjetër të aksioneve, të cilat pjesërisht do t'u shpërndahen punonjësve të shoqërive që privatizohen dhe pjesërisht do të privatizohen nëpërmjet programit të privatizimit masiv. Gjithashtu, për herë të parë u përcaktua mbajtja e aksionit të atë në ata sektorë ku shteti duhet të vazhdojë të vendosë për probleme me rëndësi ekonomike e sociale për vendin.

Vendim marrja në procesin e

privatizimit do të jetë e karakterit strategjik dhe operacional në katër nivele dhe konkretisht organet vendimmarrëse do të jenë: Kuvendi Popullor, Këshilli i Ministrave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Miratimi i strategjisë së privatizimit të sektoreve me rëndësi të veçantë për ekonominë, përfaqëson një shans më shumë për një ecuri më të mirë dhe për një perspektivë të studiuar të këtyre sektoreve.

### Ndërmarrjet

Privatizimi e ka rritur ndjeshëm kontributin e sektorit privat në gjenerimin e PBB-së. Në fund të vitit 1996 ky

kontribut është vlerësuar në afro 75 % të PBB-së.

Numri i ndërmarrjeve aktive të regjistruara pranë zyrave të tatimeve deri në fund të vitit 1997 është rreth 62,000. Në këto ndërmarrje rezultojnë të punësuar rreth 214,000 punonjës, përfshirë këtu sektorin shtetëror dhe atë privat. Ndërmarrjet shtetërore zënë rreth 9 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe në to janë të punësuar rreth 44 % e punonjësve. Numri më i madh i ndërmarrjeve është krijuar më 1994 dhe pjesa më e madhe e tyre operojnë në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve (rreth 18 %). Vetëm 10 % e ndërmarrjeve janë në sektorin e industrisë.

Duke analizuar grupin e ndërmarrjeve aktive, rezulton se për nga numri i të

*Privatizimi e ka rritur ndjeshëm kontributin e sektorit privat në gjenerimin e PBB-së. Në fund të vitit 1996 ky kontribut është vlerësuar në afro 75 % të PBB-së. Dendësia e ndërmarrjeve ekonomike të regjistruara në Shqipëri është 16 ndërmarrje për 1000 banorë.*

**Tabela 6 - Të Dhëna Kryesore mbi Ndërmarrjet Private**

	Aktiviteti ekonomik	Ndërmarrje (%)	Punësim (%)	Numri Mesatar i Punonjesve
1	Industri	10	27	5
2	Ndërtim	3	9	6
3	Tregeti	54	38	1.4
4	Transport	15	10	1.3
5	Shërbime	18	16	1.8
6	Totali	100	100	1.8


Burimi: INSTAT

punësuarve, madhësia mesatare e ndërmarrjes shqiptare, në fund të vitit 1997, është 3.5 punonjës dhe kjo paraqitet e diferencuar sipas formës legale të ndërmarrjes. Për ndërmarrjet e statusit të personit fizik ajo është 1.1 punonjës, për ndërmarrjet private me statusin e personit juridik është 5 punonjës dhe për ndërmarrjet shtetërore është 169 punonjës. Në sektorin privat 85 % e ndërmarrjeve janë me një punonjës dhe vetëm 3 % me mbi dhjetë punonjës.

**Madhësia mesatare** e ndërmarrjes është e ndryshme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë : ajo është më e madhe në ndërtim e industri dhe më e vogël në transport.

**Dendësia** e ndërmarrjeve ekonomike të regjistruara në Shqipëri është 16 ndërmarrje për 1000 banorë. Ky tregues

**Figura 14 - Shpërndarja e Ndermarrjeve sipas Zonave**



Burimi: INSTAT

paraqitet në nivele të ndryshme për rrethe të ndryshme të vendit. Kështu në Tiranë ku është përqëndruar afro 27 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve ekonomike, ky tregues është 33 ndërmarrje aktive për 1000 banorë, në Shkodër është

7 ndërmarrje aktive për 1000 banorë, në Fier është 9 ndërmarrje aktive për 1000 banorë, në Korçë është 16 ndërmarrje aktive për 1000 banorë, në Gjirokastrë është 17 ndërmarrje aktive për 1000 banorë.

Shpërndarja e ndërmarrjeve ekonomike sipas zonave urbane dhe rurale dëshmon se në zonat urbane është përqëndruar rreth 78 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe mbulohen rreth 86 % të punësimit të sektorit shtetëror e privat.

Rreth 84 % e ndërmarrjeve të krijuara në zonën rurale janë mikrondërmarrje me një punonjës. Ndërmarrjet mbi 10 punonjës e lart përbëjnë rreth 9 % të numrit gjithsej të ndërmarrjeve, por ato mbulojnë rreth 42 % të punësimit të zonës rurale. Ndërmarrjet e këtij grupi janë kryesisht ndërmarrje shtetërore me aktivitet industrial, por zënë vend edhe ato me aktivitet tregtar dhe shërbimi, në të cilat janë punësuar 46 % e punonjësve të zonës rurale.

Në ndarjen sipas origjinës, numrin më të madh e zënë ndërmarrjet me pronarë vendas me rreth 76 %, ndërsa diferencat janë ndërmarrje të përbashkëta ose me pronarë të huaj.

Deri në fund të 1997, ndërmarrjet e mbyllura, duke marrë parasysh vetëm vdekjen legale nëpërmjet deklaratës së mbylljes së aktivitetit, përbëjnë rreth 25 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara deri tani dhe kanë pasur të punësuar afro 65,000 punonjës.

Nga analiza e grupit të ndërmarrjeve të mbyllura, rezulton se 3.5 % e tyre kanë qenë shtetërore dhe 96.5 % private. Vetëm 59 % e numrit të papunëve për shkak të mbylljes së ndërmarrjeve kanë qenë

punësuar në ndërmarrje shtetërore dhe 41 % në ato private. Rreth 82 % e ndërmarrjeve të mbyllura të sektorit privat i përkasin grupit të ndërmarrjeve me statusin e personit fizik, në të cilat kanë qenë punësuar gati 30 % e punonjëve të grupit të ndërmarrjeve të mbyllura.

#### Gjendja e ndërmarrjeve gjatë vitit 1997

Gjatë vitit 1997 një pjesë e mirë e ndërmarrjeve shtetërore dhe private pësuan dëme të konsiderueshme, duke u detyruar të ndërprisnin pjesërisht apo tërësisht aktivitetin ekonomik. Pasi subjekte ekonomike që u shkatërruan plotësisht. Duke u mbështetur në informacionin e mbledhur nga anketa që INSTAT realizoi në terren gjatë muajit janar 1998 pranë ndërmarrjeve industriale, të shërbimit dhe të bankave rezulton se mbi 19 % e ndërmarrjeve të anketuara janë mbyllur duke ndërprerë kështu aktivitetin e tyre. Nga këto 60 % janë ndërmarrje me aktivitet shërbimi dhe rreth 38 % janë ndërmarrje industriale.

Ndër subjektet e mbyllura mbi 16 % janë plotësisht të shkatërruara dhe dëmi llogaritet përafërsisht 1777.5 mln lekë. Më shumë se 25 % e ndërmarrjeve të shkatërruara plotësisht janë në rrethin e Shodrës. Këtu përfshihen edhe ndërmarrje të njohura si ndërmarrja e prodhimit të këpuëve ADELCHI - SIKUPÉRIA me mbi 2,000 të punësuar, ndërmarrja ITAL - YEX me rreth 100 të punësuar, ALMAC shpk ose mbi 60 të punësuar etj.

Rreth 30 % të ndërmarrjeve të shkatërruara e zënë ndërmarrjet e përbashkëta me partnerë të huaj, kryesisht italianë. Pothuajse gjysma e ndërmarrjeve të shkatërruara janë ndërmarrje industriale të mosme me mbi 20 të punësuar dhe të mëdha me mbi 200 të punësuar.

Një tjetër tregues që tërheq vëmendjen është mbyllja e aktivitetit privat dhe largimi nga vendi i drejtuesve të firmave private për shkak të pasigurisë dhe rrezikshmërisë. Në totalin e ndërmarrjeve të mbyllura këto zënë rreth 27%. Duke u referuar rezultateve të anketes vërehet se ndërsa ndërmarrjet private të mbyllura zënë mbi 60 % të atyre të mbyllura gjithsej, nga këto mbi 40 % janë ndërmarrje të mbyllura që drejtimi u është larguar jashtë vendit.

Në ndërmarrjet e mbyllura, mbi 50% e zënë ndërmarrjet e fjetura, të cilat sot për sot nuk funksionojnë, por që janë shprehur se në të ardhmen mund ta rifillojnë aktivitetin e tyre. Këto janë kryesisht ndërmarrje shtetërore në procesin e privatizimit ose të ristrukturimit.

Tabela 7 - Madhësia e Ndermarrjeve sipas Tipit

	Madhësia e ndërmarrjes	Firma vendase	Firma të përbashkëta	Firma të huaja
1	Me 1 punonjës	76.2	12.4	11.4
2	Me 2-10 punonjës	73.5	18	8.5
3	Me mbi 10 punonjës	75.5	16	8.5

Burimi: INSTAT 1998

## **Tregu i Punës dhe Papunësia**

Deri në fund të vitit 1990 ekonomia shqiptare ishte një ekonomi e centralizuar dhe përbëhej nga dy sektorë, sektori shtetëror i përqëndruar kryesisht në qytete dhe qendra të banuara, si dhe sektori kooperativist i përqëndruar tërësisht në zonat fshatare.

Në vitin 1991, skema e punësimit u bë më komplekse, si rezultat i zbatimit të Ligjit për token dhe Ligjit për privatizimin. Ajo përfshin :

- **punësimin në sektorin shtetëror** të ekonomisë i cili përbëhet nga punësimi në ndërmarrjet shtetërore, në ndërmarrjet e përbashkëta dhe në institucionet buxhetore qendrore e lokale;

- **punësimi në sektorin privat jo bujqësor** i cili përbëhet nga të vetëpunësuar (persona fizikë dhe juridikë) si dhe të punësuar në to;

- **punësimi në sektorin privat bujqësor**, i cili përbëhet nga bujq privatë;

Duke iu referuar të dhënave statistikore për punësimin vërehet se që prej vitit 1990 e në vazhdim numri i të punësuarve në Shqipëri ka pësuar rënie të vazhdueshme. Kështu, ndërsa në fund të vitit 1990 numëroheshin më shumë se 1,4 milion të punësuar, në fund të vitit 1997 kjo shifër është ulur në 1,1 milion. Në vitin 1990 shkalla e pjesëmarrjes në punë ka qenë mbi 75 %, ndërsa në fund të vitit 1997 është ulur në afro 60 %. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i procesit të privatizimit të degëve të tregtisë, shërbimeve publike, ndërtimit, si dhe një pjesë të industrisë së lehtë e ushqimore, mbylljes së mjaft ndërmarrjeve jo rentabël dhe reformës në administratën shtetërore.

Papunësia në Shqipëri përbën një problem social shumë të ndjeshëm. Periudha e tranzicionit 1992 - 1994 u shoqërua me nivele papunësie mjaft të larta, afro 400 mijë të papunë të regjistruar. Në vitet 1995 dhe 1996 numri i të papunëve të regjistruar shënoi një rënie deri në 158 mijë të papunë, kjo jo dhe aq për faktin se u hapën vende te reja pune, por sepse shumë të papunë, pasi mbaronin afatin e përfitimit të pagesës së papunësisë, shkuroheshin dhe nuk regjistroheshin më në zyrat e punës. Në vitin 1997 numri i të papunëve të

regjistruar ka ardhur duke u rritur vazhdimisht, deri sa në muajin dhjetor 1997 arriti në 194 mijë të papunë të regjistruar. Gjate vitit 1998 papunësia është rritur mesatarisht 4 - 5 mijë vetë në muaj. Kjo rritje është edhe më e theksuar në pjesën e dytë të vitit.

Duke iu referuar të dhënave statistikore për të papunët e regjistruar vërehet se përqindjen më të lartë e zënë ata të grupmoshës 21 - 34 vjeç. Në vitin 1994 kjo kategori zinte gati 50 % të të papunëve të regjistruar, po kështu në fund të vitit 1997 kjo shifër vijon të mbetet përsëri e lartë, më shumë se 45 %.

Grupimi i të papunëve të regjistruar sipas gjinisë tregon se nuk ka dallime të theksuara gjinore. Përqindjet femra - meshkuj nga viti 1993 e deri në fund të vitit 1997 janë variojnë në kufinj të 45 dhe 55 përqind.

Sipas të dhënave të bilancit të forcave të punës në regjistrimin e fundit të popullsisë, popullsia ekonomikisht aktive zë mbi 83 % të popullsisë në moshë pune, ndërsa sipas bilancit të vitit 1997 popullsia ekonomikisht aktive zinte afro 70 % të popullsisë në moshë pune. Shkalla e papunësisë në vitin 1989 ishte 7,3 % dhe në fund të vitit 1997, 14,9%.

Në numrin e të papunëve të regjistruar gjithsejt një përqindje mjaft të lartë zënë të papunët e regjistruar në zonat qytetare. Ndërsa në fund të vitit 1994 të papunët e regjistruar në qytet zinin mbi 80 % të totalit të të papunëve, në fund të vitit 1997 kjo përqindje është rritur ndjeshëm, mbi 94 %.

Numri i kryefamiljarëve të regjistruar si të papunë në zyrat e punës është rritur vit pas viti. Në fund të vitit 1994 afro 33 % e të papunëve të regjistruar ishin kryefamiljarë, ndërsa në fund të vitit 1997, kryefamiljarë të papunë janë mbi 44 % e të papunëve të regjistruar. Duke iu referuar të dhënave statistikore mbi të papunët e regjistruar sipas shkallës arsimore vërehet se, gjatë periudhës 1993 - 1997 afro 50 % e të papunëve të regjistruar kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe të lartë.

Karakteristikë e tregut të punës në Shqipëri është papunësia afatgjatë, e cila u shfaq në fund të vitit 1992. Kolapsi i ekonomisë dhe mungesa e investimeve e bënë të pamundur gjetjen e një vendi pune

**Grupimi i të papunëve të regjistruar sipas gjinisë tregon se nuk ka dallime të theksuara gjinore.**

gjatë kësaj periudhe. Në fund të vitit 1993 papunësia afatgjatë zinte afro 65 % të të papunëve të regjistruar, ndërsa në fund të vitit 1997 zë 84 %. Gati gjysma e të papunëve afatgjatë të regjistruar në fund të vitit 1997 kanë mbaruar shkollën e mesme dhe të lartë. Pothuajse 60 % e të papunëve afatgjatë janë të rinj, deri 34 vjeç.

Niveli i diferencuar i papunësisë midis rretheve dhe rajoneve të ndryshme të Shqipërisë është një tjetër veçori e tregut të punës. Ka rrethe të vendit si Kurbini, Kuçova, Kukësi, Shkodra etj., ku shkalla e papunësisë në fund të vitit 1997 është sa dyfishi i nivelit mesatar në shkallë vendi. Gjatë periudhës 1993 - 1997 nivelin më të lartë të papunësisë e ka patur zona verilindore e vendit. Kështu në fund të vitit 1993 shkalla e papunësisë së regjistruar në këtë zonë ka qenë 25 %, ndërsa në fund të vitit 1997 ajo është 16 %. Diferenca në nivelin e papunësisë vërehen edhe midis rretheve që i përkasin të njëjtës zonë gjeografike. Kështu për zonën gjeografike jugore, ndërsa shkalla e papunësisë për rrethin e Devollit është 3 %, për rrethin e Vlorës arrin rreth 22 %.

# KAPITULLI 3 KOHEZIONI SOCIAL

## 3.1. Tablo Sociale e periudhës 1991-1998

### Ndryshimet demografike

Migrimi masiv dhe rishpërndarja e popullsisë sollën ndryshimin e strukturës së popullsisë në moshë pune dhe ndryshuan bilancin në tregun e punës, gjë që shpesh herë çon në rritje të papunësisë. Por, në të njëjtën kohë, migracioni i brendshëm solli edhe një riurbanizim, apo mbipopullim të disa rajoneve të vendit, që u shoqërua me ndryshime të mëdha sociale dhe ekonomike të këtyre zonave. Nga ana tjetër, vetë ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike në vend, gjatë tranzicionit në vazhdim, sollën lindjen, ndryshimin dhe shpesh herë, përshpejtimin e fenomeneve demografike.

Në vitin 1990 Shqipëria kishte një popullsi të barabartë me rreth 3.286 milionë, me një ritëm vjetor rritjeje rreth 2.01 % për periudhën 1980-1990. Ritmi i lartë i rritjes së popullsisë ishte rezultat i një niveli të lartë lindshmërie gjatë gjithë

asaj periudhe, rreth 3.02 fëmijë për grua në vitin 1990 (më i larti në Evropë), dhe një niveli të ulët vdekshmërie. Në vitin 1990 Shqipëria kishte një ndërjetëgjatësi të mesatare më të larta në Evropën Lindore, dhe ndër vdekshmëritë adulte më të ulta të Evropës.

Treguesi i migracionit ishte plotësisht i neglizhueshëm, si rezultat i mbylljes së plotë të shoqërisë shqiptare. Pas vitit 1990, tranzicioni politik, social dhe ekonomik solli ndryshime të mëdha edhe në regjimin demografik. Kështu një emigracion masiv filloi në vitin 1990, i cili vazhdon edhe sot. Rreth 15 % e popullsisë shqiptare llogaritet të ketë emigruar në një periudhë shumë të shkurtër kohe, në afro 7 vjet.

Lindshmëria në Shqipëri ka qenë dhe mbetet e lartë. Në vitin 1995 indeksi i pjellshmërisë ishte rreth 2.7 fëmijë për grua, gjë që e pozicionon Shqipërinë në vendin e parë në Evropë për sa i përket lindshmërisë. Me ndryshimet social-ekonomike që ndodhën në vend gjatë këtyre viteve të fundit, parashikohet që niveli i lindshmërisë të bjerë. Kjo është e

*Tabela 8 - Treguesit demografikë për periudhën 1990-1996*

Indicators	1990	1992	1993	1994	1995	1996
Popullsia (000)	3,286	3,190	3,167	3,202	3,249	3,283
Lindjet	82,125	75,429	67,730	72,179	72,081	68,358
Vdekjet	18,193	18,026	17,868	18,342	18,060	17,600*
Koef. Bruto i lindshmërisë	25.0	23.7	21.4	22.6	22.2	20.8
Koef. Bruto i vdekshmërisë	5.4	5.7	5.7	5.7	5.6	5.4

\*): Te dhëna operative

Burimi: INSTAT (1998) Shqipëria në Shifra, Tiranë

**Me krijimin e një shoqërie demokratike njerëzit kanë të drejtën dhe lirinë e lëvizjes, por nga ana tjetër ekziston pamundësia e përballimit nga pikëpamja ekonomike dhe sociale e këtyre lëvizjeve.**

lidhur me faktorë të ndryshëm, por ndër më kryesorët është migracioni i madh i popullsisë në moshë riprodhuese. Po të konsiderojmë strukturën moshore të emigrantëve shqiptarë në Itali (emigracioni i shqiptarëve në Itali është më i evidencuar) do të arrinim në përfundimin se mëse 83 % e emigrantëve janë të moshës 19-40 vjeç, kundrejt numrit total të emigranteve që arrin në afro 420 mijë. Kjo do të thotë gjithashtu, se, mëse 40 % e popullsisë së përfshirë në këtë grupmoshe ka emigruar jashtë vendit. Ky fenomen do të ketë një efekt kohor të theksuar në të ardhmen e lindshmërisë në Shqipëri. Ndikim të rëndësishëm në uljen e lindshmërisë do të ketë edhe ligjërimi i abortit pas ligjit të miratuar në vitin 1991, si dhe përhapja e mjeteve të kontracepcionit, me gjithë edukimin e ngadalshëm për përdorimin e tyre për arsye të ekzistencës së një shoqërie tradicionale.

Vdekshmëria në Shqipëri ka qenë e ulët dhe vazhdon të mbetet e tillë. Niveli i lartë i vdekshmërisë foshnjore është tipar i veçantë i saj. Shqipëria ka koeficientin më të lartë të vdekshmërisë foshnjore në Evropë, me afro 43.3 vdekje për 1000 të lindur gjallë. Niveli i ulët i vdekshmërisë të të rriturit në Shqipëri është karakteristikë tjetër kryesore. Në fund të vitit 1990, Shqipëria kishte një ndër nivelet e vdekshmërisë adulte më të ulta në Evropë, të njëjtë me Greqinë, Italinë, Spanjën etj. Sidoqoftë niveli i përgjithshëm i vdekshmërisë në Shqipëri është i ulët, me një jetëgjatësi mesatare afro 72 vjet gjatë periudhës 1990-1995.

Ngjarjet e vitit 1997 do të kenë një efekt kohor të veçantë në treguesit e vdekshmërisë për Shqipërinë gjatë kësaj periudhe. Duke pasur parasysh se gjatë vitit 1997 ndodhën mëse 2000 vdekje si rezultat i trazirave, kjo do të thotë që numri i përgjithshëm i vdekjeve do të rritej rreth 12 % në krahasim me vitin 1996. Natyrisht që ky fenomen do të influencojë më shumë të vdekshmëria adulte e meshkujve, ku edhe kanë ndodhur më shumë vdekje.

Mbi bazën e vlerësimit të Drejtorisë së Emigracionit për Shqipërinë, numri i përgjithshëm i emigrantëve përgjatë viteve 1990-1997 është afro 500,000 vetë. Duke patur parasysh edhe statistikat e lindjeve

dhe të vdekjeve të botuara nga Instituti i Statistikës, popullsia e Shqipërisë e vlerësuar për vitin 1997 është rreth 3.22 milionë, ose rreth 60,000 banorë më pak se në vitin 1990. Kjo do të thotë që gjatë periudhës 1990-1997, Shqipëria ka pasur një ritëm negativ rritjeje të popullsisë.

### **Urbanizim apo Mbipopullim**

Mbas vitit 1990 ndryshimi në strukturën e popullsisë ka sjellë edhe dy tipe të migracionit të brendshëm: migracionin nga fshati në qytet dhe migracionin nga zonat periferike drejt qyteteve të mëdha, veçanërisht Tiranës.

Ndryshimi i menjëhershëm i strukturës politike në Shqipëri, në fillim të viteve nëntëdhjetë, solli edhe një ndryshim të madh të strukturës social-ekonomike të vendit. Shumë njerëz nisën të braktisin fshatin me synimin për të gjetur punë në qytet. Ky fenomen erdhi duke u theksuar nga njëri vit në tjetrin dhe, njëkohësisht, u shoqërua me një lëvizje të popullsisë nga Veriu dhe Jugu i vendit drejt qyteteve të mëdha si Tirana e Durrësi. Kështu më 1997 popullsia në Prefekturën e Tiranë arriti shifrën 568,758 vetë, ose afërsisht 18 % e popullsisë së vendit. Kjo shpjegohet me zhvillimin më të madh të qendrave kryesore.

Fenomeni i zgjerimit të qyteteve kryesore industriale ishte i prishëm për një shoqëri ku më 1990 mbizotëronte popullsia fshatare me afro 64 %. Por, urbanizimi i menjëhershëm në këto 7 vitet e fundit është shoqëruar me probleme të ndjeshme sociale. Kështu, për shembull, rrethi i Tiranës është rritur afro 30 % në krahasim me vitin 1990, por infrastruktura për të përballuar këtë rritje pothuajse nuk ka ndryshuar. Pra, ekziston një mospërputhje midis rritjes së numrit të madh të popullsisë në qytetet kryesore dhe ritmeve të ulta të zhvillimit të infrastrukturës për të përballuar rritjen e popullsisë.

Ky fenomen, megjithëse i natyreshëm, paraqitet tepër kontradiktor në kushtet e Shqipërisë. Me krijimin e një shoqërie demokratike njerëzit kanë të drejtën dhe lirinë e lëvizjes, por nga ana tjetër ekziston pamundësia e përballimit nga pikëpamja ekonomike dhe sociale e këtyre lëvizjeve. Prandaj dukuria e riurbanizimit apo



mbipopullimit është problemi kryesor që autoritetet lokale po ndeshin sot në Shqipëri. Përsa kohë qeveria dhe autoritetet lokale nuk do të krijojnë kushtet për përmirësimin e infrastrukturës dhe integrimin social të këtyre njerëzve, ky fenomen do të mbetet një mbipopullim, që do të vazhdojë të krijojë probleme të rënda sociale për popullsinë e këtyre qyteteve, veçanërisht të Tiranës.

### **Emigracioni masiv**

Shqipëria ka përjetuar një fenomen masiv emigrimi nga viti 1990. Ky komponent i rëndësishëm i regjimit demografik, ishte pothuajse i shpërfillur para vitit 1990, kur shoqëria shqiptare ishte një shoqëri e mbyllur ndaj lëvizjeve migruese. Mbas vitit 1990, komponenti përcaktues i regjimit demografik bëhet emigracioni.

**Italia dhe Greqia mbeten vendet kryesore të emigrimit të shqiptarëve.** Kjo konfirmohet edhe nga të dhënat e studimeve të kryera mbi emigracionin shqiptar. Kjo lëvizje kushtëzohet si nga afërsia gjeografike dhe kulturore e shqiptarëve me italianët dhe grekët, ashtu edhe nga pamundësia për zgjidhje të tjera për të emigruar në mënyrë ligjore e të rregullt. Në Greqi rezultojnë aktualisht 350-400,000 vetë, ndërsa në Itali rreth 100-150,000 emigrantë shqiptarë (duke përfshirë edhe familjarët). Sipas informacioneve të marra nga ambasadat e shteteve perëndimore në Tiranë, disa mijëra shqiptarë gjenden gjithashtu edhe në vende të tjera perëndimore si në SHBA (rreth 10,000), Gjermani (rreth 12,000), Belgjikë (rreth 2,500), Francë (rreth 2,000), Turqi (rreth 2,000), Kanada, Zvicër etj. Sipas të dhënave të përafërta të studiuësve, në Greqi ndodhet aktualisht 1 shqiptar për 25-30 grekë, ndërsa në Itali ky raport është 1 me 400-450. Pra, prania e shqiptarëve në Greqi është afro 15-20 herë më e madhe se prania e tyre në Itali. Ndërkohë, problematika që ndeshin emigrantët dhe instalimi i tyre në punë e shoqëri është pak a shumë në të njëjtin nivel.

**Gjatë vitit 1997 Shqipëria ka pasur tregues jo normalë në raportet**

**emigracion legal / klandestin.** Në fillim të vitit 1997, në Itali figuronin të legalizuar rreth 62,000 emigrantë shqiptarë, ndërkohë që numri i përgjithshëm i emigrantëve shqiptarë në këtë vend (legalë dhe klandestinë) ishte rreth 100,000 (Caritas di Roma, 1997). Shpërpjestimi emigrantë legalë - ilegalë në favor të këtyre të fundit ishte më i theksuar në Greqi, ku në të njëjtën periudhë, ndër afro 350,000 qytetarë shqiptarë që jetonin në këtë vend, të legalizuar nuk ishin më shumë se 10,000 vetë.

Nga të dhënat e botuara del se rreth 78.6 % e emigrantëve shqiptarë janë ilegalë, që në shifra absolute është rreth 400,000 vetë dhe se, vetëm një numër tepër i vogël, afro 100,000 vetë janë emigrantë të legalizuar.

**Emigracioni shqiptar priret të jetë shumë herë më i lartë te meshkujt sesa te femrat.** Në Itali meshkujt zënë 70.9 % e emigrantëve legalë ndërsa në Greqi rreth 60.4 % e tyre.

Që prej vitit 1990 emigrimi vlerësohet si një nga rrugët kryesore për përballimin e jetesës dhe sigurimin e së ardhmes, sidomos ekonomike, të individit, familjes dhe të shoqërisë shqiptare. Për një kohë të gjatë, ai ka shërbyer si një amortizator i fuqishëm për zbutjen e konflikteve dhe tensioneve të brendshme, po të mbajmë parasysh karakteristikat e zhvillimeve shoqërore e politike në Shqipëri gjatë viteve të fundit, sidomos gjatë vitit 1997. Emigrimi mbetet, gjithashtu, një ndër faktorët më të rëndësishëm të mbijetesës ekonomike.

Shqipëria ka pasur gjatë viteve '90-të ritme mjaft të larta të emigrimit të popullsisë. Aktualisht ajo ka fluksin më të lartë të emigrimit në krahasim me gjithë vendet e tjera të Evropës Lindore e Qendrore. Të dhënat (të përafërta e të tërthorta) dëshmojnë se jashtë vendit ndodhet aktualisht rreth 15 % e popullsisë, ndërkohë që praktika migratore e vendeve në zhvillim, vendeve të Evropës Lindore, si edhe parashikimet e ekspertëve sugjerojnë, në fillim të viteve '90-të, një fluks mesatar deri 5-6 % të popullsisë aktive. Pra, ritmet e emigrimit të shqiptarëve janë rreth 3 herë më të larta se ritmet mesatare normale të emigrimit në kohën e sotme.

**Emigrimi ka qenë rrjedhojë jo vetëm i nevojave të zhvillimit ekonomik, por edhe i tensioneve politike e sociale në vend.**

Emigrimi ka qenë rrjedhojë jo vetëm i nevojave të zhvillimit ekonomik, por edhe i tensioneve politike e sociale në vend. Gjatë viteve '90-të, fluksit migratoro kanë qenë të çrregullta e të pakontrolluara. Ato kanë mbetur të tilla edhe gjatë vitit 1997. Përgjithësisht, vihen re raporte jo normale midis emigrimit aktiv dhe pasiv, në favor të këtij të fundit. **Emigrimi i shqiptarëve ka pasur ritme të larta të emigrimit familjar dhe fluks të madh të emigrimit të të miturve.**

Natyra dhe karakteri i zhvillimeve në vend, sidomos trazirat që shpërthyen në fillim të vitit 1997, bënë që **emigrimi i shqiptarëve të mbetet një dukuri e sunduar kryesisht nga veprimi i faktorëve shtytës sesa nga veprimi i faktorëve tërheqës, të cilët ishin mjaft veprues në një pjesë të popullsisë, sidomos në moshat e reja, në fund të viteve '80-të dhe fillimin e viteve '90-të.**

Pas 6-7 vjet përvoje migratore, veprimi i këtyre faktorëve rezultoi po aq i fuqishëm sa edhe në fillim të viteve 90-të. Veprimi i faktorëve shtytës ka ardhur duke u forcuar, dukuri që arriti kulmin në pranverën e vitit 1997, kur emigrimi i shqiptarëve evoluoi nga një emigrim klandestin në një emigracion të detyruar të njerëzve, të cilët lanë vendin për shkak të trazirave dhe pasigurisë së jetës. Fuqizimi i faktorëve shtytës ka ndodhur paralelisht me dobësimin relativ të veprimit të faktorëve tërheqës, si rezultat i përvojave migratore kontradiktore dhe pengesave të shumta e në rritje të emigrimit e integritimit në shoqëritë pritëse.

Megjithatë, faktorët kryesorë të emigrimit mbeten faktorët ekonomikë. Situata ekonomike e vendit dhe domosdoshmëria e rimëkëmbjes së shpejtë të tij, në kushtet e burimeve të brendshme të kufizuara, do të imponojë veprimin e këtyre faktorëve edhe për një periudhë jo të shkurtër kohore, disavjeçare.

Përsa i përket emigrimit të organizuar, Shqipëria ka marrëveshje të punësimit sezonal me Gjermaninë, nënshkruar më 1991, Greqinë, nënshkruar më 1996, dhe me Italinë, nënshkruar në vjeshtë të vitit 1997. Të dyja marrëveshjet e fundit kanë filluar të zbatohen më 1998.

### **Integrimi i emigrantëve shqiptarë**

Shkalla e integritimit të emigrantëve shqiptarë në të dy shoqëritë kryesore pritëse (greke dhe italiane) si dhe problematika e marrëdhënieve me popullsinë vendase janë të përafërta. Marrëdhëniet me institucionet dhe shërbimet sociale në të dy vendet kanë pak a shumë të njëjtën tipologji. Raporti emigrantë klandestinal-legal po shkon drejt një përafërimit, po të mbajen parasysh efektet e pritshme të dekretit presidencial për legalizimin e emigrantëve të huaj në Greqi, nënshkruar në nëntor 1997, si dhe krijimin e instrumenteve ligjorë e institucionale që e njohin Greqinë si një vend tipik unigrimi.

Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë, si në Greqi ashtu edhe në Itali janë të punësuar në ndërtim e në bujqësi (meshkujt) dhe në shërbimet shtëpiake (femrat).

Tipologjia e punësimit e emigrantëve shqiptarë dhe përqëndrimi i tyre në punë të vështira e të rëndomta ka penguar dhe pengon pjesërisht rolin e emigrantit në triçjen e formimit e kualifikimit profesional të emigrantëve dhe familjarizimin e tyre me teknikën e teknologjinë bashkëkohore, që aplikohet në vendet e emigrimit. Emigrimi dhe punësimi në këta sektore vepron më shumë si faktor i mbijetesës ekonomike të familjeve të emigrantëve, nëpërmjet sigurimit të të ardhurave sesa si një faktor integritimi, qytetërimi dhe emancipimi.

Pengesa më e madhe për integritimin e emigrantëve shqiptarë në shoqëritë pritëse është viktimizimi, kriminalizimi dhe demonizimi i pranisë së komunitetit të emigrantëve shqiptarë, sidomos në Itali dhe Greqi. Imazhi mbt emigrantët shqiptarë është, më së shumti, një imazh i akredituar nga shtypi e TV dhe jo nga fenomenologjia apo praktika e pranisë dhe e marrëdhënieve të tyre me popullsinë vendase. Studimet e ekspertëve të emigrimit në këto vende tregojnë se vlerësimet dhe opinionet negative për shqiptarët, përveçse nga faktorët e mësipërm, vijnë nga ato shtresa të popullsisë vendase, të cilat nuk kanë pasur kontakte me shqiptarët.

Fakti që shqiptarët janë të punësuar kryesisht në sektore marginalë, përfshirja e një pjese të tyre në punë të zezë e veprimtari ilegale; mosvëmendja e qeverive dhe autoriteteve shqiptare në drejtat e integritimit të tyre etj., e bën jetën asociative dhe komunitare të emigrantëve shqiptarë të zbehë e të papeshë. Kjo ka bërë gjithashtu që emigrantët shqiptarë të jenë pjesërisht të privuar nga të drejtat legjitime e institucionale që u takojnë, sipas normave dhe standarteve ndërkombëtare, si edhe nga shërbimet e ndryshme sociale në vendet pritëse.

## *Vonesa e emigracionit të kthyer*

Pas shtatë vjet përvoja migratore në vend ende nuk shihet asnjë investim serioz prej emigrantëve të kthyer, me përjashtim të disa investimeve sporadike në sferën e shërbimeve. Në vitin 1997 shqiptarët e gjejnë veten jo vetëm me fare pak ndryshime të dukshme në jetën dhe veprimtarinë e tyre në sajë të emigrimit, por po aq të motivuar për të emigruar sa edhe në fillim të viteve '90-të. Potenciali migrator i shoqërisë gjatë periudhës 1990 - 1997 nuk ka ardhur duke rënë. Ky potencial i lartë është një ndër pengesat më të mëdha për emigrimin e kthyer. Kjo situatë shkaktohet për arsye të përdorimit jo racional e jo të suksesshëm të të ardhurave të emigracionit, të zhvillimeve të komplikuar në vend, si edhe nga mungesa për një kohë të gjatë e një strategjie shtetërore e kombëtare për emigracionin, në veçanti për emigracionin e kthyer. Megjithatë, vihen re disa përpjekje për nxitje e kthimit të emigrantëve, siç është rasti i Gjermanisë, e cila ka filluar projekte kreditimi për emigrantët që kthehen për të filluar një biznes në Shqipëri. Në fund të vitit 1996 një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave prej emigracionit u thithën prej piramidave. Duke qenë ndër grupet e fundit të popullsisë (në kohë) që shërbyen si kreditorë të piramidave, emigrantët rezultojnë ndër grupet e popullsisë më të goditura nga rënia e tyre.

Sidoqoftë, shtyja kryesore e kthimit të emigrantëve është dështimi. Janë kthyer në s' shumti ato kategori emigrantësh, të cilët nuk kanë mundur të nguliten me sukses në shoqëritë pritëse, ose janë kthyer forcërisht nga policia e vendeve fqinje. Në kushtet e mbizotërimit të emigracionit klandestin, është e shpjegueshme dukuria e mospasjes. Marrëveshjet e nënshkuara kohët e fundit me vendet fqinje në fushën e emigrimit, duke vendosur në një pistë të re emigrimin e shqiptarëve, duke ndryshuar raportet emigracion klandestin - emigracion legal, priret të sjellin ndryshime pozitive në emigracionin e kthyer dhe të nxisin kthimin e emigrantëve të suksesshëm.

## **3.2. Marrëdhëniet Sociale Ndërmjet Njerëzve**

### *Cilësia e Marrëdhënieve: konfliktuale apo solidarizuese?*

**Në Shqipërinë e vitit 1997, e sidomos në gjysmën e parë të tij, në marrëdhëniet sociale mbizotëroi aspekti konfliktual.** Përveç faktorëve më të hershëm, ndikuan edhe një sërë faktorësh specifik të periudhës së tranzicionit dhe veçanërisht gjatë harkut kohor 1997-1998.

Si në të gjitha vendet e Lindjes edhe në Shqipëri ndryshimet filluan në sferën e politikës. Nga shkalla e reformave dhe koha e realizimit të tyre do të përcaktoheshin raportet e reja sociale dhe zgjidhjet e shumë konflikteve që u shfaqën me ndryshimin e sistemeve. Ishte politika që premtoi drejtësi sociale, zgjidhjen e çështjes së pronës dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës. Si rrjedhim, **duke qenë se politika mori përsipër përgjegjësi të mëdha, atëherë edhe shumica e konflikteve u ngjiten në skenën politike dhe u lidhën me protagonistët e jetës politike, partitë politike, qeveritarët, etj.** Ky politizim i theksuar i problemeve dhe sidomos polarizimi i jetës politike, përbën

nje faktor dominues përse marrëdhëniet shoqërore shkojnë drejt konflikteve.

Për shkak të problemit të pazgjidhur të pronave, niveli i integritimit që ka arritur shoqëria shqiptare gjatë periudhës 1991-1997 mbetet ende i ulët. Me rënien e komunizmit, për zgjidhjen e këtij problemi shtroheshin dy alternativa: një zgjidhje radikale duke ua kthyer pronat ish - pronarëve, ose prona të mbetej shtetërore dhe të gjendej një zgjidhje që të kënaqte si ish - pronarët edhe ata që nuk kishin pronë, por që kishin kontribuar në pasurinë kombëtare të krijuar gjatë viteve të komunizmit. Kështu, duke mos e llogaritur pasurinë kombëtare dhe duke mos hartuar një ligj të qartë për pronat, mbizotëruan marrëdhëniet konfliktuale ndaj atyre solidarizuese.

**Në shoqërinë shqiptare ende nuk ka zënë vend koncepti se shtet i së drejtës do të thotë, para së gjithash, ndarje e pushteteve dhe zëvendësim i shtrëngimit me marrëveshjen.** Kështu, duke mos realizuar një ndarje efektive dhe reale të pushteteve, jeta politike shqiptare u karakterizua nga një përqëndrim i theksuar i pushteteve në institucionin e presidentit, si dhe nga akuza të ndërsjellta ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij ligjor.

***Në shoqërinë shqiptare ende nuk ka zënë vend koncepti se shtet i së drejtës do të thotë, ndarje e pushteteve dhe zëvendësim i shtrëngimit me marrëveshjen***

**Prania e armëve në duart e popullsisë, si rezultat i hapjes së depove ushtarake në e fillim të vitit 1997, është një tjetër faktor potencial i ashpërsimit të marrëdhënieve sociale.**

Një tjetër arsye në mosrregullimin institucional që vazhdon edhe sot e kësaj dite, është mungesa e kushtetutës, e cila ka bërë që organizimi i hapësirës institucionale, sidomos në vitin 1997, të mos funksionojë siç duhet në shërbim të zgjidhjes së problemeve të shumta sociale.

Vështirësitë ekonomike, mungesa e shtetit të së drejtës dhe moskuptimi i lirisë në funksion të ligjit ndikoi në një lëvizje të pakontrolluar të popullsisë drejt qyteteve të mëdha, e cila vazhdoi në përmasa të gjera edhe gjatë vitit 1997, gjë që në ekzistencën e kushteve të mësipërme krijoi probleme të mprehta sociale. Në radhë të parë ato ishin probleme pronësie, pasi zënia e trojeve të reja ndeshi në reagimin e pronarëve të ligjshëm. Por do të kishte edhe probleme social - kulturore, si rezultat i disproporcioneve të akumuluar në zhvillimin ndërmjet krahinave të ndryshme.

Një ndikim të fuqishëm në natyrën e marrëdhënieve ka pasur edhe gjuha politike, e cila në kushtet e pluralizmit presupozohet të jetë e larmishme. Në realitet vihet re një gjuhë politike tepër e ashpër që synon shkatërrimin e kundërshtarit dhe jo pranimin e tij. Në Shqipëri gjuha e pushtetit ka më fort natyrë justifikuese. Gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike deri në mars 1997, justifikimet në mosrealizimin e premtimeve gjendeshin te segmentet e fshehta të regjimit komunist. Për koalicionin aktualisht në pushtet, gjuha e justifikimit i referohet gjendjes së mjeruar në të cilën e gjeti vendin prej qeverisjes së keqe të mëparshme.

Në krijimin e klimës konfliktuale ka ndikuar edhe shtypi shqiptar. Shtypi partiak në përgjithësi është tepër agresiv dhe denigrues ndaj kundërshtarit politik. Madje dhe shtypi i pavarur, në periudhat e nxehta të jetës politike shqiptare është pozicionuar në krah të kësaj apo asaj force politike. Fjala e shkruar dhe media elektronike luajnë një rol të madh në krijimin e klimës së paqes sociale sidomos në Shqipëri, një vend që ende nuk është familjarizuar me shtypin e lirë.

Prania e armëve në duart e popullsisë, si rezultat i hapjes së depove

ushtarake në e fillim të vitit 1997, është një tjetër faktor potencial i ashpërsimit të marrëdhënieve sociale.

Bashkësia e këtyre faktorëve që ndikojnë në konfliktualitetin e marrëdhënieve të shoqërisë shqiptare, të cilët edhe mund të justifikohen në një farë mase me ndryshimin e sistemeve, ka bërë të domosdoshme nxitjen e marrëdhënieve solidarizuese. Sidomos të domosdoshme i bëjnë këto marrëdhënie çështja kombëtare si edhe kërkesat për stabilitetin institucional dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Gjuha e përbashkët që u gjet nga forcat politike shqiptare në qëndrimin rreth ngjarjeve në Kosovë në mars 1998, është një shenjë e emancipimit politik dhe e shpresës se cilësia e marrëdhënieve mund të shkojë drejt solidaritetit dhe jo ashpërsimit të mëtejshëm të frymës së konfliktit.

**Një hap prapa : Kthimi i së vjetrës**

Gjallërimi i zakoneve të vjetra, veçanërisht dukuria e gjakmarrjes, edhe pse e kufizuar gjeografikisht, kryesisht në rajonet e Shqipërisë së Veriut dhe të Verilindjes, përbën një nga shqetësimet e vazhdueshme të shoqërisë shqiptare të periudhës paskomuniste. Shkaqet e kesaj dukurie, e cila konsiderohej thujse e zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, kanë të bëjnë sa me faktorë historikë, aq dhe me faktorë politikë, ekonomikë dhe shoqërorë. Por, shkaku kryesor duhet kërkuar te tronditjet e forta që pësoi sistemi i vlerave në shoqërinë shqiptare pas rënies së komunizmit dhe, sidomos, te vakuumi i krijuar në jetën e bashkësive të zonave më të thella të Veriut të vendit, nga një shtet i cili nuk arriti ta shtrinte plotësisht autoritetin e vet. Kriza e vlerave, mungesa e modeleve të qëndrueshme sociale, shoqëruar me vakuumin administrativ dhe praninë e pamjaftueshme të shtetit, solli që mjaft nga bashkësitë malësore të prireshin drejt modeleve të vjetra patriarkalo-fisnore, te sistemi vetërregullues i Kanunit, i cili kishte shërbyer shpesh në të kaluarën, gjatë periudhës së sundimit otoman, për të kompensuar mungesën e pranisë së pushtetit qendror.

Fenomeni i gjakmarrjes u rishfaq në Shqipëri pas viteve 90-të, në periudhën e tranzicionit, në përmasa të kufizuara dhe vetëm në disa zona të Shqipërisë Veriore e Verilindore. Në vitet 1992-1995 rreth 8 % e numrit të përgjithshëm të vrasjeve kryheshin për motive gjakmarrjeje. Ndërkohë gjatë vitit 1997, 28.8 % e vrasjeve ishin për hakmarrje dhe vetëm 3.6 % për gjakmarrje. Nga anketimet në zonat ku është më e përhapur gjakmarrja, rezulton se dukuria e gjakmarrjeve të vjetra shkon drejt uljes ose shuarjes, ndërkohë që hakmarrjet e gjakmarrjet e reja përbëjnë një problem shqetësues.

Gjithsesi, kjo dukuri me dualizmin juridik që sjell, flet në radhë të parë për dobësinë dhe paefektshmërinë e theksuar të institucioneve të shtetit dhe është pjesë e krizës së përgjithshme politike, shoqërore, ekonomike, organizative, juridike e psikologjike që përjeton shoqëria shqiptare. Në këtë aspekt mund të thuhet se çorganizimi shoqëror çoi në çorganizimin individual. Në një anketim të bërë në vitin 1996 në 14 rrethe të vendit (me 1200 vota), rezultoi se rreth 70 % e të anketuarve nuk kishin besim te gjykatat. Po t'i shtojmë këtij fakti edhe mangësitë në funksionimin e policisë, të prokurorisë për një hetim të shpejtë e të drejtë të krimeve, dënimet e padrejta (analizat tregojnë se krimet e vrasjes me dashje në mbi 50 % të rasteve janë dënuar lehtë nga gjykatat, gjë që në disa raste ka sjellë që fajtorët e nxjerrë nga burgu të vriten nga familjarët e viktimës), si dhe pezullimi i dënimit me vdekje, pas angazhimit të Shqipërisë para Këshillit të Evropës, atëherë kemi një tablo më të saktë të kuadrit që solli gjallërimin e fenomenit të vetëgjyqësisë. Këtij kuadri i duhet shtuar dhe faktori ekonomik, shpërbërja e pronës kooperativiste, ligji për ndarjen e tokës dhe privatizmi, të cilët krijuan hapësirë për veprimin e normave të Kanunit. Po ashtu migrimi në masë dhe i pakontrolluar i njerëzve nga zonat e thella malore në ato fushore apo rrethinat e qyteteve, krijoi në jo pak raste kolizion zakonesh e traditash dhe një reagim konservativ të grupeve të të sapoardhurve, sipas normave të Kanunit, duke shkaktuar konflikte, deri dhe vrasje,

për çështje trojesh e tokash të zaptuara.


Të gjitha këto dukuri morën përmasa shqetësuese gjatë pjesës së parë të vitit 1997, kur shembja thuajse e plotë e shtetit, anarkia, kaosi, hapja e depove të ushtrisë dhe armatosja masive e popullsisë, dalja e të burgosurve nga burgjet, shtuan dukshëm rastet e vetëgjyqësisë dhe të hakmarrjes. Fillimi i normalizimit të jetës së vendit pas zgjedhjeve të qershorit 1997 është duke sjellë edhe pakësimin gradual të kësaj plage shoqërore. Por vetëm konsolidimi i institucioneve demokratike, mbushja e vakuumit administrativ dhe forcimi i shtetit do të zhdukë këtë dukuri që po shoqëron tranzicionin shqiptar.

### ***Krimi: Një sfidë e vështirë***

Rëndimi i situatës ekonomike e politike në fillim të vitit 1997, solli një rritje galopante të kriminalitetit dhe të agresivitetit. Ndikim të madh pati, gjithashtu, armatosja masive e popullsisë dhe anarkia e krijuar nga shkatërrimi i shtetit.


Sikurse edhe në vendet e tjera të tranzicionit, veçanërisht në Shqipëri, zgjerimi i menjëhershëm i lirive të individit dhe tejkalimi i tyre përtej ligjit, krijoi kushte të volitshme për gjallërimin e krimit. Këtu ndikoi mosfunksionimi i mirë i shtetit, roli rregullator i të cilit nuk u ndje kur ndodhte prerja e rrathëve të lirisë së një individi me ato të një individi tjetër. Si rezultat numri i krimeve ka ardhur duke u rritur dhe ndërkohë u krijuan kushtet për lindjen dhe zhvillimin e krimit të organizuar.

**Figura 15 - Llojet e Krimeve ne Vitin 1997**




Burimi: Ministria e Rendit Publik

**Figura 16 - Krimi i Vrasjes në disa Rrethe të Vendlit**




Burimi: Ministria e Rendit Publik

**Figura 17 - Grupmoshat e Autoreve të Krimeve**




Burimi: Ministria e Rendit Publik

**Figura 18 - Motivet e Krimin të Vrasjes për Vitin 1997**



**Figura 19 - Arsimimi i Autoreve të Krimeve**



Burimi: Ministria e Rendit Publik

Krimi i vrasjes ka qenë lloji më i shpeshtë i krimin gjatë vitit 1997: Vrasjet zënë afro 51 % të numrit të përgjithshëm të krimeve, ndërsa rreth 33 % e zënë tentativat për vrasje.

Në krahasim me vitin 1996, gjatë vitit 1997 numri i vrasjeve rezultoi 5 herë më i lartë. Ai është rritur në mënyrë të dukshme pothuajse në të gjithë rrethet e vendlit, por në mënyrë të veçantë në rrethin e Vlorës. Vloza dhe Tirana ishin rrethet me numër më të madh vrasjesh.

Ndër motivet e krimin të vrasjes mbizotërojnë vrasjet për motive të dobëta (afro 44 %), si dhe ato për motiv hakmarrjeje (rreth 29 %).

Rreth 53 % e krimeve janë kryer nga të mitur e të rinj deri në moshën 26 vjeç. Në fakt, bandat e adoleshentëve e të rinjve të armatosur, me një nivel të ulët arsimor, me origjinë sociale nga shtresat e ulta e vendbanim zonat heterogjene, përbëjnë një fenomen të dukshëm shqiptar të karakterit social e psikologjik që ka ndikuar në rritjen e kriminalitetit. Në kushtet e lëvizjes së lirë dhe zhvendosjeve të ndjeshme të popullatës nga zonat malore në rrethinat e qyteteve të mëdha apo edhe brenda tyre në zona të caktuara, gjatë kësaj periudhe, ashtu si gjatë gjithë harkut kohor 1992-1998, u krijuan premisa për mikromjedise heterogjene, basifonde, zona midis atyre urbane e rurale, me kushte tepër të volitshme për lindjen dhe formimin e grupeve të tilla.

Kjo shpjegohet edhe me humbjen e ndikimit të mikromjedisit specifik shqiptar, domethënë të lagjes, rrugës, pallatit, i cili ka qenë mjaft i theksuar më parë, në krahasim me vendet e zhvilluara.

Veç plagëve sociale, varfërisë, privacioneve të së kaluarës, prirjes për rritjen e menjëhershme të mirëqenies pas 45 vjetësh varfëri, nëpërmjet rrugësh shpesh jo ligjore, në rritjen e kriminalitetit të të rinjtë, ka ndikuar shumë edhe niveli kulturor e arsimor. Nga statistikat, rreth 77 % e autorëve të krimeve nuk kanë kryer ose kanë kryer vetëm arsimin 8 vjeçar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e krimeve kryhen nga njerëz me nivel të ulët kulturor e arsimor. Pa dyshim, faktori motivues (grindjet, urrejtjet, xhelozitë etj.), ai i

temperamentit, i vrullit, gjaknxehtësisë, fuqisë rinore, ai ekonomik apo i lidhur me pronën private (ndarja e tokës, e pasurisë etj.) kanë rolin e tyre në mjaft raste. Megjithatë, ato do të zbeheshin shumë në rastin e një niveli kulturor të ngritur, së paku për krime të nivelit tejet ordiner, që janë jo të pakta. Jo më kot krimi në radhët e rinisë studentore, si shtresë e një niveli intelektual e kulturor më të ngritur, shfaqet tepër rrallë.

Një faktor tjetër i lulëzimit të krimit është efekti i kundërt i izolimit dhe komprimimit të gjatë 45 vjeçar të Shqipërisë, efekt ky i shfaqur në formën e shpërthimit të një lirie të tepruar, veçanërisht në moshat e reja. Në këto moshë krimi është dominuar nga shkaqe të brendshme si urrejtja, dëshira për pasurim të shpejtë, xhelozia, prona, varfëria, por kanë ndikuar edhe faktorë të jashtëm si ana spektakolare, aventurat etj. Kështu që ai është shfaqur si veprim personal, por dhe si imitim. Megjithëse aspekti i dytë mund të duket më pak i rëndësishëm, nuk duhet harruar se herë-herë krimi ka filluar edhe nga një zënkë, nga një armë e mbajtur pa leje, nga një vjedhje ordinere dhe ka përfunduar në krime të rënda. Raste të tilla kanë qenë më të shpeshta gjatë vitit 1997. Gjatë këtij viti u bë e zakonshme që sapo ndodhte një krim i një lloji të ri apo të veçantë, menjëherë pas tij ndodhnin të tjerë të ngjashëm. Ndodhte një vrasje spektakolare në mes të qytetit dhe menjëherë pas saj ndodhnin dhjetëra vrasje të tjera të këtij lloji. Ndodhte një rrëmbim apo grabitje shtëpie dhe menjëherë dhjetëra të tjera; ndodhi një shpërthim masiv në mes të Tiranës dhe menjëherë pas tij pati shpërthime në rrethe të tjera.

Kur individit bëhet apo ndjehet anonim, i fshehur mes turmës e bandës apo kur maskohet, ai vepron më lirisht dhe premisat për kriminalitet rriten. Kjo formë agresiviteti u shfaq hapur në Shqipëri në periudhën e mungesës së shtetit e të anarkisë së vitit 1997. Banda të armatosura e të maskuara kryesisht adoleshentësh grabisnin madje edhe ditën në mes të rrugës udhëtarë, automjete etj., aq sa u bë pothuaj e pamundur të udhëtoje nëpër Shqipëri. Mjediset heterogjene i

favorizuan krijimin e grupeve të tilla. Ka syresh që modelojnë te vetja dhe familjet e tyre të lidhura në formë fisesh të mëdha, strukturat e njohura mafioze apo kamorriste. Prognoza është që ky fenomen për vetë nivelin ekonomik e kulturor të bëhet gjithnjë e më shqetësues.

Një tjetër faktor specifik për Shqipërinë konsiderohet fakti i të qenurit një vend në kërkim të një fizionomie të re. Ky nuk është thjesht tranzicion, por një prirje për kalim në një ndryshim rrënjësor nga instinkti i stërgjyshërve e trashëgimia kanunore (të ringjallura prej rrëmujës, anarkisë e problemeve të pronës private), në një mentalitet të ri, modern. Është si një operacion i vështirë, që së bashku me të keqen që nxjerr, sjell me vete edhe zjarrminë, ethet e gjithfarë komplikacionesh.

#### **Droga: në vend të grurit - cannabis**

Vetëm gjatë viteve '92-'96 rezultoi se janë transportuar në Greqi dhe Itali rreth 80 ton bimë narkotike të papërpunuara. Pamundësia që shteti i vërftër shqiptar të subvenciononte, kreditonte apo të siguronte treg për prodhimet e fshatarëve, bëri që organet shtetërore të mbyllnin sytë përpara qindra hektarëve tokë bujqësore, e cila në vend të grurit mbijellohej Cannabis Sativa. Në periudhën mëris viteve 92-93 në disa zona jugore të vendit, në kufi me Greqinë, u evidencuan për herë të parë afro 15 vatra të mbjella me bimë narkotike. Ndodhëra prej tyre numëronin rreth 1200 rrezeje maribuanë. Emigrantët që lëshimë kishin siguruar edhe tregun e parë të shitjes në shtetin grek, u sugjestionuan nga firmet e papara ndonjëherë. Një vit më pas, vatrat ku kultivohej maribuanë rritën të zgjerimin hapësirë e drogës në vend. Në vitin 1994, mendohet që Shqipëria të ketë hyrë në trafikun e drogës me vendet e Evropës Perëndimore. Në vitin 1993 policia shqiptare zbuloi qendra të tjera të kultivimit të bimëve narkotike, të cilat më pas do të bëheshin në qindra. Pas 12 muajsh, afro 50 qendra në Shqipëri u shndërruan në baza kryesore për kultivimin dhe prodhimin e maribuanës. Në Shqipëri është shfaqur dhe po përhapet dukuria e përdorimit të drogës. Sipas shifrave zyrtare sot ekzistojnë rreth 10 mijë narkomanë, 8 mijë prej të cilëve vetëm në kryeqytet. Burime nga shërbëtorët e luftës kundër drogës thonë se të paktën 200 nga përdoruesit janë femijë VIP-ësh. Grupmoshat më të prekura rezultojnë të jenë të rinjtë, studentët e nxënës të shkollave të larta, të mesme dhe ato të 8 vjeçaros. Rrethet më së prekur janë Tirana, Durrësi, Shkollat, Shkodra, Vlora dhe Elbasani. Përdorues më të shumtë të drogës janë meshkujt. Droga më e përdorshme, në mbi 90 % të rasteve është heroina, por përdoret edhe cannabis, marijuana dhe më pak kokaina.

Nga një sondazh i realizuar në vitin 1997 në dy shkolla të Tiranës (770 nxënës të anketuar) rezultoi se 10 % e të anketuarve ishin përdorues të rregullt. Ata pohojnë se njihnin mirë tregjet ku ofrohet drogë dhe si shkaqe të përdorimit tradhësinë prirjen për të qenë të modës, çlirim nga problemet që kanë ose ndikimin e të njohurve.

Përdoruesit e drogës në Shqipëri mund ndahen në tri kategori: emigrantet e kthyer nga Italia, Greqia e Zvicra, të cilët ishin të parët që e përdorën dhe e lëshimë drogën në vend; të rinjtë e familjeve të mesme e të pasura që përfaqësojnë numrin më të madh të përdoruesve; dhe një numër shumë i kufizuar zyrtarësh të lartë, politikantësh e gazetarësh. Deri tani në Shqipëri kanë vdekur nga mabdoza 7 vetë dhe code

naq ekziston një qendër rehabilitimi për toksikomanet.

Tentakulat e drogës janë bërë të frikshme në shoqërinë shqiptare. Rreziku i sindromit kolumbian është i pranishëm. Pasi humben paratë në skemat piramidale, një pjesë e shqiptarëve kërkojnë t'i rifitojnë nëpërmjet "vdekjes së hardhë". Ndërkohë Shqipëria rrezikon të kthehet në urë kalimi për trafikun e drogës.

### Kërcënimi i SIDA-s

Duke lu referuar të dhëna të prillit 1998, Shqipëria numëron 34 raste me virusin HIV, 10 prej të cilëve të sëmurë nga SIDA. Pjesa më e madhe e tyre janë meshkuj (27 vetë) dhe mbi 90 % i përkasin grupmoshëve 20 - 35 vjeç. Rruga mbizotëruese e përcjelljes së virusit është rruga seksuale (në 85 % të rasteve me marrëdhënie heteroseksuale dhe homobiseksuale). Ka patur katër raste të martesë së virusit nëpërmjet gjakut të infektuar. Megjithatë, po të gjykojmë nga numri i individëve të infektuar me HIV, gjendja është shqetësuese. Sipas Programit Kombëtar të SIDA-s mund të rezultojnë përafërsisht rreth 2000 raste që mund të kenë kontaktuar virusin HIV. Kjo shifër është e destinuar të rritet për shkak të disa faktorëve favorizues: ndryshimet social-ekonomike dhe politike, lëvizjet kaotike të popullatës, liberalizimi i papritur i sjelljes seksuale, shpërthimi i trafikut të prostitutave dhe të gjitha këto të shoqëruara nga mungesa e edukatës seksuale. Nga ana tjetër, përdorimi i drogës shumë lehtë mund të çojë në shkallëzimin e përhapjes së virusit HIV të përdoruesit, sikurse ka ndodhur në të gjithë vendet e rajonit.

Sipas politikës së Shqipërisë kundër SIDA-s, e përshtatur sipas strategjisë së Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe UNAIDS, testimi për HIV bëhet mbi baza vullnetare. Testimi i gjakut të dhunuar për virusin HIV është i detyrueshëm. Programi Kombëtar ka planifikuar që nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik të zhvillojë një vëzhgim epidemiologjik mbi përhapjen e HIV-it, me qëllim që të masë prevalencën e këtij infeksioni dhe të monitorojë prirjet e tij në të ardhmen.

Për sa i përket ndjekjes dhe konsultimit të rasteve me virus me HIV dhe SIDA, deri më sot është krijuar mundësia e trajtimit vetëm të infeksioneve shoqëruese të virusit. E vetmja qendër që trajton sëmundjet e lidhura me këto viruse është Departamenti i Sëmundjeve Infektive pranë Qendrës Spitalore Universitare në Tiranë. Pranë Programit Kombëtar të SIDA-s në Institutin e Shëndetit Publik në Tiranë, funksionon edhe një qendër këshillimore në ndihmë të të infektuarve.

### 3.3. Shtresëzimet e Reja të Shoqërisë Shqiptare

Në gjithë kampin e Lindjes komuniste, Shqipëria ishte vendi që njohu barazizimin më të shpejtë. Rënia e komunizmit e përmbysi hierarkinë shoqërore të mëparshme duke e zëvendësuar fillimisht me një kaos shoqëror, që më pas filloi të strukturohet duke paraqitur një sërë veçorish dalluese.

Dinamika e shtresëzimit të shoqërisë shqiptare paskomuniste është e lidhur ngushtë me disa dukuri që kanë luajtur një rol përcaktues në këtë proces:

- Emigrimi masiv si një nga lëvizjet më të rëndësishme pas rënies së komunizmit.

- Klasa politike që u përfshi në luftën për pushtet nuk kishte pronë dhe pasuri.

- Në periudhën postkomuniste filloi privatizimi i pasurive shtetërore i kombinuar me procesin e rikthimit të pronave, pronarëve të shpronësuar nga regjimi komunist.

- Mbështetja perëndimore do të luante një rol përcaktues për mbijetesën dhe ndërtimin e një ekonomie tregu në Shqipëri.

Sipas të dhënave zyrtare, deri më 1997 Shqipëria ishte vendi që shënonte rritjen më të madhe ekonomike prej vitit 1992 (kishte përqindjen më të ulët të inflacionit, monedha vendase u forcua kundrejt valutave të forta; numri i veturave u rrit nga 10 mijë në 250 mijë, të ardhurat për frymë u trefishuan), ndërkohë që kishte aparatit prodhues më të dobët ndër vendet ish-komuniste (prodhimi bujqësor dhe industrial ende nuk kishte arritur nivelin e vitit 1989). Ky paradoks mund të shpjegohet me faktin se brenda pak vitesh ekonomia shqiptare kaloi nga kolektivizimi i skajshëm në një ekonomi të kapitalizmit të egër, në të cilën sfera e qarkullimit monetar mbizotëronte mbi ekonominë reale, ku pasuritë e mëdha krijoreshin e shembeshin nëpërmjet lojës financiare dhe tregut të zi. Pikërisht në një kontekst të tillë duhet parë zhvillimi i procesit të shtresëzimeve shoqërore në Shqipërinë paskomuniste.

**Borgjezia e re shqiptare** është pasuruar me shpejtësi dhe në rrugë të ndryshme, të cilat jo në të gjitha rastet mund të thuhet se kanë qenë të ligjshme. Mungesa e legjislacionit, sidomos në fillimet e kapitalizmit, madje edhe mungesa e taksave, favorizuan një pasurim të shpejtë. Nga ana tjetër, kontrabanda dhe korrupsioni, kanë ndikuar jo pak si në masën e pasurisë, ashtu edhe në profilin social të borgjezisë së re shqiptare. Karakteristikë e kësaj shtrese është se



pasuria nuk është deklaruar, madje shpesh herë është edhe fshehur apo depozituar në banka të huaja jashtë vendit.

Deri në rënien e komunizmit Shqipëria kishte afro dy të tretat e popullsisë në fshat dhe e prodhonte në vend krejt produktin bujqësor. **Popullsia fshatare** në Shqipërinë komuniste ishte në gjendje shumë të mjeruar. Shkatërrimi i kooperativave bujqësore dhe fermave, si dhe heqja e kufizimeve për lëvizjen e lirë shkiktoi ndryshime të thella dhe të menjëhershme në popullsinë fshatare. Një pjesë e madhe emigruan jashtë shtetit, një pjesë tjetër u zhvendosën në qytete. Të dyja këto lëvizje u kryen në mënyrë të pakontrolluar duke krijuar probleme të panumërta sociale dhe ekonomike. Sot, pjesën më të madhe të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore, veçanërisht atë që konsumohet në qytet, Shqipëria e importon nga jashtë, kryesisht nga Greqia, Maqedonia dhe Italia.

Me rënien e komunizmit, zonat e largëta pësuan një shkatërrim të madh të infrastrukturave të ndërtuara nga shteti komunist, ashtu sikurse edhe ato të sistemit arsimor dhe shëndetësor. Ajo pjesë e kësaj popullsie që ka mbetur në vendbanimin edikurshëm është pjesa më e varfër e popullsisë fshatare. Situata ekonomike ku ato u gjendën ishte mjaft e vështirë. Një pjesë e madhe e tyre janë familje me 5-7 a më shumë anëtarë dhe me parcela toke të vogla në pronësi. Një pjesë e tyre i janë kthyer ekonomisë së mbyllur, ku gjithçka që u nevojitet duke filluar nga buka e prodhojnë vetë. Mbijetesë e këtyre familjeve i dedikohet edhe ndihmave që sjellin pjesëtarët e familjes që janë refugjatë. Prirja e tyre është të largohen nga vendet e humbura ku banojnë dhe të

vendosen nëpër qytete ose të emigrojnë jashtë shtetit.

Ndërkaq, gjatë këtyre pesë vjetëve, pjesa më vitale e popullsisë fshatare kreu një migrim të brendshëm tepër të madh. Një pjesë e mirë janë vendosur në rrethinat e Tiranës ku zunë pa leje toka dhe filluan të ndërtojnë kush një kolibe e kush një shtëpi. Shumica e tyre ishin të varfër dhe përdorën të gjitha mjetet për të mbijetuar. Mangësitë për t'u arsimuar bënë që gjashtë vjetët e fundit një pjesë e madhe e fëmijëve të këtyre familjeve të mbeten të padukuar dhe të futen në botën e kriminalitetit. Edhe pas zgjedhjeve të 29 qershorit të shtesa fshatare vazhdon të mbisundojë prirja për të emigruar jashtë shtetit dhe kur nuk mundën, prirja për të migruar në qytetet kryesore. Mungesa e kushteve për mbijetesë si dhe e arsimimit, bënë që kjo shtresë të jetë burimi kryesor i kriminalitetit, si dhe një rrezik i vazhdueshëm përsa i përket stabilitetit politik dhe social.

**Punëtorët** përfaqësojnë shtresën më të ekspozuar të popullsisë ndaj reformës drastike ekonomike. Ata që mbajtën mbi shpatulla "ndërtimin e socializmit", tani ndjehen të pambrojtur përballë mbylljes masive të uzinave, fabrikave dhe minierave me teknologji të vjetëruar e aspak konkurruese. **Karakteristikë e kësaj shtrese është mungesa e mundësive të tjera të punësimit për profesionet që zotëron.** Kjo lidhet jo vetëm me numrin e vogël të ndërmarrjeve të krijuara rishtaz, por veçanërisht me faktin se në të kaluarën popullsia urbane u përqëndrua në zona industriale specifike. Jeta e popullsisë në këto zona u lidh me këtë industri, siç është rasti i minierave, industrisë kimike dhe metalurgjike, industrisë tekstile etj. Si

#### VROJTIM Nr.2 - Shkaqet Kryesore të pasurimit

	Gjithsej (%)	Numri gjithsejt
Ilegjitime	59 %	818
Legjitime	19 %	261
Pozicioni Qeveritar '92 -'96	18 %	245
Pozicioni Qeveritar gjatë Komunizmit	4 %	60
Gjithsejt	100 %	1348

Burimi: ORT, 1997

rezultat i papunësisë, kjo shtresë është e prirur të emigrojë dhe vetëm një pjesë e emigrantëve nga kjo shtresë kanë mundur të punësohen në profesione të përafërta me atë që kanë patur në Shqipëri.

**Nëpunësit dhe shtresa e pronarëve dhe tregtarëve të vegjël** është një tjetër pjesë e dallueshme në shtresëzimet sociale paskomuniste. Kjo u krijua kryesisht nga pjesa qytetare e popullsisë që gjatë komunizmit ishte e punësuar në shtet, në administratë dhe në shërbime publike. Një pjesë e tyre mbetën pjesë e administratës së re, me rroga tepër të vogla, kurse pjesa me vitale do të ishin pronarët apo tregtarët e vegjël, të cilët privatizuan dyqanet e dikurshme shtetërore dhe filluan tregtinë me pakicë ose të hapin punishte të vogla. **Kjo është pjesa më e qëndrueshme e shoqërisë, më profesionalja, më e lidhura me vendin dhe më e përgjegjshmja përsa i përket respektimit të ligjeve të shtetit dhe normave të jetës shoqërore.** Megjithatë edhe kjo shtresë vuan pasigurinë e jetës. Edhe në radhët e kësaj shtrese ndjehet fuqishëm prirja për t'u larguar nga vendi. Gjatë krizës së vitit 1997, ajo u përpoq të ruajë çka kishte investuar dhe jo në pak raste e pa veten të plaçkitur ose të shkatërruar.

Emigrantët gjithashtu përbëjnë një kategori sociale ku përfaqësohen të gjitha shtresat e përmendura më sipër. Ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm për mbijetesën e shqiptarëve gjatë periudhës paskomuniste. Fenomeni i emigrimit nga viti 1990 e deri më sot ka qenë edhe një valvölë shkarkimi e problemeve ekonomike dhe sociale që ka kaluar vendi pas rënies së komunizmit. Por, nga ana tjetër, ka qenë edhe një humbje e madhe e burimeve njerëzore dhe intelektuale. Shqipëria vazhdon të pësojë një "brain drain" të fuqishëm, një rrjedhje të pjesës më vitale të kombit. Sot, pas gjashtë vjetësh të tranzicionit paskomunist, Shqipëria mbetet në gjendjen e një kaosi shoqëror, ku bie në sy mungesa e një klase të mesme që do të ishte faktor i stabilitetit social dhe politik të vendit.

### 3.4. Shoqëria Civile

#### *Arsimimi, Mundësia për t'u Edukuar*

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve që filluan vitin e ri shkollor në Shqipëri në shtator të vitit 1997, në të gjitha ciklet, ishte rreth 113 mijë. Ndër ta rreth 75 mijë fëmijë nisën klasën e parë të shkollës tetëvjeçare të detyruar. Në shkollën e mesme u regjistruan për herë të parë rreth 32 mijë nxënës, ndërsa në shkollën e lartë 7 mijë studentë. Gjithashtu, në vitin 1997, hynë për herë të parë në kopësht rreth 10 mijë fëmijë.

Shteti Shqiptar ende nuk është në gjendje të plotësojë siç duhet nevojat më jetike të arsimit. Shumë prej shkollave janë tejet të amortizuara dhe me konstruksion të papërshtatshëm (35% e tyre janë ngritur para vitit 1960), ndërkohë që ka mungesa të ndjeshme në pajisje didaktike, madje edhe për banga e tabela të zeza. Dyndjet demografike nga zonat e thella rurale drejt qyteteve të mëdha e kanë bërë të domosdoshme ndërtimin e shkollave të reja. Në kryeqytet ka klasa në shkollën e mesme të përgjithshme me 50 nxënës. Mesatarisht klasat e para të Tiranës janë me 44,1 nxënës, kur norma është 35. Vitet e fundit mungesa të ndjeshme ndjehen edhe për tekste. Për vitin shkollor 1997-98 mundën të ribotohen 32 tituj tekstesh shkollorë të shkollës tetëvjeçare nga 80 tituj që nevojiteshin, ndërsa për shkollën e mesme të përgjithshme vetëm 6 nga 70 tituj.

Sipas përlllogatitjeve, plotësimi i nevojave jetike të shkollave sipas standarteve bashkëkohore do të kërkonte rreth 200 milionë dollarë, ndërkohë që buxheti i vitit shkollor 1997-98 për investime është rreth 560 milion lekë (3.5 milion dollarë). Një ndihmë të rëndësishme janë duke i dhënë arsimit shqiptar donatorë të ndryshëm. Kështu, Banka Botërore për periudhën 1994-98 dha një kredi prej 8.7 milionë dollarë për ndërtime dhe riparime të shkollave, ndërsa KE 9.9 milionë dollarë për vitet 95 e 96. Në financimet e huaja joqeveritare spikat ndihmesa e fondacionit Soros me një pro-

gram masiv rehabilitimi.

Vitet e fundit shkolla të veçanta kanë arritur të sigurojnë një standart deri diku normal në sajë të lidhjeve me fondacione apo shoqata të huaja ose duke tërhequr kontributin e biznesmenëve dhe, më pak, të prindërve. Gjendja e shkollave të pakta private, paraqitet shumë më e mirë se e atyre shtetërore.

Aktualisht grumbullimi i fondeve shtetërore për arsimin është i përqëndruar në qeverinë qendrore, që do të thotë se nuk ka taksapagues lokalë. Planifikimi i nevojave financiare nuk nis nga shkolla, nuk bëhen përllogaritje korsive per capita dhe shkollave nuk u jepen burime financiare, por vetëm materiale. Ndryshimi i mekanizmit të planifikimit, tërheqjes dhe shpërndarjes së fondeve shtetërore do të ishte një rëndësie të madhe për ecurinë e Reformës Arsimore.

Pamjaftueshmëria e burimeve financiare, si problemi thelbësor i arsimit, mund të zbutet me një politikë më të zhdërvjellët të tërheqjes së donatorëve të huaj, por edhe me një legjislacion më joshës për thithjen e fondeve të brendshme. Familja shqiptare tradicionalisht është e gatshme të sakrifikojë për shkollimin e fëmijëve, duke e konsideruar si mjetin më shpresëdhënës për t'i shpëtuar nga mjerimi material dhe moral. Shkollat private mund të jenë një mundësi e mirë nëse shteti plotëson jo vetëm kuadrin ligjor për hapjen e tyre, por edhe i nxit financiarisht. Deri tani janë hapur vetëm 31 shkolla të tilla, ndër to 5 kopshte dhe 16 shkolla fetare.

Megjithë parashtrimet e ideve të reja ende nuk ekziston një strategji e qartë kombëtare e zhvillimit të arsimit me drejtimet themelore, hierarkinë e prioritetëve, kronologjinë e vendimeve-kyçe, gjë që do të siguronte vijimësinë e ndryshimeve pavarësisht nga ndërrimet e qeverive.

Studiuesit që merren me kërkime shkencore formojnë një rreth të ngushtë, madje të mbyllur, sepse thuhet mungon debati profesional alternativ, ndërkohë që vazhdon paqartësia kronike e kufijve ndërmjet vendim-marrësve dhe studiuesve. Kërkimi shkencor ende nuk konsiderohet si mjeti më efikas i përmirësimeve në arsim. Vendimet

fragmentare që synojnë ndryshime rrezikojnë të mos kenë suksesin e pritur përdërisa nuk janë paraprirë nga studime tërësore që do të harmonizonin zhvillimet arsimore me politikën e strategjitë ekonomike, sociale e kulturore në nivel kombëtar dhe rajonal.

Hapja ndaj informacionit bashkëkohor është një ngjarje madhore për arsimin e viteve të fundit, por megjithë një hop modest të botimeve dhe të bashkëpunimit me ekspertë të huaj, ky informacion ende nuk është shndërruar në veprim efikas profesional, si nga mësuesit ashtu edhe nga vertikalja administrative. Arsyja kryesore është se ky informacion është tepër pak në krahasim me kërkesat. Pa një vërshim të një informacioni formues e konstruktiv nuk mund të shpresojmë për një ritëm të mirë të ndryshimeve themelore në arsim. Nga ana tjetër, është tejet i zbehtë debati kombëtar publik mbi ardhmërinë e arsimit.

Ndryshimet në organizimin e brendshëm të shkollës janë gjithnjë e më të nevojshme në mënyrë që ajo të marrë më shumë përgjegjësi e kompetenca në administrimin e saj, në plotësimin e kurrikulës dhe në formimin e vazhdueshëm të mësuesve. Gjatë viteve '90 janë hartuar programe të reja mësimore dhe përpiluar tekste thuhet në të gjitha lëndët. Efektet më pozitive janë ç'ideologjizimi i edukimit shkollor, modernizimi i përmbajtjes, më shumë në shkollën 8-vjeçare, edhe përmirësime të thella në mënyrën e të mësuarit dhe të nxënimit. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë plane e programe tejet të centralizuar, që hartohen nga grupe të kufizuara specialistësh dhe që i shkojnë për shtat centralizimit të rreptë të shtetit të mëparshëm. Ka tekste unike lëndore dhe pak hapësirë për plotësime programore lokale apo shkollore; përgjithësisht, tekstet janë të mbingarkuar me fakte, mbizotëron të mësuarit verbal dhe të nxënimit mekanik. Vendosija e standarteve lëndore, decentralizimi i planeve e programeve, përdorimi i testeve kombëtare, si dhe i testeve standarte ndërkombëtare, tregu i teksteve alternative, zhvendosja drejt formimit të vlerave dhe bindjeve në edukimin shkollor, të mësuarit me qendër nxënësin, janë elementët kryesorë të një reforme që po përgatitet e pritet të

*Familja shqiptare tradicionalisht është e gatshme të sakrifikojë për shkollimin e fëmijëve, duke e konsideruar si mjetin më shpresëdhënës për t'i shpëtuar nga mjerimi material dhe moral.*

zhvillohet shkallë-shkallë.

Kalimi në sistemin e shkollave 3 vjeçare profesionale, që nxjerrin punëtorë të kualifikuar dhe të shkollave 5 vjeçare teknike që përgatitin teknikë, është deri tani i vetmi ndryshim në strukturën e sistemit arsimor para universitar. Megjithatë raporti tepër i pafavorshëm i shkollave tekniko-profesionale ndaj shkollave të mesme të përgjithshme konsiderohet si ndër defektet kryesore të sistemit ekzistues.

Arsimi tekniko-profesional nuk funksionon i orientuar sipas nevojave të tregut të punës. Ende nuk është përfunduar lista e zanateve dhe përshkrimi standart i tyre; arsimi tekniko-profesional mbulon afro 35 zanate, që është tepër pak. Specialistët këmbëngulin për autonominë e këtyre shkollave, që do të thotë ndryshim i legjislacionit financiar në mënyrë që të sigurojnë vetë të ardhura nga shërbimet dhe decentralizim të planeve e programeve. Tanimë ekzistojnë disa shkolla profesionale të konceptuara sipas modeleve të huaja, nën asistencën e specialistëve të huaj.

Vitet e fundit puna e mësuesit në të gjitha nivelet ka ndryshuar për shkak të ndryshimeve jo vetëm në arsim por edhe në shoqëri, ndërkohë që përgatitja profesionale përgjithësisht është e pamjaftueshme për të përballuar parimet e arsimit bashkëkohor, që do të thotë të zotërojnë praktikat e reja të mësimdhënjes e njëherësh të jenë misionarë të specializuar të qytetërimit demokratik. Megjithë qarkullimin e ideve të reja, hopi profesional nuk është masiv; me sa duket do të lypë kohë dhe burime të konsiderueshme financiare.

Paga e mësuesit luhatet rreth mesatares prej 10.000 lekë. Shumë mësues largohen nga mësuesia për një punë më të paguar, duke shkuar qoftë edhe në emigracion. Nga ana tjetër, shumë të sapodiplomuar parapëlqejnë punë të tjera. Për vitin shkollor 1996-97 në ciklin e ulët të 8-vjeçares ndër 372 të diplomuar, u paraqitën për punë 87% dhe u pranuan emërimin 61%, kurse në ciklin e lartë, ndër 1909 të diplomuar u paraqitën 77% dhe u emëruan 53%. Për pasojë po shtohen mësuesit pa arsimin përkatës. Në vitin

shkollor 1996-97 ata zinin 22% në arsimin parashkollor, 10% në ciklin e ulët dhe 20% në të lartin.

Arsimi parashkollor me 2.408 kopshte, 80.418 fëmijë dhe 4.116 edukatore (100 % femra) ka në dispozicion 2,6% të buxhetit vjetor të shtetit për investimet parauniversitare. Vitet e fundit pjesëmarrja në kopshte luhatet në 37-39% të grupmoshës, tepër larg maksimumit prej 58,7% e vitit 1990. Kjo një shpjegohet kryesisht me lirinë e nënave nga puna në kooperativa dhe nga shtimi i nënave të papuna në qytete, por ka ndikuar edhe pakësimi i detyruar i numrit të kopshteve për shkak të zënies forcërisht nga ish-pronaret e ndërtësive apo nga shkollat që pesuan. Sot shqetësimi më i mprehtë është mospërfitimi i kërkesave për të ndjekur arsimin parashkollor për shkak të mungesës së godinave.

Arsimi 8 vjeçar me 1.803 shkolla, 559.324 nxënës (48,3% femra) dhe 30.111 mësues (60,7% femra) thihet 79,13% të investimeve 1997 për arsimin. Raporti nxënës - mësues është 19 kurse nxënës / klasë 29. Në vitin 1997 e kryen shkollën tetëvjeçare 9.963 nxënës më pak se në vitin 1990 ose 16,6% më pak. Nxënësit që mbanan klasën e tetë përbëjnë 71,2% të nxënësve që nisën shkollën 8 vjet me parë. Fakti që 2,8% e nxënësve ose 15.661 nxënës kanë braktisur njërin nga klasat e shkollës tetëvjeçare është shqetësues sidomos kur kujtojmë se vite me radhe para vitit 1990 raportohet 100% realizimi i detyrimit shkollor. Sidoqoftë tani në jemi larguar pakut të vitit shkollor të vitit 1991-92 me 6,34% ose 34.232 nxënës të larguar.

Megjithë përmirësimet e shumta, sidomos në disa lëndë dhe shfaqjes së lëndëve si edukimi i të drejtave të fëmijëve etj., shkolla 8-vjeçare ka një numër të ndjeshëm të lëndesh (në ciklin e dytë janë 15). Nuk janë konstatuar ende zonat lëndore, ku parimi i integritimit lëndor bëhet mbizotërues, sidomos në klasat e ulta. Veçanërisht në disa lëndë rëndon akademizmi i pënevojshëm.

Në vitin 1997 hynë në shkollat e mesme 61% e nxënësve që mbanan klasën e tetë. Në krahasim me vitin shkollor 1990-91 janë regjistruar në klasën e parë 13.129 nxënës më pak ose 30,2% më pak. Një rritje e tillë është dukuri e viteve të fundit. Nderkohë, duke vërejtur se hyrja në shkollën e mesme të përgjithshme është rritur 53,2% , kurse në shkollat profesionale është ulur 84,8% e që në fihat uja është drastike, duket se pakësimi i fluksit kah shkollat e mesme i detyrohet kryesisht mbylljes masive të shkollave bujqësore, zënies së të rinjve në punët bujqësore private në fshat, kurse në qytet i detyrohet me fort emigracionit intensiv që përshihet mjaft nga moshat e shkollës së mesme. Arsimi i mesëm i përgjithshëm ka 400 shkolla, 98.721 nxënës dhe 5.989 mësues (52,7% femra). Raporti nxënës/ mësues është 17, kurse nxënës - klasë, 33. Në mbarësinë '97 u diplomuan 15.892 nxënës. Në një shkollë të mesme të përgjithshme zhvillohen mesatarisht 31,5 orë në javë.

Shkollat e mesme teknike e profesionale janë 46 të shpërdara në 23 rrethë. Në vitin shkollor 1997-98 u regjistruan për herë të parë në këto shkolla 3.191 nxënës, dmth 9,9% e nxënësve të shkollave të mesme; ato i ndjekin 10.537 nxënës ose 10,7% e nxënësve të shkollave të mesme.

## **Familja**

Në përgjithësi mund të thuhet se zhvillimet e sotme në gjirin e familjes shqiptare janë më së shumti të diktuar nga faktorët ekonomikë. Janë këta faktorë që përcaktojnë si dukuritë pozitive ashtu edhe prirjet negative që vërehen.

**Familja e sotme shqiptare është përfshirë në një proces të gjithanshëm ndryshimesh, ku më i dukshmi është zvogëlimi i numrit të pjesëtarëve si rezultat i ndarjeve.** Këto vijnë si pasojë e shkëputjes së pjesëtarëve të familjes, të emigrimit, të pakësimit të numrit të lindjeve apo edhe për shkak të martesave të pjestarëve të familjes dhe të shkëputjes së tyre nga trangu familjar. Tendenca e zvogëlimit të familjeve ka përparësitë, por dhe problemet e veta. Të moshuarit e kanë të vështirë t'iu përshtaten ndryshimeve që po ndodhin ndaj dhe bashkëjetesa midis brezave të ndryshëm po bëhet gjithmonë e më e rrallë. Kjo është arsyeja që familja shqiptare përbëhet gjithnjë e më tepër nga prindërit dhe fëmijët e mitur.

**Në familjet shqiptare me përbërje numerike të vogël vihet re tendenca për pavarësi të gruas nga burri, të fëmijëve nga prindërit dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjes nga njëri-tjetri. Kjo pavarësi vjen si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në mentalitetin e shoqërisë shqiptare.** Procesi i kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut u shoqërua me dy prirje të kundërta. Ekonomia e tregut ka rritur në përgjithësi pushtetin ekonomik të burrit, duke çënuar pavarësinë ekonomike të gruas. Kjo duket në nivelin më të lartë të papunësisë te gratë sesa te burrat. Nga ana tjetër është rritur numri dhe pesha specifike e grave të punësuar në ekonominë shtëpiake, në njësi të vogla shërbimesh, që në një pjesë të madhe administrohen nga bashkëshortët e tyre. Faktori ekonomik është shumë i rëndësishëm për pavarësi, sidomos për brezin e vjetër, i cili me të ardhurat që siguron nga pensionet e ulta e ka të vështirë të ushtrojë pushtetin vendimor që ka patur më përpara.

**Tipar i rëndësishëm i familjes së sotme shqiptare është edhe futja e metodave të planifikimit familjar me gjithë vështirësitë që diktohen nga faktorë socialë, ekonomikë, gjeografikë etj.** Ritmet e larta të shtimit të popullsisë dhe ekzistenca e familjeve të mëdha u nxitën nga sistemi i mëparshëm. Aborti nuk lejohej. Madje konsiderohej vepër penale dhe lejohej vetëm për arsye shëndetësore. Shërbimet e planifikimit familjar ishin të kufizuara vetëm në edukimin shëndetësor të nënave. Ritmet e lindjes ishin shumë më të larta se në vendet e tjera të Evropës. Lindshmëria ndryshonte shumë midis zonës urbane dhe asaj rurale. Në bazë të statistikave të vitit 1989 madhësia e familjeve në zonat urbane ka qenë 3.9 anëtarë, ndërsa në zonat rurale 5.3 anëtarë.

Në korrik të vitit 1992, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Organizatën e Botërore të Shëndetësisë dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë kanë iniciuar një program që përfshin edhe planifikimin familjar. Në këtë projekt marrin pjesë edhe disa organizata jo qeveritare. Zbatimi i këtij programi ka dhënë rezultatet e tij. Duke iu referuar statistikave në këtë fushë, konstatohet se ndërsa në vitin 1994 vetëm 8 % e grave të grup-moshës 15 - 44 vjeç kanë përdorur kontraktivë, në fund të vitit 1997 ky numër është rritur në 12 %. Tregues të tillë si ulja e vdekshmërisë të nënat në masën 25% nga viti 1991 në 1996, ulja jo e ndjeshme e vdekshmërisë të fëmijët, ruajtja pak a shumë e të njëjtit nivel të lindjeve (sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 1996 niveli i lindjeve ka qenë 68358, ndërsa në vitin 1997 numri i lindjeve ka qenë 59541) dhe rritja e përdorimit të kontraktivëve flasin për efektshmërinë e këtij projekti.

Duke ju referuar informacionit statistikor vërehet një rënie e ndjeshme e numrit mesatar të fëmijëve për një grua. Në vitin 1950 indeksi sintetik i fekonditetit ishte mesatarisht 6,1 fëmijë për një grua, ndërsa në vitin 1995 ky tregues ka rënë ndjeshëm në 2,7 fëmijë mesatarisht për një grua. Vdekshmëria amënore në lindje është një tjetër tregues i rëndësishëm i cili ka ardhur në rënie. Në vitin 1980 në 1000

***Familja e sotme shqiptare është përfshirë në një proces të gjithanshëm ndryshimesh, ku më i dukshmi është zvogëlimi i numrit të pjesëtarëve si rezultat i ndarjeve.***

lindje numëroheshin 32 vdekje nënash, ndërsa në fund të vitit 1997 ky tregues është përgjysmuar. Një tregues i veçantë është edhe vdekshmëria infantile ose siç quhet ndryshe, numri i vdekjeve të fëmijëve nën 1 vjeç për 1000 lindje të gjalla, ka qenë dhe mbetet tepër i lartë. Megjithatë po ti referohemi statistikave vemë re në fund të vitit 1981 ky tregues ishte 65,1 fëmijë të vdekur për 1000 lindje të gjalla, ndërsa në fund të vitit 1995 është ulur në 43,2 fëmijë nën 1 vjeç të vdekur për 1000 lindje të gjalla.

Pas legalizimit dhe liberalizimit të abortit në vitin 1991, në dhjetor të vitit 1995 u miratua ligji për ndërprerjen e shtatzanisë. Në Shqipëri aborti është ende një metodë shumë e rëndësishme për pakësimin e numrit të lindjeve. Megjithë rënien e rasteve të abortit në shumë absolute ai vazhdon të jetë në nivel të lartë. Në vitin 1994 numri i aborteve për 1000 lindje ishte 438, ndërsa në fund të vitit 1997 numri i tyre ka rënë në 358 aborte për 1000 lindje. Vdekja e grave nga abortet, nga 16 gra të vdekura për 1000 lindje që ka qenë në vitin 1985, në vitin 1994 është ulur në 6 për 1000 lindje dhe në vitin 1997 është regjistruar vetëm një grua e vdekur nga aborti.

### **Martesa**

Martesa është një fenomen i përgjithshëm në Shqipëri. Ndryshimet që vihen re në lidhjen e martesave dhe në krijimin e familjeve kanë në themel dukuritë e reja, që janë pasqyrë e ndryshimeve që kanë ndodhur në jetën sociale, ekonomike dhe në mendësinë e shoqërisë gjatë viteve të tranzicionit. Ritmet e martesave janë pothuajse në të njëjtat nivele gjatë gjithë këtyre viteve: në vitin 1995 u lidhën 26,989 martesa ose 8.3 martesa për 1000 banorë, ndërsa në vitin 1996 u lidhën 27,690 ose 8.4 martesa për 1000 banorë. Në vitin 1997 janë lidhur 24,111 martesa. Moshë mesatare e lidhjes së çifteve është rritur në mënyrë të konsiderueshme: për gratë është 23, ndërsa për burrat 27 vjeç.

Krahas martesës si një dukuri tradicionale, vitet e fundit është vënë re edhe bashkëjetesa pa lidhur martesë

ligjore. Legjislacioni shqiptar mbi familjen nuk e rregullon këtë lloj bashkëjetese.

Krahas familjes klasike që përbëhet nga prindërit dhe fëmijët, po përhapen edhe familjet me një prind. Rritja e numrit të lindjeve jashtë martese ka sjellë rritjen e numrit të familjeve që përbëhen nga nënat e vetme dhe nga fëmijët. Në kushtet sociale dhe ekonomike të vendit, për shkak të mentalitetit e për arsye se shteti është i pafuqishëm për të zbatuar një politikë të ndihmës sociale efikase, ekzistenca e këtyre familjeve është shumë e vështirë dhe në një pjesë të konsiderueshme ato prishen, nëpërmjet dërgimit të fëmijëve nëpër institucione shtetërore apo private.

Emigracioni që filloi në vitet '90 është një faktor i rëndësishëm që influencën mbi popullsinë dhe familjen shqiptare. Nga pikëpamja ekonomike, niveli i shumë familjeve varet nga të ardhurat e pjesëtarit, kryesisht të mashkullit që është në emigracion. Nga ana tjetër ky fenomen ka ndikim negativ në dobësimin e familjes dhe në krijimin e familjeve me një prind, që në praktikë janë familje me nënën dhe fëmijët që qëndrojnë në Shqipëri dhe etërit që kryesisht për arsye ekonomike jetojnë jashtë shtetit. Kjo ndarje de facto ka pasojat e veta që pasqyrohen në një pjesë të rasteve në kërkimin e divorcit nga palët, por pasojat e vërteta vihen re në problemet e edukimit dhe të mirërritjes së fëmijëve.

### **Divorci**

Zhvillimet demokratike kanë sjellë ndryshime në statuset ekonomike, politike, socialkulturore të njerëzve duke përfshirë edhe bashkëshortët. Ndryshimet që kanë ndodhur në statuset e bashkëshortëve shpesh shndërrohen në burim mosmarreveshjesh e konfliktesh që i çon ata drejt divorcit.

Gjatë viteve të fundit divorci në shumë absolute ka rënë, po kështu edhe në raport me numrin e martesave të lidhura: në vitin 1994 janë zgjidhur 2,108 martesa ose në 100 martesa të lidhura janë zgjidhur 7.5 martesa; në vitin 1995 janë zgjidhur 2,331 martesa, ose në 100 martesa të lidhura janë zgjidhur 8.6 martesa; në vitin 1996 janë zgjidhur 1,901 martesa ose në 100 martesa të lidhura janë zgjidhur 6.8 martesa ; në

vitin 1997 janë zgjidhur 1,430 martesë ose në 100 martesë të lidhura janë zgjidhur 6.3 martesë. Megjithatë në krahasim me nivelin e divorceve të vitit 1990, numri i divorceve të vitit 1997 është përgjysmuar.

Kjo rënie e divorcit ka faktorët e vetë. Një nga arsytet është se papunësia që ka prekur më shumë gratë i ka kthyer ato në amvisa dhe të varura ekonomikisht nga burrat. Kjo mungesë pavarësie bën që ato të bashkëjetojnë me burrat edhe kur mosmarrëveshjet janë acaruar në atë masë, sa që jeta bashkeshortore i ka humbur funksionet e veta. Ky përfundim mund të nxirret duke iu referuar padive të ngritura nga burrat apo gratë, ku bie në sy rënia e numrit të padive nga ana e grave në krahasim me ato të ngritura nga burrat. Kështu në vitin 1993 janë ngritur 1,304 padi nga burrat dhe 1,589 padi nga gratë, në vitin 1994 janë ngritur 1,297 padi nga burrat dhe 1,454 nga gratë, në vitin 1995, 1,501 padi janë ngritur nga burrat dhe 1,487 padi nga gratë, në vitin 1996, 1,114 padi janë ngritur nga burrat dhe 1,151 nga gratë.

### *Si e Shpenzojnë Kohën Familjet Shqiptare*

Burrat dhe gratë formojnë familjet, por martesë, puna dhe fëmijët do të thotë për ta më pak mundësi për të rregulluar kohën. Jeta e një burri i përshtatet ritmeve dhe orëve të punës, ndërsa gruaja duhet të bëjë kompromis të përditshëm për të plotësuar njëkohësisht angazhimet familjare, sociale dhe të punës jashtë shtëpisë.

Përdorimi i kohës në familjet shqiptare është analizuar në bazë të një ankete pilot "mbi përdorimin e kohës" të kryer në 249 familje shqiptare, në 5 rrethe kryesore të vendit Tiranë, Korçë, Durrës, Shkodër dhe Fier, në zonat urbane dhe rurale. Përbërja mesatare familjare e kampionit të studiuar është rreth 4,1 persona dhe raporti femra-meshkuj është 49,5 % me 50,5 %. Në këtë grup bëjnë pjesë familje të zgjeruara me një person të vetëm, familje pa fëmijë, familje me nga një dhe më shumë fëmijë dhe familje të zgjeruara. Në familjet e

konsideruara, meshkujt kryefamiljarë zënë 88 % , ndërsa femrat 12 %. Familjet e studiuara përbëhen nga 1,013 pjestarë, nga të cilët 841 me moshë 10 vjeç e lart.

Dallohet një situatë e ndryshme e përdorimit të kohës nga meshkujt dhe femrat. Përveç kohës për nevojat bazë (gjumë, ngrënie, higijenë personale) që ndryshon pak, janë femrat ato që pjesën më të madhe të kohës e shpenzojnë për punët e shtëpisë. Njëkohësisht ato janë të angazhuara edhe në punë jashtë shtëpisë. Kjo tregon për ekzistencën e mentalitetit se punët e shtëpisë janë përgjegjësi e gruas, megjithëse edhe ajo mund të jetë në marrëdhënie pune. Burrat shpenzojnë më shumë kohë në punë (7h26'), flenë më shumë se bashkëshortet (8h40') dhe i kushtojnë më shumë vëmendje vetes për t'u larë dhe veshur. Ata qëndrojnë për të pirë diçka rreth 50' në ditë dhe kalojnë një kohë të veçantë në jetën sociale si në shëtitje ose në takime me shokë për mesatarisht (1h10') si dhe 81% e tyre kalojnë për argëtim (1h57'), merren me shumë me sport (1h44') ndërkohë që 100% e tyre kalojnë çdo ditë mesatarisht 2h41' pranë TV. Në familjet me fëmijë, meshkujt aktivizohen më shumë duke u marrë me punë shtëpie mesatarisht 2h38' dhe duke u kujdesur për fëmijët për 1h11'. Megjithatë pjesëmarrja e tyre në këto aktivitete është e ulët (24.8%) dhe ( 25.6 %).

Një pushim i plotë, në kuptimin e shpërndarjes tërësore duket se është karakteristik. Janë 44.3% e meshkujve dhe 39.2% e femrave që e kanë të domosdoshme një pushim absolut pas drekës duke shpenzuar një kohë përkatësisht prej 1h9' dhe 1h16'. Ndërsa kanë deklaruar se shkëmbejnë vizita, një numër i vogël personash 10 % e burrave dhe 15.5 % e femrave, por që koha e shpenzuar për këto vizita është mesatarisht 1h10'.

Tabela 9

Përdorimi i kohës nga çiftet me dhe pa fëmijë (mosha e bashkëshorteve nga 18-44 vjeç)

	Çift me fëmijë				Çift pa fëmijë			
	Koha mesatare		Koha mesatare		Koha mesatare		Koha mesatare	
	Burra	%	Gra	%	Burra	%	Gra	%
Punë në familje 2h20'	63.3	6h48'	97.2	2h14'	55.6	5h4'	100	
- Punë shtëpie	2h38'	24.8	5h48'	90.5	1h15'	16.7	5h13'	100
- Pazar	1h5'	22.6	0h47'	30.9	1h25'	22.2	0h26'	31.3
- Kujdes për fëmijët	1h11'	25.6	2h19'	63.7				
Punësimi	7h26'	53	6h44'	31.9	8h2'	55.6	7h0'	43.8
Nevojat bazë	11h10'	100	10h29'	100	11h0'	100	10h37'	100
Argëtim	1h57'	81.1	1h42'	70.7	2h8'	77.8	1h58'	75
Sport	1h44'	22.6	1h26'	12.6	2h40'	22.2	1h5'	12.5
Hobbi dhe lojra	1h31'	17.4	0h54'	2.8	1h32'	27.8		
Media	2h48'	100	2h16'	100	3h3'	100	2h18'	100

Burimi: INSTAT, 1998

*Mbyllja e fabrikave në qytete solli një rritje të menjëhershme të papunësisë të gratë dhe rrjedhimisht edhe një varësi më të madhe ekonomike nga burrat.*

### **Gruaja : Rruga e mundshme drejt progresit**

Sistemi socialist, ngandonjëherë edhe me forcë e detyroi shoqërinë konservatore dhe tradicionale shqiptare të pranonte pjesëmarrjen aktive të gruas në jetën shoqërore. Por ai që konsiderohej si "emancipim" i gruas lidhej më tepër me veprimtarinë e jashtme të saj dhe jo me ndryshimin e jetës së brendshme. Kjo sillte kontradiktën që ndërsa jashtë mureve të shtëpisë gruaja ndiente një shkallë lirie, brenda shtëpisë ajo mbetej e nënshtuar. Bashkë me këtë sfond të së kaluarës së afërt në fazën e parë të tranzicionit paskomunist rikthehen në jetën shqiptare edhe disa zakone dhe paragjykime tradicionaliste ndaj gruas.

Hapja e shoqërisë shqiptare dhe demokratizmi i saj kanë sjellë një shkallë lirie më të madhe për gruan. Futja në shkallë të gjerë e pajisjeve elektroshtëpiake e kanë lehtësuar gruan dhe kanë zhvilluar kulturën e jetesës në familjet shqiptare. Vajza shqiptare është çliruar nga frika absurde e normave shtetërore për veshjet. Por, nga ana tjetër, mbyllja e fabrikave në qytete solli një rritje të menjëhershme të papunësisë të gratë dhe rrjedhimisht edhe një varësi më të madhe ekonomike nga burrat. Kjo mbyllje

në shtëpi po favorizon largimin e grave nga jeta shoqërore.

Në zonat rurale, me ndarjen e tokës fshatarëve, gruaja u rëndua edhe më shumë. Duke mos patur mundësi financiare për të blerë makineri bujqësore, duke patur në numër të madh burrat në emigrim, gratë e këtyre zonave shpesh duhet të punojnë gjithë ditën tokën me mjete primitive. Nuk bëhet fjalë për pjesëmarrje në jetën shoqërore të këtyre grave, të cilat janë krejtësisht të dërrmuara nga punët dhe përpjekjet për mbijetesë.

Mjaft komplekse paraqitet gjendja edhe te kategoria e vajzave të reja, si në qytet edhe në fshat. Megjithëse është e vështirë të gjendet një përcaktim ose karakterizim i vetëm, për shkak të veçorive dhe ndryshimeve nga krahina në krahinë, nga qyteti në fshat dhe nga qyteti në qytet, mund të pohohet se tipar i përbashkët është frika dhe pasiguria për të ardhmen. Vajzat e reja shohin pak ose aspak mundësi për të patur një rrugë të sigurt në jetë.

Në qytetet e mëdha ka ende pak mundësi për gratë për të konkuruar në tregun e punës. Nje grup i kufizuar ka mundësinë të punojë në firma të huaja, një grup më i gjerë në sektorët e shërbimeve, ndërsa shumica është e detyruar të kryejë punë që paguhet pak, si në disa ndërmarrje të përbashkëta ose të qëndrojnë në shtëpi.



Në fshat dhe në qytetet e vogla gjendja është dhe më e rëndë. Këto zona ndonëse janë më tradicionale dhe konservatore, paradoksalisht janë edhe furnizueset kryesore të kanaleve të prostitucionit për në vendet fqinjë.

### **Prostitucioni**

Ky fenomen social e përballë shoqëritë shqiptare me një ndryshim që ajo veshitë se do të mund ta përlytyronte 10 vjet më parë. Ai u shfaq fillimisht si ngjarje. Më pas u shndërrua në një fenomen social të dhimbshëm, që për një kohë të gjatë mbeti i pasipallur publikisht.

Pas ndryshimit të sistemit politik shqiptarët u gjodën përballë boës së madhe dhe të shndërrime të mirëkolluar, të hutuar e të çorodhur, me dëshira të ndezura e plot kureshtje, me guxim për të provuar të rejtat, por pa asnjë goshë në xhep. Dëshira për të fituar shpejt ato që kishin ëndërruar gjatë jetën ("detyroi" shumë njerëz të përdorin çdo mjet në shkëmbim të tyre. U çliruan gjithashtu një sërë vesesh të karakterit, të cilat izolimi i periudhës komuniste i konservoi brenda jetës morale të popullit. Kështu, nga njëra më varfëria e madhe dhe firma-revolte nga ana tjetër, mbeten shkaqet kryesore të lindjes së prostitucionit të organizuar shqiptar.

Prostitucioni brenda Shqipërisë përfshin grup mosha nga 14 - 55 vjeç. Një përqindje jo e madhe vajzash janë shtrënguar për të ushtruar këtë profesion. Aktualisht, Shqipëria po kalon kohën e kaosit të madh, ku të gjejsh veten ishtë e veshitë. Shpesh të riqitë në këtë lufte për të gjetur vetveten e bumbasim atë. Mungesa e alternativave dhe e besimit është një nga arsyet ku mbështetet kjo zgjedhje e tyre. Kësaj i shoqëhet edhe një situatë ekonomike tëjet e veshitë dhe zgjidhja mbelet shpesh në kufijtë e mbijetesës.

Prostitucioni shqiptar jashtë Shqipërisë përkon ose iken e rregullatëve të parë shqiptarë në vitet '90 - '91. Gjendja së keqe ekonomike i shtohet në këtë situatë edhe përvoja e vendasve dhe të huajve në këto vende. Gjendja e prostitucionit shqiptar jashtë Shqipërisë është më e studiuar. Numri i vajzave shqiptare që prostituojnë në Evropë vlerësohet të jetë afro 30 mijë vajza. Por në shumicën e studimeve të sociologëve grekë ose italianë, dukuria e prostitucionit trajtohet më shpesh si fenomeni ekonomik me avantazhet dhe disavantazhet që sjell në treg kërkesa dhe oferta për të, si shiroja majore nga prostitucioni në përgjithësi, ai i huaj në veçanti ose investimeve të kryera për këtë "shërbim" të ofruar etj.

Problemi më i mprehtë i pasqyruar në studimet e kryera nga shqiptarët dhe të huajt është roli i trafikantit ose protektorit. Në më të shumtën e rasteve, ai luan rolin e një personi të dhunshëm, i cili shfrytëzon dhe përgjak këdo që i del përpara në qellimin e tij. Ai mashtrohet, rëmben me forcë dhe e detyron vajzën të prostituojt, nuk e lë atë të kthehet në jetën normale edhe pse qëllimi i saj nuk është të vazhdojë këtë profesion. Kjo gjendje e ndërmjetme është më shumë se një etapë trafiku, një periudhë e errët dhe e rëndë psikologjike për të dhunuarën, e cila nuk gjen sa duhet mbështetjeje e familjes, shoqërisë dhe shtetit për t'u mbrojtur nga kjo falkëqësi. Interpoli shqiptar ka trajtuar në periudhën 1993 - 1998, 103 raste të zhdukjes së vajzave, i mbështetur në denoncimin e familjeve të tyre dhe ka arritur të kthejë në Shqipëri 44 prej tyre. Nga 580 persona të denoncuar në periudhën 1991 - 1997 për trafik prostitucioni janë arrestuar 200 vetë.

Legjislacioni shqiptar është një legjislacion jo diskriminues ndaj grave në thelbin e vet. Megjithatë aspekte të ndryshme mbeten për t'u rishikuar, sidomos në plotësimin e kuadrit ende të mangët në fushën e trashëgimisë së pronës private, të të drejtave mbi fëmijët, të dhunës shtëpiake dhe dhunës ndaj gruas në përgjithësi etj.

Lëvizja e gruas në Shqipëri ka shkuar drejt masivizimit dhe konsolidimit të saj. Ajo e ka zgjeruar shtrirjen e vet duke kaluar nga qytetet e mëdha në qytete të vogla, duke synuar të depërtojë gradualisht edhe në fshat. Kriza e vitit 1997, dëshmoi në mënyrë të veçantë rolin e kësaj lëvizjeje. Në kushtet e rënies së strukturave shtetërore, manifestimet e organizatave dhe shoqatave të grave kundër përdorimit të armëve luajtën një rol të madh në ringjalljen e besimit.

Lëvizja e gruas në Shqipëri përfshihet në dy grupime kryesore: shoqatat e pavarura të grave dhe grupimet e grave brenda partive politike. Shoqatat e pavarura veprojnë të udhëhequra nga slogani i Konferencës së Pekinit -s'ka demokraci pa të drejtat e gruas-, që janë pjesë përbërëse e të drejtave të njeriut. Shoqatat e grave, të specializuara tashmë në shumë drejtime, kanë si objekt të veprimtarisë së tyre ndryshimet në legjislacion, programet për respektimin e të drejtave të grave, ndalimin e dhunës ndaj grave, punësimin, planifikimin familjar etj. Karakteristikë e lëvizjes së gruas është një shkallë relativisht e lartë e bashkëpunimit mes grupeve dhe shoqatave të ndryshme, çka i jep kësaj lëvizjeje një karakter më kompakt.

Nuk mund të thuhet se pjesëmarrja e gruas shqiptare në organet vendimmarrëse apo në organet drejtuese në partitë politike është e kënaqshme. Sot ka një zëvendëskryetare Parlamenti, një grua ministre në kabinetin qeveritar dhe shtatë deputete në Kuvendin Popullor. Pavarësisht nga një farë ecurie, mungesa e ndjeshme e grave në organet vendimmarrëse, në qendër dhe në pushtetin lokal, dëshmon se gruja shqiptare është ende larg të qenurit aktore e barabartë në zhvillimin e vendit. Nivelit relativisht të lartë të arsimimit të grave

***Nuk mund të thuhet se pjesëmarrja e gruas shqiptare në organet vendimmarrëse apo në organet drejtuese në partitë politike është e kënaqshme.***

**Më shumë se shoqëri civile shoqëria shqiptare është një shoqëri politike. Qytetari shqiptar më shumë se një homo civicus paraqitet si homo politicus.**

shqiptare nuk i pergjigjet aspak shkalla e përfshirjes të tyre në procesin e drejtimit dhe të marrjes së vendimeve. Megjithatë, gjatë vitit 1997 gratë zënë 58.8 % të punonjësve të sistemit të arsimit, në sistemin shëndetësor 70.7 %; në gjykatat 29 %; në Ministrinë e Drejtësisë 43.8 %; në Ministrinë e Burimeve Energjitike 21.8 % etj. Disa hapa inkurajues kanë synuar rritjen e rolit të gruas në të gjitha nivelet. Në Kuvendin Popullor vepron grupi i grave parlamentare ku bëjnë pjesë të gjitha deputetet gra. Ky grup ka mandatin e një komisioni parlamentar. Qëllimi i këtij grupi është mbrojtja dhe promovimi i të Drejtave të Gruas dhe sensibilizimi i legjislativit në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me gruan. Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas është krijuar drejtoria "Gruaja dhe Familja". Kjo drejtori synon të nxisë pjesëmarrjen aktive të gruas në të gjitha sferat e jetës përmes hartimit dhe drejtimit të politikave sociale, përmirësimit të legjislacionit dhe bashkëpunimit me pushtetin lokal.

#### *Shoqëria Civile në një Vend të Armatosur*

Kriza e fundit në Shqipëri dëshmoi veç të tjerave se shoqëria civile është ende e pakonsoliduar. Më shumë se shoqëri civile shoqëria shqiptare është një shoqëri politike. Qytetari shqiptar më shumë se një *homo civicus* paraqitet si *homo politicus*. Kjo lidhet, nga njëra anë me faktin se ende shumë aspekte të jetës së tij varen nga zgjidhjet politike dhe administrata shtetërore, por nga ana tjetër edhe me faktin se shqiptarët jetojnë në një mjedis tejet e politizuar.

Marrëdhëniet ende të pabalancuara ndërmjet Lirisë dhe Përgjegjësisë janë reflektuar në mungesën e atij që quhet homo civicus ose Qytetar. Kapërcimi nga një kolektivizëm i skajshëm në një individualizëm po aq të skajshëm, ka çuar natyrshëm në dobësimin e ndjenjës së komunitetit, e cila sigurisht duhet të ringrihet mbi baza të reja. Ndërmjet individit dhe shtetit ka ende një hapësirë të madhe, që në një shoqëri normale demokratike mbushet nga një shoqëri civile e larmishme.

Gjithsesi, shoqëria civile në Shqipëri ishte ndër ato segmente të shoqërisë që edhe në kushtet e një krize të rëndë mundi të mbijetojë, madje të fitojë edhe simpati. Në kulmin e ngjarjeve të marsit 1997, organizatat joqeveritare u shfaqën si një aktor me peshë në skenën shqiptare.

Vitet e fundit mund të thuhet se OJQ-të në Shqipëri kanë hedhur disa hapa përpara. Ato po shfaqen gjithnjë e më tepër si përfaqësuese të interesave specifike të grupeve të ndryshme dhe si tribuna të dialogut social. Në të njëjtën kohë, ato po përpiqen të luajnë një rol më aktiv në modelimin e politikave qeveritare.

OJQ-të në Shqipëri kanë vepruar dhe veprojnë në disa kushte specifike që ua vështirësojnë mbijetesën dhe aktivitetin. Kriza e rëndë që kaloi vendi, varfëria, mjedisi tejet i polarizuar politik nuk mund të mos ndikojnë edhe në veprimtarinë e tyre. Por janë pikërisht këta faktorë që e bëjnë edhe më të rëndësishëm rolin e tyre në zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Në kushtet e vështira të vitit 1997, OJQ-të qenë të afta të ndryshojnë shpejt kalendarët e aktiviteteve dhe t'i përshtaten situatës së krijuar. Një pjesë e tyre realizuan projekte të mëdha në rritjen e ndjeshmërisë së publikut për të marrë pjesë në zgjidhje, në vëzhgimin e zgjedhjeve, në monitorimin e medias etj. Situata e vitit 1997 solli një element të ri: rritjen e shkallës së bashkëpunimit të organizatave të ndryshme në realizimin e projekteve të përbashkëta.

Arritjet më të rëndësishme të OJQ-ve gjatë vitit 1997 janë:

Në Qeveri një grup pune u krijua për plotësimin e paketës ligjore që rregullon veprimtarinë e OJQ-ve, si dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punës për hartimin e ligjeve të reja.

U shkruan të paktën 14 projekt-ligje dhe amendamente për çështje të rëndësishme sociale, ekonomike, të mjedisit e të demokracisë dhe u fillua përpjekja për miratimin e tyre nga qeveria.

U mbajtën forume dhe diskutime me anëtarë të Parlamentit për projekt-kushtetutën.

U organizuan marshime dhe demonstrime paqësore duke iu bërë thirrje qytetarëve, partive politike dhe qeverisë për tolerancë dhe mirëkuptim gjatë periudhës së krizës.

U zhvilluan debate me kandidatë për në Kuvendin Popullor gjatë zgjedhjeve të vitit 1997 për të votuar më të mirinformuar. Këto debate u mbajtën nga grupe grash, shoqata pensionistësh të cilët ngriten probleme specifike për kandidatët dhe ndihmuan votuesit të njihin më mirë me kandidatit e tyre.

30 OJQ morën pjesë në ndërtimin, zhvillimin, dhe vënien në zbatim të një anketimi në shkallë të gjerë kombëtare që pati për qëllim studimi njohuritë, eksperiencën dhe opinionet shqiptare në situatën e tanishme ekonomike, sociale dhe politike, në faktorët që shkaktojnë krizën e 1997, si dhe për hapat e ardhshëm për të zgjidhur situatën e krijuar.

OJQ-të dhe në përgjithësi ato që përfaqësojnë gratë, u bënë nëpër shumë rajone të vendit dhe mbajtën diskutime lokale për mbledhjen e armëve dhe çështje të tjera të sigurisë publike.

Një qendër këshillimore për gratë kreu një anketim për rritjen e dhunës ndaj gruas gjatë periudhës së krizës.

Shumë shërbime të nevojshme u ofruan si: planifikim familiar, informacion mbi kujdesin për të porsalindurit, informacion mbi abuzimet me drogë ose alkool, dreka në shkollë për fëmijë të paprivileguar, këshillim për gratë për çështje të dhunës, shëndetit dhe ligjit, përfaqësim ligjor për gratë e paprivileguara, prodhimi dhe shpërndarja e kartave me rrotë për handikapuar, edukim civil, konsumator dhe votues, trajnime dhe shërbime përkrahëse për drejtues dhe biznesmenë.

U kryen shumë anketime për çështje të rëndësishme si dhuna në shtëpi, dhuna ndaj grave në zona të pazhvilluara, abuzimi i drogës dhe alkoolit, prostitucioni, njohuritë e grave mbi ligjin, gratë në biznes dhe privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.

U rrit niveli i aktiviteteve të OJQ-ve jashtë rrethit të Tiranës.

Ajo që vihet re është se OJQ-të janë një sektor i parajzykuar dhe i nënvlerësuar nga politika vendase, por mjaft i mbështetur dhe i vlerësuar nga jashtë, si nga OJQ homologe, ashtu edhe nga Qeveritë Perëndimore, të cilat e kanë shtuar ndjeshëm numrin e projekteve në këtë fushë.

Koncepti themelor i një shoqërie civile është pjesëmarrja e publikut, gjë që nuk ka traditë në Shqipëri. Duhet pohuar se si OJQ-të, si sindikatat ende realizojnë një shkallë të ulët pjesëmarrjeje të qytetarëve. Marrëdhënia dy-kaheshe, domethënë që qytetarët respektojnë autoritetin e shtetit, ndërsa shteti nga ana e vet respekton qytetarët dhe shoqërinë civile do të dojë ende kohë që të hedhë rrënjë.

Për shkak të kuadrit të mangët ligjor për regjistrimin e OJQ-ve është disi e vështirë të jepet një shifër e saktë për numrin e tyre të përgjithshëm, por besohet se ka arritur afërsisht në afro 850. Nga numri i përgjithshëm i OJQ-ve të regjistruara rreth 50 prej tyre janë tepër aktive. Ato kanë zyra, botime dhe burime financiare për të funksionuar. Prirja e përgjithshme është se me shpejt rritet numri i OJQ-ve sesa numri i anëtarëve që bëjnë pjesë në to. Kjo i ka dhënë shoqërisë civile shqiptare një karakter tepër fragmentar.

Megjithë arritjet e fundit dhe forcimin e OJQ-ve, është e rëndësishme të përmendim edhe mangësitë e tyre. Fakti që këto organizata nuk kanë identifikuar dhe pasqyruar qartë rolin e tyre në shoqëri, ka rezultuar në një imazh publik jo shumë pozitiv. Ky imazh jo pozitiv përforcohet nga marrëdhënie të dobëta ndërmjet këtyre organizatave dhe qeverisë, biznesit, medias dhe popullatës. OJQ-të kanë vepruar në përgjithësi në mënyrë të pavarur nga

njëra-tjetra dhe nga sektorë të tjerë të ekonomisë. Për pasojë besimi në këto organizata dhe njohuritë e publikut për veprimtarinë që zhvillojnë ka ardhur duke u zvogëluar. Mjaft përpjekje janë bërë për të përmirësuar marrëdhëniet me sektorë të ndryshëm dhe krijimi i Departamentit të Koordinimit të Ndhmës Humanitare pranë Ministrisë së Punës, ka ndihmuar në përmirësimin e këtyre marrëdhënieve. Me mbështetjen e UNDP-se ky departament ka kryer një mision të dyfishtë: koordinimin e ndihmave humanitare dhe vendosjen e përjashimit nga taksat të organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave të tjera që sjellin ndihma në Shqipëri; si dhe përmirësimin e bashkëpunimit me qeverinë, përfshirë një partneritet zyrtar ndërmjet qeverisë dhe OJQ-ve.

Një studim kombëtar i kryer nga ORI/USAID në vjeshtë të vitit 1997 konfirmon nivelin e ulët të vetëdijes së publikut për sektorin e OJQ-ve. Kur u pyetën 1582 persona nga 32 rrethet të vendit për kuptimin

**Statusi ligjor per OJQ-te eshte liberal dhe i garanton atyre lirinë e veprimit duke u siguruar një bazë për përfshirjen në aktivitete sociale, fetare, kulturore dhe humanitare.**

e shkronjave OJQ, vetëm 37 % u përgjigjën saktë dhe vetëm 11 % u përgjigjën se kishin marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga OJQ-të. Megjithatë, 68 % e të anketuarve u përgjigjën që këto organizata janë të rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe ç'është më e rëndësishme 65 % mendojnë se duhet të rritet bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve dhe qeverisë. Një pjesë e madhe e të anketuarve, rreth 69 %, raportuan se do të ishin të gatshëm të punonin me një OJQ për çështje të rëndësishme.

Një mangësi tjetër e këtij sektori në Shqipëri është statusi ligjor i tanishëm. Ky status është liberal dhe i garanton atyre lirinë e veprimit duke u siguruar një bazë për përfshirjen në aktivitete sociale, fetare, kulturore dhe humanitare. OJQ-të kanë një status ligjor të dyfishtë si shoqata dhe fondacione dhe mund të regjistrohen shumë thjesht në çdo gjykatë rajonale. Megjithatë baza ligjore është ende jo e plotë dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe të Përkrahjes Sociale, po përgatitet pjesa plotësuese e legjislacionit. Këto plotësime do të lejojnë OJQ-të të paraqitnin mendimin e tyre në vendosjen e standarteve dhe kriterëve për licensim si dhe mbledhjen e fondeve për të marrë pjesë në aktivitete ekonomike që përkrahin qëllimet e tyre jo fitimprurëse.

Një tjetër mangësi që ndikon në përkrahjen e këtij sektori është mungesa e përgjithshme e një strukture të pranueshme për OJQ-të e bazuar në standartet ndërkombëtare. Periudha e shkurtër e ekzistencës së tyre, së bashku me historinë e izolimit të gjatë të vendit që ndaluan veprimtarinë e organizatave të pavarura, kanë bërë që njohuritë e përgjithshme mbi zhvillimin e OJQ-ve dhe veçanërisht aftësitë dhe eksperiencën për të drejtuar lenë për të dëshiruar. Një anketim në shkallë vendi nga ORT/USAID në Korrik - Gusht 1997 hedh dritë mbi shqetësimet e drejtuesve të OJQ-ve për strukturën organizative, bordin e drejtorëve, problemeve të punonjësve, imazhin publik, përgjegjësinë drejtuese dhe financiare, si dhe mbarëvajtjen e përgjithshme. Një strategji kombëtare pesë vjeçare për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e OJQ-ve u financua nga ORT/USAID,

Programi për Ndërlidhjen Demokratike, për t'iu adresuar çështjeve të lartpërmendura. Kjo inicativë kombëtare përfshin zhvillimin e një qendre trainimi dhe asistencë teknike, së bashku me tetë qendra kombëtare që do të funksionojnë si sektorë përkrahjeje, të cilat do të ofrojnë shërbime të zgjeruara për të ndihmuar ristrukturimin e OJQ-ve dhe veprimtarinë e tyre konform standarteve ndërkombëtare.

Megjithëse 1997 ishte një vit me zhvillime dramatike në fushat politike, ekonomike dhe sociale, organizatat jo qeveritare vazhduan të kryenin një rol shumë të rëndësishëm. Shumë prej tyre jo vetëm e vazhduan misionin, por edhe e rritën nivelin e aktivitetit, sidomos po të krahasohen me sektorin qeveritar dhe të biznesit që e kufizuan aktivitetin në një shkallë të lartë për shkak të krizës.

### **Rinia, Kriza e Besimit për të Ardhmen**

Shqipëria bën pjesë në vendet me popullsi të re në moshë. Brezi i ri ka përbërë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit afërsisht 15-20% të popullsisë së vendit, tregues ky shumë i lartë në krahasim me treguesit mesatarë të vendeve të tjera. Por vendi që zë popullsia me moshë të re në popullsinë e përgjithshme të vendit, gjatë viteve të fundit ka ardhur duke u ulur. Kjo ka ardhur si pasojë e një sërë faktorësh, veprimi i të cilëve pati nisur nga fundi i dekadës së kaluar.

Fakti që popullsia rinore zë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së vendit, përveç ndikimeve pozitive është shoqëruar edhe me kontradikta, të cilat kanë patur dhe vazhdojnë të kenë pasojë negative. Ndër to mund të përmendim dy kontradikta të rëndësishme, që kanë shoqëruar jetën e zhvillimet rinore e shoqërore gjatë dhjetëvjeçarit të fundit dhe vazhdojnë edhe sot. Kontradikta e parë: ndërsa moshë e popullsisë shqiptare ishte shumë e re dhe popullsia rinore vinte gjithnjë e në rritje, ofertat e tregut të punës ishin dhe mbeten shumë të kufizuara. Kontradikta e dytë: ndërsa shkalla e arsimimit të rinisë është mjaft e lartë, në tregun e punës ka mungesa të theksuara për punë të kualifikuara, që t'i përgjigjen zhvillimeve demografike,

arsimore e kulturore rinore. Prania e këtyre kontradiktave ka çuar si në rritjen e emigracionit të rinisë, ashtu edhe në rritjen e numrit të të rinjve të papunë.

Viti 1997 duke qenë një vit krize ka qenë edhe për rininë tepër kritik. Rënia e piramidave goditi ekonomikisht tërë rininë, por më ndjeshëm pasojat e kësaj rënieje u ndjenë në atë pjesë të saj që ishte në emigracion dhe që kishte depozituar në to kapitalet e siguruara nga puna si emigrantë. Rënia e piramidave pati pasoja serioze edhe për atë pjesë të rinisë që jeton në qytete ose në zona të tjera urbane, e cila në kushtet e mungesës së punës, jetonte kryesisht me të ardhurat nga depozitat e parave të kredituara në sportelet e firmave rentiere.

Ndërkohë, pasojat sociale, shpirtërore e morale të rënies së firmave rentiere janë ndër të pak a shume njëlloj në të gjitha grupimet e popullsisë rinore. Kjo ka krijuar disa fraktura serioze në mentalitetin dhe kuptimet e saj për jetën dhe punën. Në kohën e "piramida dream" rinia përjetoi një situatë e cila impononte mendësinë e pagesës, madje të të pasuruarit, jo nëpërmjet punës. Kjo mënyrë jetese stimuloi përjashtimin ose marginalizimin shkallë - shkallë të rinisë nga jeta ekonomike, politike dhe shoqërore e vendit.

Rinia filloi të ndihej gjithnjë e më shumë në pozitë minoritare në pjesëmarrjen politike dhe institucionale. Me kohë u krijua një hendek që sa po vinte e thellohej midis rinisë dhe institucioneve politike e sociale në vend. Në Shqipëri po bëhej gjithnjë e më shumë e pranishme dukuria e gerontokracisë, pra dominimi i pjesëmarrjes politike dhe institucionale të brezave të rritur dhe i përjashtimit ose marginalizimit të popullsisë së re. Kjo u shoqërua nga një ulje e ndjeshme e kredibilitetit të institucioneve politike e sociale në raport me rininë. Institucionet politike (qeverisja qendrore, parlamenti, partitë politike, qeverisja lokale etj.) rezultojnë të ishin gjatë dy-tre viteve të fundit institucionet më pak të besueshme prej rinisë. Pra, rrënimi i institucioneve shtetërore në fillim të krizës së vitit 1997 nuk ishte një rrufe në qiell të pastër, por kurorëzimi logjik i amplitudës së

besueshmërisë së tyre, sidomos te rinia.

Anarkia dhe kaosi që pushtoi vendin goditën në mënyrë të veçantë institucionet arsimore, të shkollimit dhe të edukimit. Rinia e pa veten papritmas në rrugë, pa asnjë shpresë e perspektivë për të ardhmen. Institucionet arsimore dhe akademike, përveç zhvillimeve problematike që patën përjetuar deri në fillim të vitit 1997 iu nënshtruan një procesi rrënimi total. Rinia u ndje në pikëpyetje dhe udhëkryq teksa pa me sytë e saj rrënimin e institucioneve arsimore, për të cilat kujtesa kolektive e shqiptarëve ruante një veneracion e vlerësim të veçantë.

Kushtet e rënda politike dhe shoqërore që përjetoi vendi gjatë vitit 1997 thelluan më tej krizën shpirtërore dhe të identitetit të rinisë. Patologjitë sociale rinore, droga, tabakizmi, alkoolizmi etj., u gërshetuan me kriminalitetin (rinor dhe jo rinor), duke krijuar për grupimet e ndryshme rinore një situatë krize të përgjithshme dhe duke vënë në pikëpyetje mjaft vlera shoqërore e kombëtare. Sistemi i vlerave rinore pësoi gjithashtu fraktura serioze, të cilat lëkundën pozitën elitare demografike të rinisë dhe vështirësuan procesin e integritetit të saj në komunitetin e të rriturve dhe në shoqëri. Integriteti rinor u ndërlikua edhe ngaqë vetë shoqëria përjetoi një periudhë krize dhe amullie, për rrjedhim ishte mjaft vështirë të sigurohej veprimi i sinkronizuar e koherent i agregatëve të shoqërisë civile shqiptare.

Përsa i përket lëvizjes rinore, gjatë vitit 1997 në Shqipëri vepronin rreth 50 organizata rinore joqeveritare, por prania dhe veprimtaria e tyre nuk arriti të kompensojë shpërbërjen e përgjithshme të shoqërisë e të institucioneve, si dhe kaosin në të cilin u përfshi vendi dhe rinia. Organizatat dhe forumet rinore joqeveritare që veprojnë në vend janë në mospërputhje të ndjeshme me njëra-tjetrën dhe nuk kanë arritur të plotësojnë e t'iu përgjigjen kërkesave të grupimeve moshore, shoqërore e profesionale, të cilat pretendojnë se përfaqësojnë.

*Organizatrat dhe forumet rinore joqeveritare që veprojnë në vend janë në mospërputhje të ndjeshme me njëra-tjetrën dhe nuk kanë arritur të plotësojnë e t'iu përgjigjen kërkesave të grupimeve moshore, të cilat pretendojnë se përfaqësojnë.*

## *Arti dhe Kultura: Zhvillime Kontradiktore*

*Në përgjithësi mund të thuhet se ka munguar një politikë e një vizion i qartë për transformimin dhe kalimin e artit e kulturës shqiptare nga një strukturë tejet e centralizuar dhe e subvencionuar nga shteti në realitetin e ri të ekonomisë së tregut.*

Në përgjithësi mund të thuhet se ka munguar një politikë e një vizion i qartë për transformimin dhe kalimin e artit e kulturës shqiptare nga një strukturë tejet e centralizuar dhe e subvencionuar nga shteti në realitetin e ri të ekonomisë së tregut. Në këtë mënyrë pjesa dërmuese e atij buxheti tepër të pakët që shteti i akordon kulturës (afërsisht 1 % e buxhetit të shtetit) vazhdon të shkojë për të mbajtur gjallë e paguar rrogat e një sërë institucionesh kulturore anakronike, të trashëguara nga periudha e socializmit. Në të njëjtën kohë, një politikë e paqartë privatizimi, vonimi i madh i privatizimit dhe më tej, privatizimi pa kriter i një sërë objektivsh kulturore, solli një dëm tepër të madh, duke krijuar situata të tilla ekstreme, si ai i Tiranës, kryeqytet i Shqipërisë, e cila aktualisht nuk ka asnjë kinema, ndërkohë që thuajse gjithë ish-kinemate janë kthyer në bingo ose lojra fati. Sot Shqipëria është jashtë rrjetit ndërkombëtar të distribucionit të filmave bashkëkohorë.

Kjo situatë u rëndua edhe më tepër nga ngjarjet e fillimit të vitit 1997, kur në anarkinë e kaosin e përgjithshëm që përfshiu mbarë vendin, u shkatërruan dhe pësuan dëme të ndjeshme mjaft institucione e objekte kulturore, duke i dhënë një tronditje serioze e me pasoja afatgjata infrastrukturave edhe ashtu tejet të brishta të jetës kulturore në Shqipërinë paskomuniste. Pasojë tjetër serioze e anarkisë ishte dhe shtimi i madh i vjedhjeve dhe kontrabandimit jashtë vendit të objekteve të antikitetit dhe ikonave, si dhe dëmtimi i mjaft prej objekteve arkeologjike nga ndërtimet pa leje.

Thuajse gjithë fushat e artit dhe kulturës janë prekur në një mënyrë apo në një tjetër nga kjo situatë. Pasojat më të rënda dhe, në një farë mënyre, logjike, i pësoi në radhë të parë kinematografia shqiptare. Rrjedhoje e natyrshme e ndryshimeve politike dhe ekonomike që pësoi Shqipëria, e pakësimit të ndjeshëm të subvencioneve të shtetit për kulturën, ka sjellë pakësimin e numrit të filmave

shqiptarë të prodhuar. Nga 14 filma artistikë, 40 dokumentarë dhe po aq filma vizatimorë që prodhoheshin në një vit para 1990, në 2 filma artistikë, 3 dokumentarë dhe 6 filma vizatimorë, të prodhuar gjatë 1997. Kohët e fundit, me nxjerrjen e ligjit të ri për kinematografinë dhe me krijimin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, po shkohet drejt ndryshimit të mendësisë së një industrie e cila ishte mësuar të mbahej vetëm nga shteti, duke kërkuar burime alternative financiare e bashkëprodhime.

Ndërkohë, pavarësisht nga vështirësitë, në Shqipëri vazhdon të ketë një jetë teatrale e koncertale në qytetet kryesore të vendit, ndonëse, me përjashtim të ndonjë iniciative të kufizuar, në përgjithësi mund të thuhet se ende mungojnë teatrot private. Ndjehet, gjithsesi, nevoja e një ristrukturimi të arteve të skenës, për të krijuar struktura më elastike, që i përshtaten kushteve të reja të krijuara, duke bërë të mundur hapësirën e nevojshme për nisma të reja private. Shqetësim serioz vazhdon të mbetet hemorragjia e artistëve, sidomos e instrumentistëve, të cilët si rrjedhojë e një shkolle të mirë të muzikës në Shqipëri, e kanë më të lehtë të gjejnë punë në Perëndim, e sidomos në vendet fqinjë.

Një situatë më pozitive, ekziston në fushën e botimeve, ku dalja e një numri të madh botuesish privatë menjëherë pas rënies së komunizmit, ka bërë që tanimë të jetë konsoliduar një industri e librit mjaft më efikase e më afër standarteve perëndimore. Aktualisht ekzistojnë rreth 100 shtëpi botuese, por në fakt afërsisht dhjetë prej tyre tanimë janë konsoliduar duke botuar afro 900 tituj të rinj në vit, me një mesatare prej 2.5 libra në ditë.

Një politikë më largpamëse është duke u konkretizuar në drejtim të trashëgimisë kulturore, si rrjedhojë edhe e interesimit dhe projekteve mbështetëse të Këshillit të Evropës dhe të UNESCO-s. I veçantë dhe i rëndësishëm është projekti për zhvillimin e turizmit kulturor, i cili jo vetëm do të ndihmojë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e Monumenteve të Kulturës, por do të përbëjë edhe një burim të rëndësishëm ekonomik. Aktualisht në Shqipëri mbrohen me ligj 1200 monumente të kulturës, njëri

prej të cilëve, qyteti antik i Butrintit, ka fituar tashmë statusin e Pasurisë së Kulturës Botërore, ndërsa dy qytete të tjerë, Berati dhe Gjirokastra, janë në listën e pritjes për të përfituar këtë status.

Arti dhe kultura në Shqipëri ndodhen para sfidash të mëdha dhe për një kohë relativisht të gjatë do vazhdojnë të ndjejnë pasojat e krizës së rëndë shoqërore, ekonomike dhe politike që po kalon vendi. Por, nga ana tjetër, gjithnjë e më shumë njerëz janë duke u bërë të vetëdijshëm për nevojën e artit e kulturës si një mjet për të zbutur krizën e rëndë shpirtërore që po kalojnë. Në kushtet e mungesës së mjeteve financiare, ndjehet urgjentisht nevoja e nje politike të re nga ana e shtetit, për të ruajtur ata elementë pozitiv të trashëguar nga e kaluara e, në radhë të parë shkollat e artit, që në disa raste kanë një nivel të mirë profesional. Mbi të gjitha ndjehet nevoja e ndryshimit të mendësive: së pari nga ana e shtetit, i cili duhet të kuptojë rolin e tij rregullues dhe të heqë dorë nga inercia e prirjeve centralizuese, gjë që ka sjellë që gjithë jeta dhe qendrat kulturore në rrethe të varen drejtpërdrejt nga Ministria e Kulturës në Tiranë, duke mos i lënë thujtë asnjë kompetencë e asnjë mjet financiar pushtetit lokal; së dyti, ndryshimit të mendësisë nga artistët, që s' duhet ta shohin më shtetin si shpëtimtarin e tyre.

# KAPITULLI 4 TRANZICION I VESHTIRE

## 4.1. Histori e Shkurtër e Shtetit Shqiptar

Shqiptarët janë ndër banorët më të lashtë të gadishullit ballkanik. Shkencëtarët përgjithësisht janë të një mendje që t'i shohin ata si pasardhës të ilirëve, të cilët shtriheshin në perëndim të Ballkanit. Shteti i parë feudal shqiptar, Principata e Arbërisë, u krijua në fund të shek XII dhe në fillim të shek. XIII-të. Pas kësaj Shqipëria ra nën sundimin e feudalëve anzhuinë që krijuan Mbretërinë e Arbërisë (Regnum Albaniae), si dhe nën pushtimin e Perandorisë Serbe të Stefan Dushanit. Në mesin e shek. XIV-të, pas dëbimit të sundimtarëve anzhuinë dhe serbë u krijuan disa principata feudale shqiptare, si ajo e Balshajve në Shkodër, e Topiajve në Durrës, e Muzakajve në Berat, e Shpatajve në Artë e të tjera më të vogla. Kjo periudhë lirie do të ishte tepër e shkurtër, sepse në fund të shek. XIV-të, për shqiptarët dhe për popujt e tjerë të Ballkanit u shfaq një rrezik i ri, ai i turqve osmanë. Pas betejës së Kosovës (1389) principatat feudale shqiptare u pushtuan dhe ranë nën vasalitetin e sulltanit.

Në vitet 1443 shpërtheu kryengritja kundër pushtimit osman nën udhëheqjen e Gjergj Kastriot Skënderbeut, që çoi në çlirimin e Shqipërisë duke arritur dhe bashkimin e pjesës më të madhe të principatave feudale në një shtet të vetëm e të përqëndruar nën udhëheqjen e Skënderbeut. Lufta kundër pushtimit osman dhe bashkimi i principatave shqiptare (1443-1468) forcuan unitetin e shqiptarëve dhe ndjenjën e kombësisë së përbashkët. Prej kësaj lufte populli shqiptar fitoi heroin e vet kombëtar të përmasave evropiane, Gjergj Kastriot Skënderbeun dhe simbolet shtetërore, si flamurin kombëtar që mban edhe sot, i cili

ishte flamuri i familjes fisnike të Kastriotëve.

Shteti i pavarur shqiptar rilindi në fillim të shek. XX-të, kur Perandoria Osmane po shkatërrohej nga Lufta Ballkanike (1912). Më 28 Nëntor 1912 një kuvend shqiptarësh i mbledhur në Vlorë, nën kryesinë e patriotit Ismail Qemali, shpalli pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe krijoi një Qeveri të Përkohshme. Pavarësia shqiptare u bë shpejt objekt i shqyrtimit nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër me pjesëmarrjen e gjashtë Fuqive të Mëdha: Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Austro - Hungaria dhe Italia. Kjo konferencë përcaktoi statusin e Shqipërisë si shtet i pavarur dhe neutral, nën garancinë e Fuqive të Mëdha, përcaktoi kufijtë e Shqipërisë që janë edhe sot, duke lënë jashtë më tepër se gjysmën e trojeve të banuara nga shqiptarët, si dhe sovranin e Shqipërisë, princin gjerman Wilhem Von Wied. Një Komision Ndërkombëtar i Kontrollit hartoi kushtetutën e parë të këtij shteti (Statuti Organik i Shqipërisë, prill 1914) dhe u ngarkua të mbikqyrte administratën dhe financat. Nga viti 1920 - 1924 në Shqipëri u vendos për herë të parë një demokraci parlamentare dhe u miratuan dy kushtetuta : Statuti i Lushnjës (1920) dhe Statuti i Zgjeruar i Lushnjës (1922). Mirëpo lufta ndërmjet dy grupimeve politike që përfaqësonin dy prirje të ndryshme çoi në Revolucionin e Qershorit të vitit 1924. U krijua një Qeveri Demokratike, nën kryesinë e peshkopit ortodoks Fan Noli, i cili përfaqësonte forcat demokratike dhe përparimtare. Jeta e qeverisë së Fan Nolit zgjati vetëm gjashtë muaj. Reformat demokratike të premtuara nuk u realizuan. Në dhjetor të vitit 1924, kundërshtari i kësaj qeverie Ahmet Zogu, me ndihmën e serbëve, u rikthye në Shqipëri. Në



***Ngjarjet e vitit 1997 dëshmuuan se tranzicioni demokratik në Shqipëri paraqitet më i vështirë dhe më i gjatë nga sa parashikohej.***

periudhën 1925 - 1928 ai qeverisi vendin si Kryetar i Republikës dhe më vonë, 1928 - 1939 u vetëshpall Mbret i Shqiptarëve. Gjatë 15 vjetëve të sundimit të tij u miratuan dy kushtetuta: Statuti i Republikës Shqiptare (1925) dhe Statuti i Mbretërisë Shqiptare (1928), Kodi Civil i vitit 1929 etj. Gjatë Luftës së Dytë Botërore Shqipëria u pushtua së pari nga Italia dhe më pas, në vitin 1943 nga Gjermania. Vendi u çlirua më 29 nëntor 1944.

Mbas çlirimit të vendit në Shqipëri u vendos regjimi komunist. Në krye të Partisë Komuniste Shqiptare (më vonë Partia e Punës së Shqipërisë) dhe të shtetit ishte Enver Hoxha, i cili e sundoi vendin me dorë të hekurt. Regjimi komunist në Shqipëri ishte më i ashpri ndër vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, dogmatik dhe stalinist, i paepur ndaj çdo ndryshimi në sensin liberal. Në marrëdhëniet ndërkombëtare fillimisht Shqipëria pati marrëdhënie të mira me Jugosllavinë (deri më 1948), me BRSS (deri më 1960) dhe me Kinën (deri më 1978); më vonë u vetizolua, duke u ndarë jo vetëm nga Perëndimi, por edhe nga Lindja. Nga frika e një pushtimi imagjinar vendi u mbush me bunkerë dhe u pajis me një armatim konvencional të jashtëzakonshëm. Mbas prishjes së marrëdhënieve me Kinën (1978) u ndërpre çdo ndihmë ekonomike nga jashtë; brenda pak viteve ekonomia rreptësisht e planifikuar dhe e centralizuar ra në një kolaps të plotë.

Revolucioni Demokratik në Shqipëri filloi pak më vonë se në vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. Në dhjetor 1990 u krijua partia e parë opozitare, Partia Demokratike. Në mars 1991 u organizuan zgjedhjet e para pluraliste dhe u vendos një demokraci parlamentare. Zgjedhjet e përgjithshme të marsit 1992 sollën në pushtet opozitën antikomuniste, Partinë Demokratike, të drejtuar nga Sali Berisha, i cili më pas u zgjodh President i Shqipërisë. Nga qershori 1997 vendi qeveriset nga koalicioni i udhëhequr nga socialistët, të drejtuar nga Fatos Nano, kryeministër.

### **Monarki apo Republike?**

Shqipëria është i pari vend paskomunist që ka zhvilluar një Referendum për formën e regjimit: monarki apo republikë. Deri në pranverën e vitit 1997 kërkesat o vazhdueshme të legalistëve për organizimin e Referendumi kishin marrë përgjigje negative. Madje, pretendenti për fronin, Leka Zogu, ishte dëbuar nga vendi më 1993, pas shpërfilljes së tij për t'u pajisur me pasaportë të Republikës së Shqipërisë. Por, në rrethanat e krijuara në pranverën e vitit 1997, kërkesa e legalistëve për të zhvilluar Referendumin për formën e regjimit gjeti jehonë pozitive. Referendumi u caktoi të zhvillohej në të njëjtën ditë me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.

Referendumi u paraprir nga një fushatë intensive e pretendentit të fronit, Lekës së Parë. Ai e zhvilloi fushatën në mbarë vendin, pavarësisht se Ligji i Gjendjes së Jashtëzakonshme ndalonte mbledhjet në vende publike. Po ashtu fushata pro monarkisë zuri një vend të rëndësishëm në median elektronikë. Ndërkohë partitë politike, të zëna me fushatën për zgjedhjet e deputetëve në Kuvendin Popullor, i kushtuan pak vëmendje Referendumi.

Sipas rezultateve zyrtare, për monarkinë votuan rreth 30% e votuesve, ndërkohë që Partia e Legalitetit, që përfaqësonte identitetin monarkist, mori vetëm 4% të votave. Rezultati i Referendumi u kundërshtua nga monarkistët, të cilët të parë nga Leka i Parë, me uniformë ushtarake dhe i armatosur, organizuan një marshim proteste për në selinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në incidentin që ndodhi në këtë rast u vra një demonstrues. Ndaj Lekës së Parë u hap një proces penal, por disa ditë më pas ai u largua për në Afrikën e Jugut, ku jeton edhe sot e kësaj dite.

### **4.2. Pluse dhe Minuse të Tranzicionit Politik**

**Ngjarjet e vitit 1997 dëshmuuan se tranzicioni demokratik në Shqipëri paraqitet më i vështirë dhe më i gjatë nga sa parashikohej.** Ai që konsiderohet tranzicion nga diktatura në demokraci mesa duket pati si shkallë të ndërmjetme një proces të kalimit nga totalitarizmi në autoritarizëm, dukuri kjo që është vënë re edhe në disa vende të tjera të Lindjes. Shkaqet e kësaj dukurie lidhen sa me traditat e varfëra demokratike dhe shprehitë politike të trashëguara, aq dhe me ngjarjet në rajon, të cilat padyshim kanë krijuar faktorë që pengojnë një zhvillim normal demokratik. Por ndër shkaqet duhen përmendur dhe disa ngurrime të politikës perëndimore, e cila duket se u gjend e papërgatitur për të përballuar gjithë kompleksitetin e problemeve të shoqërive paskomuniste, si ajo shqiptare. Në të njëjtën kohë, tranzicioni politik ndërthuret

me shndërrimet e tjera në shoqërinë shqiptare, e cilat kanë ndikuar jo pak në natyrën dhe intensitetin e transformimit politik. Tranzicioni politik nga diktatura në demokraci është ndërthurur me tranzicionin ekonomik nga ekonomia kolektive e centralizuar në ekonominë e lirë të tregut; me tranzicionin nga një shoqëri rurale në një shoqëri urbane, me zhvendosje të mëdha e të pakontrolluara demografike; me tranzicionin nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur. Ky ndërveprim faktorësh ka ndikuar në ndërlikimin e procesit të tranzicionit politik, çka përbën një veçori dalluese të Shqipërisë paskomuniste krahasuar me vendet e tjera të Lindjes.

Nëse në vende të tjera të Lindjes transformimi politik, pra ndërtimi i institucioneve demokratike, është zhvilluar në një mjedis më të ekuilibruar, në Shqipëri vështirësitë kanë qenë më të mëdha. Ndërsa në vitet e para pas rënies së komunizmit theksi u vu në transformimin politik, çka ishte e kuptueshme, më pas u bë e qartë se pa një zhvillim harmonik të të gjithë aspekteve të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, transformimi politik mund të ndalet, madje mund të bëjë edhe hapa prapa.

Nëse përgjatë një procesi normal, tranzicioni politik ka si bashkudhëtar kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut, në Shqipëri ai pati për një farë kohe si bashkudhëtar edhe fenomenin e tregut informal të depozitave. Pavarësisht nga përpjekjet për të kryer një reformë ekonomike dhe privatizim të bazuar në modelet perëndimore, në më të shumtën e rasteve kapitalizmi u konceptua si një kapitalizëm i egër, pa rregulla, ku pasurimi sa më i shpejtë përlligjte edhe shkeljen e ligjeve. Duke sjellë një polarizim të skajshëm në një shoqëri të mësuar me barazitizëm, ky lloj kapitalizmi, nga njëra anë solli çlirimin e energjive dhe gjallërimin e iniciativës së lirë, nga ana tjetër solli edhe një parazitizëm masiv dhe mendësinë e të jetuarit pa punë ose të pasuruarit pa mund.

Përveç kësaj, transformimi politik përkoj në kohë me një aspekt tepër të rëndësishëm të tranzicionit të shoqërisë

shqiptare nga një shoqëri rurale në një shoqëri urbane, fenomen ky, i cili nga përmasat që mori, mund të quhet si një veçori e tranzicionit shqiptar në raport me vendet e tjera ish-komuniste të Evropës. Mentalitete, mënyra të ndryshme jetese, stereotipe e botëkuptime të reja përplasen në një hapësirë të ngushtë, disa herë duke krijuar tensione dhe probleme mjaft të mprehta.

Dhe më në fund, transformimi politik ka ecur në një hap, madje shpesh më ngadalë, se sa procesi i kalimit nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur. Shqipëria ishte vendi më i izoluar dhe më i mbyllur i Evropës, dhe ky fakt ishte pasqyruar edhe në mendësitë e njerëzve. Hapja e shpejtë e ka favorizuar shndërrimin kulturor e politik, e ka dinamizuar atë, por njëkohësisht e ka bërë edhe më kompleks.

Të gjitha këto sollën si rezultat që rënia e komunizmit në Shqipëri të shoqërohej edhe me një krizë identiteti dhe një krizë vlerash, të cilat duhen parë si shkak e pasojë të krizës shqiptare. Mungesa tradicionale e institucioneve, ku mund të mbështetej shoqëria në çaste të tilla krize, solli që kjo periudhë kalimi në shumë raste të konceptohej thjesht si një reaksion negativ ndaj sistemit komunist të përmbysur, duke e identifikuar demokracinë thjesht me antikomunizmin. Tranzicioni u konceptua si një ndërrim vendesh, për pasojë ideologjia komuniste u zëvendësua me një të ashtuquajtur "ideologji demokratike". Demokracia u paraqit kështu jo si një metodë, rrugë, rregulla loje, sundim i ligjit, por si një ideologji zëvendësuese. Kjo mënyrë procedimi përeaktoi termat e debatit politik, mbajti gjallë dhe vazhdon të mbajë gjallë, jo vetëm mentalitetet e Luftës së Ftohtë, por edhe personazhet e saj.

Kriza që kapërtheu Shqipërinë gjatë vitit 1997, shpreh qartë domosdoshmërinë e krijimit të institucioneve të qëndrueshme demokratike, si dhe të një kulture të re politike. Në këtë drejtim mbështetja e institucioneve ndërkombëtare, si dhe vendeve Perëndimore ka patur dhe ka një rol të dorës së parë në tranzicionin shqiptar. Impakti i tyre në një vend të vogël si

***Kriza që kapërtheu Shqipërinë gjatë vitit 1997, shpreh qartë domosdoshmërinë e krijimit të institucioneve të qëndrueshme demokratike, si dhe të një kulture të re politike.***

**Shqipëria ka një legjislacion të përparuar, një sistem demokratik që bazohet mbi ndarjen e pushteteve, një jetë parlamentare, një shtyp të lirë dhe është duke u krijuar një opinion publik aktiv**

Shqipëria është shumë i madh. Mësimet që mund të nxirren nga gabimet e të kaluarës do të shërbejnë padyshim për të hartuar një politikë më të qartë e afatgjatë për të krijuar e konsoliduar institucionet e mendësitë demokratike. Qoftë për shkak të rolit që ato kanë sot në zgjidhjen e konflikteve rajonale, qoftë për shkak të rolit historik të arbitrit që Fuqitë e Mëdha kanë luajtur në këtë rajon, qoftë për vetë gjendjen e rëndë ekonomike, që e bën të pamundur zhvillimin e vendit pa ndihma e investime të komunitetit ndërkombëtar, përsa e bashkësisë ndërkombëtare e në radhë të parë të vendeve të Evropës Perëndimore dhe SHBA-së do të vazhdojnë të mbetet mjaft e madhe në jetën shqiptare.

Një politikë e qartë e institucioneve dhe bashkësisë ndërkombëtare, rrjedhimisht do të kishte një rol vendimtar në ardhmërinë e demokracisë në vend. Por, pavarësisht nga kjo tablo, duhet thënë se transformimi politik e ekonomik në Shqipëri, krahas vështirësive dhe dukshëm përpara. Si periudhë e ndërmjetme e kalimit nga një gjendje në një tjetër, nga një sistem në një tjetër, tranzicioni nënkupton një bashkëjetesë për një farë kohe të dy gjendjeve. Institucionet e vjetra bashkëjetojnë me të reja, legjislacioni i vjetër me të riun, mentalitetet e vjetra me të reja. Por, pavarësisht nga kriza e pranverës së vitit 1997, pavarësisht nga disa rreshqitje të përkohshme, mund të thuhet se Shqipëria ka bërë hapa vendimtarë për shkëputjen nga e kaluara dhe procesi demokratik në vend është i pakthyeshëm.

Sot, Shqipëria ka një legjislacion të përparuar, një sistem demokratik që bazohet mbi ndarjen e pushteteve, një jetë parlamentare, një shtyp të lirë dhe është duke u krijuar një opinion publik aktiv, një vetëdije më e qartë për nevojën e respektimit të të drejtave të njeriut, të detyrave dhe përgjegjësisë të qytetarit, pra janë hedhur hapa përpara ndonëse jo gjithnjë me shpejtësinë e duhur, por të sigurt drejt krijimit të një shoqërie civile.

### 4.3. Shqipëria në Kontekstin Ballkanik

#### Demokracia dhe stabiliteti

I gjithë zhvillimi politik, ekonomik dhe shoqëror i Shqipërisë është i kushtëzuar në një masë të madhe nga zhvillimet në rajon. Veç faktorëve të brendshëm, fakti që ishte jo larg zonave të luftës në Bosnjë, e bënte Shqipërinë një vend jotërheqës për investitorët e huaj. Por, më tepër se ky fakt, një influencë të madhe në mbarë jetën shqiptare ushtron çështja e shqiptarëve të Kosovës, si dhe tensionet etnike në Maqedoninë fqinje, ku jeton një popullsi e konsiderueshme shqiptare. Kriza e Kosovës, që përbën një rrezik për gjithë rajonin, mbart një rrezik të vazhdueshëm, në radhë të parë për Shqipërinë.

Në Shqipëri jetojnë afro 3.5 milionë shqiptarë. Dy milionë shqiptarë jetojnë në Kosovë, të cilët përbëjnë 90 % të popullsisë së kësaj krahine. Në Maqedoni jetojnë rreth 500-600 mijë shqiptarë, që sipas regjistrimit të fundit në këtë vend, përbëjnë 23 % të popullsisë, shifër kjo që kontestohet nga shqiptarët. Ndërkohë në Malin e Zi jetojnë 40-50 mijë shqiptarë, që llogariten 6 % të popullsisë së kësaj republike. Sipas statistikave greke dhe shqiptare, aktualisht në Greqi punojnë dhe jetojnë mbi 350 mijë shqiptarë, të cilët kanë shkuar atje në vitet e tranzicionit.

Nga ana tjetër, ky peizazh i shpërndarjes së shqiptarëve në të gjithë vendet fqinjë, pa llogaritur ata që jetojnë në vende të tjera ballkanike, sidomos në Turqi, e bën faktorin shqiptar tepër të ndjeshëm për të gjithë rajonin. Është kjo arsyeja që Shqipëria ka një peshë të ndjeshme në drejtpeshimin e brishtë të rajonit. Kjo, me sa duket, ka kushtëzuar shpesh gjatë viteve të fundit, edhe politikën e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Shqipërisë dhe qëndrimet e saj ndaj zhvillimeve politike të atyshme. Është diskutuar shpesh tema e raporteve mes stabilitetit dhe demokracisë në Shqipëri. Është e qarte se pa stabilitet nuk mund të ketë një demokraci që funksionon normalisht. Por ngjarjet e fundit e bëjnë të qartë se, po ashtu, pa një zhvillim harmonik

të demokracisë nuk mund të ketë stabilitet afatgjatë. Politika e mbivlerësimit nga bashkësia ndërkombëtare në një sërë rastesh të nevojës së stabilitetit në dëm të zhvillimit të demokracisë rezultoi e pafrytshme.

Gjatë viteve të tranzicionit Shqipëria u bë anëtare e organizmave kryesore ndërkombëtare: OSBE, Këshillit të Europës, Partneritetit për Paqe, si dhe mori pjesë në një sërë nismash rajonale. Një numër traktatesh të miqësisë dhe të bashkëpunimit u nënshkruan me Italinë, Greqinë, Turqinë, Francën, Bullgarinë dhe vende të tjera. Ndonëse pas krizës së fundit, imazhi i krijuar për Shqipërinë, nuk mund të quhet i favorshëm, Shqipëria po bën përpjekje për një politikë të jashtme aktive dhe të moderuar. Realizmi politik dhe elasticiteti në trajtimin e çështjes së Kosovës; vendosja e një balance ndërmjet orientimit evropian dhe atij amerikan në politikën e jashtme; aktivizimi maksimal në iniciativat rajonale, sidomos në ato që lidhen me marrëdhëniet ballkanike; përpjekjet për përmirësimin e marrëdhënieve me fqinjët, duke përfshirë edhe Serbinë; ruajtja e ekuilibreve ndërmjet dy fqinjëve evropianoperëndimorë, Italisë dhe Greqisë nga njëra anë dhe ndërmjet dy fqinjëve ballkanikë Greqisë dhe Turqisë nga ana tjetër; ngrirja e marrëdhënieve me Konferencën Islamike dhe pranimi në gjirin e Konferencës së Vendeve Frankofone - ky do të ishte një përshkrim i shkurtër i politikës së jashtme të sotme të Shqipërisë.

Kosova përbën aksin kryesor të politikës së jashtme të Shqipërisë. Në mënyrë të përmbledhur, Qeveria shqiptare është për një zgjidhje paqësore të problemit të Kosovës; nuk kërkon ndryshimin e kufijve, është për rrugën e dialogut, për bisedime të drejtpërdrejta shqiptaro - serbe nën kujdesin ndërkombëtar, trajtimin e Kosovës si element federativ, të barabartë me republikat e tjera jugosllave, me aspekte plotësuese të modeleve evropiane.

Në një kontekst më të gjerë, nga qëndrimi që shtete të ndryshme mbajnë ndaj çështjes së pazgjidhur të Kosovës, varen në një masë të madhe edhe

marrëdhëniet e Tiranës me to. Nga ana tjetër, vetë pozicioni i Tiranës ndaj çështjes së Kosovës, varet jo pak nga rekomandimet e aktorëve kryesorë të politikës botërore. Për herë të parë që nga fillimi i viteve '90 ministrat e jashtëm të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, Milo dhe Milutinović janë takuar në New York në fund të tetorit, 1997, në një përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet e ngrira dypalëshe. Një muaj më pas, gjatë Samitit të Kretës, për herë të parë pas 50 vjetësh, që nga takimi i Enver Hoxhës me Titon në Beograd, kryeministri Nano u takua me Presidentin Milosheviç, Shqipëria dhe Jugosllavja kanë patur dhe vazhdojnë të kenë marrëdhënie të ndera për shkak të shtypjes së vazhdueshme mbi popullsinë shqiptare të Kosovës. Tirana e ka kushtëzuar përmirësimin e marrëdhënieve me Beogradin me respektimin e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës. Rruga për përmirësimin e marrëdhënieve mes Tiranës dhe Beogradit është zgjatur edhe më shumë pas ngjarjeve të përgjakshme të vitit 1998 në Kosovë, të cilat veçanërisht muajt e fundit janë mbushur me krime të rënda ndaj popullsisë civile me synimin e një spastrimi etnik në Kosovë. Si rezultat, që nga muaji maj i vitit 1998 një numër në rritje kosovarësh, shumica fëmijë, gra e pleq të pambrojtur po refugjojnë në zonën Veri-Lindore të Shqipërisë. Agresioni i Qeverisë Serbe, i dënuar zyrtarisht nga Bashkësia Ndërkombëtare, i ka zhvlerësuar përpjekjet e mësipërme për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve.

Qeveria e tanishme Shqiptare ka theksuar vektorin ballkanik të politikës së saj dhe ka arritur të ndërtojë marrëdhënie të mira me fqinjët e tjerë ballkanikë. Shqipëria dhe Maqedonia kanë shënuar hapa përpara në marrëdhëniet dypalëshe, duke nënshkruar brenda një kohe të shkurtër 14 marrëveshje në fusha të ndryshme. Gjithashtu, marrëdhëniet Shqipëri - Greqi janë forcuar dhe zgjeruar vazhdimisht, çka lidhet si me progresin e shënuar në Shqipëri në respektimin e të drejtave të pakicës greke, ashtu edhe me kapërcimin e disa tensioneve që vëreheshin herë pas here mes dy vendeve. Ndërsa marrëdhëniet Shqipëri - Turqi i

***Kosova përbën aksin kryesor të politikës së jashtme të Shqipërisë.***

përmbahen një konstanteje tradicionale pozitive, ku peshën kryesore e kanë marrëdhëniet ushtarake.

Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në një sërë nismash rajonale, si Samiti i Liderëve të Ballkanit, Nisma e Detit të Zi, Korridori 8, SECI, të cilat synojnë zgjerimin e bashkëpunimit rajonal në fusha të ndryshme.

### ***Ligji, Zbatimi i tij dhe Kushtetuta***

Pas plotësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor, dukuria e bashkëjetesës së legjislacionit të ri të standarteve evropiane me legjislacionin e vjetër të periudhës komuniste është kapërcyer. Por, nga ana tjetër, legjislacioni i ri shqiptar nuk buron ose nuk mbështetet nga ligji themelor i shtetit, Kushtetuta. Shqipëria është i vetmi vend ish-komunist i Lindjes që nuk ka arritur të miratojë Kushtetutën e periudhës paskomuniste. Vendi vazhdon të qeveriset nga një Paketë ligjesh Kushtetuese, Dispozitat Kryesore Kushtetuese, të miratuara më 1991 dhe të konsideruara si një Kushtetutë e përkohshme.

Situatat e tensionuara në të cilat Shqipëria ka kaluar sidomos pas zgjedhjeve të majit 1996, kanë penguar arritjen e konsensusit të nevojshëm politik që do të lejonte miratimin e dokumentit themelor të shtetit. Nga ana e saj, mungesa e Kushtetutës ka reflektuar negativisht në disa momente krizash ose konfliktesh mes institucioneve të brishta shqiptare. Pavarësisht nga fakti se legjislacioni ka shkuar drejt kompletimit dhe përmirësimit, ai nuk mund të kompensojë ose zëvendësojë Kushtetutën e vendit. Me vendim të Kuvendit Popullor është krijuar prej disa muajsh një Komision i posaçëm për hartimin e Kushtetutës së re. Edhe kjo ndërmarrje e re ende nuk ka mundur të sigurojë konsensusin e plotë politik të nevojshëm.

Megjithatë, vihet re një veprimtari e dendur e disa organizatave ndërkombëtare, të cilat po japin ndihmesën e tyre në përgatitjen e Kushtetutës si dhe në organizimin e një debati publik të frytshëm. Krahas Këshillit të Evropës, OSBE, Komisionit të Venecias etj., në procesin e hartimit të Kushtetutës janë

përfshirë aktivisht edhe shumë organizata joqeveritare vendase. Të gjitha përpjekjet synojnë që Kushtetuta e re të jetë një dokument konsensusi politik e popullor dhe jo fryt i votës së një mazhorance të caktuar. Pas miratimit në Kuvendi Popullor një Referendum popullor parashikohet të vendosë përfundimisht për Ligjin themelor të shtetit shqiptar.

Nënshkrimi nga Shqipëria i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka shtuar nevojën e përshtatjes ose pajtueshmërisë së legjislacionit të brendshëm shqiptar me Konventën. Aktualisht Shqipëria vazhdon të mbajë në fuqi rezervën e paraqitur në momentin e ratifikimit të Konventës dhe të Protokollit shtesë, lidhur me Ligjin Antigenocid. Ndërkohë, në aspekte të tjera, legjislacioni shqiptar ka njohur përmirësime në frymën e pajtueshmërisë me Konventën, siç ishte abrogimi i Ligjit për Shtypin. Por, debati më i madh, mbetet ai lidhur me heqjen e dënimit me vdekje. Kodi penal shqiptar parashikon dënimin kapital për disa lloje krimesh, kurse Protokollin Nr.6 i Konventës Evropiane të vitit 1983 kërkon heqjen e tij. Situata paraqitet e koklavitur. Nga njëra anë kemi angazhimin që Shqipëria ka marrë në momentin e hyrjes në Këshillin e Evropës për ta pezulluar dhe më pas hequr dënimin me vdekje; nga ana tjetër, kemi realitetin shqiptar që kërcënohet seriozisht nga fenomeni shqetësues i vetegjyqësisë dhe i rritjes së kriminalitetit. Një debat i gjerë vazhdon mes politikanëve, juristëve dhe grupeve të të drejtave të njeriut lidhur me aplikimin apo jo të dënimit me vdekje në Shqipëri. Kohët e fundit është hedhur edhe ideja e organizimit të një referendumi për heqjen ose jo të tij.

Ndoshta kontradikta më serioze në fushën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri është ajo mes nivelit relativisht të përparuar të legjislacionit dhe zbatimit të tij. Një ndër shkaqet e krizës në vend lidhet edhe me shkeljet e ligjit. Pavarësia e diskutueshme e sistemit të drejtësisë, niveli i ulët i gjykatësve, korrupsioni i përfolur në rradhët e tyre duhen llogaritur në faktorët me ndikim negativ. Ndërkohë, niveli juridik i

***kontradikta më serioze në fushën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri është ajo mes nivelit relativisht të përparuar të legjislacionit dhe zbatimit të tij.***

qytetarëve shqiptarë, edukata e tyre juridike mbetet ende e ulët. Me të drejtë, programet e asistencës ndërkombëtare janë përqëndruar në trainimin e gjyqtarëve, por përparësi përbën edhe edukimi i qytetarëve për njohjen e ligjeve.

### *Partitë dhe Klasat Politike*

Kriza e thellë politike që përfshiu Shqipërinë gjatë vitit 1997, mund të konsiderohet edhe si shprehje e krizës së vetë klasës politike në vend. Kriza tregoi kufizimet e kësaj klase politike, sjelljet e së cilës vazhdojnë të mbetën të kushtëzuara jo rrallë nga e kaluara, duke u karakterizuar shpesh nga logjika e konfliktit, e përjashtimit të tjetrit, nga intoleranca dhe nga populizmi. Klima e tensionimit dhe konfliktit të vazhdueshëm mes partive politike kryesore në luftë për pushtet është kthyer në një pengesë serioze për kthimin e vendit në normalitet, për rivendosjen e rendit dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare.

Nga ana tjetër, vetë konceptet politike, e në radhë të parë ato të së Majtës dhe të së Djathtës, aq shumë të përdorura aktualisht në jetën politike shqiptare, në të vërtetë ende s'kanë marrë një konotacion të qartë politik bashkëkohor. Jo rrallë, më shumë se sa të bazuar në programet, apo në një stratifikim të qartë social, partitë e konsiderojnë veten të djathtë apo të majtë në vartësi nga zanafilla tyre historike, raportet me të shkuarën komuniste, qoftë edhe thjesht nga personazhet që dominojnë njërin apo tjetrin parti. Jo rrallë has parti të ashtuquajtura të djathta, të cilat bëjnë të vetat teza dhe koncepte ekonomike apo sociale tipike të së majtës, në përpjekje për të fituar apo ruajtur simpatinë e masave votuese, ashtu siç gjen edhe parti e forca politike të ashtuquajtura të majta, që, si rrjedhojë e komplekseve të së shkuarës apo si pasojë e nevojave të çastit, përvetësojnë e përpiqen të vënë në jetë programe e masa ekonomike të djathta, duke u bërë, madje, nganjëherë, edhe më radikalë në këtë drejtim sesa vetë e djathta.

Jeta politike e vendit vazhdon të dominohet plotësisht nga dy forcat

kryesore politike, që u shfaqën në jetën shqiptare pas rënies së komunizmit: Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Mes tyre ekziston një polarizim i skajshëm, që në pjesën më të madhe të rasteve e bën thuajse të pamundur bashkëpunimin konstruktiv, madje edhe për çështje si ajo e hartimit të Kushtetutës. Partia Socialiste, pasardhëse e Partisë së Punës, është partia kryesore e koalicionit të majtë, aktualisht në pushtet. Ajo fitoi zgjedhjet e qershorit 1997, duke zënë në parlament një shumicë mbi dy të tretat e vendeve së bashku me partitë e tjera që përbëjnë koalicionin qeveritar: Partia Socialdemokrate, Aleanca Demokratike, Partia Agrare, si dhe Partia e Të Drejtave të Njeriut, që përfaqëson pakicën greke dhe pakicat e tjera etnike që ekzistojnë në Shqipëri. Pavarësisht nga humbja që pësoi në zgjedhjet e fundit parlamentare, si pasojë e të cilave humbi pushtetin, të cilin e mbante prej pesë vjetësh, si dhe të krizës së brendshme që kaloi në pjesën e parë të vitit 1997, Partia Demokratike mbetet partia e dytë në vend, me 25% të vendeve në parlament, duke qenë, në të njëjtën kohë edhe partia kryesore opozitare.

Ndonëse fillimisht i njohu rezultatet e zgjedhjeve politike të qershorit 1997, Partia Demokratike e ka bojkotuar parlamentin disa herë, duke vënë në dyshim legjitimitetin e tij dhe duke kërkuar zgjedhje të reja të parakohshme politike ose formimin e një qeverie teknike. Të përfaqësuara në Kuvendin Popullor janë gjithashtu edhe Partia Republikane, E Djathta e Bashkuar Shqiptare, Balli Kombëtar dhe Partia e Legalitetit (monarkistët), këto dy të fundit, të ashtuquajtura parti "historike", trashëgimtare të partive antikomuniste të krijuara gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe që pas përfundimit të saj, me ardhjen e komunistëve në pushtet vazhduan të ekzistojnë në emigracion. Partitë e tjera të përfaqësuara në Kuvendin Popullor, pavarësisht se nuk arritën të kapërcejnë pragun e përcaktuar nga ligji për përfaqësim në parlament, janë Bashkimi Liberal (ish-Bashkimi Socialdemokrat), Partia Demokristiane, si dhe Partia e Bashkimit Demokrat. Përfaqësimi i këtyre partive u bë i mundur vetëm nëpërmjet

*Pas shtatë vjet sistemi shumëpartiak, mund të thuhet se në Shqipëri s'është krijuar ende një kulturë politike bashkëkohore, e shprehur nga një klasë politike e aftë të nxjerrë vendin nga trashëgimia e shprehitë politike të së kaluarës.*

përfshirjes të kryetarëve të tyre në listën elektorale shumëmërore të Partisë Demokratike. Tre partitë e fundit, së bashku me Partinë e Legalitetit janë në aleancë me Partinë Demokratike, duke formuar bllokun kryesor të opozitës, Bashkimin për Demokraci. Deri në fund të vitit 1997 Partia Komuniste vepronte ilegalisht për shkak të nxjerrjes së saj jashtë ligjit më 1992. Pas diskutimesh dhe debatesh të shumta, Kuvendi Popullor miratoi legalizimin e Partisë Komuniste. Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Partia Republikane kanë shtypin e tyre të përditshëm, ndërsa disa parti të tjera botojnë gazeta periodike me tirazhe të kufizuara.

Pas shtatë vjet sistemi shumëpartiak, mund të thuhet se në Shqipëri s'është krijuar ende një kulturë politike bashkëkohore, e shprehur nga një klasë politike e aftë të nxjerrë vendin nga trashëgimia e shprehitë politike të së kaluarës. Në klasën politike shqiptare spikatin ende grupime antikomunistësh, ish-komunistësh dhe nacionalistësh, produkt i tipareve specifike të revolucionit demokratik të vitit 1991, në një vend ku regjimi i mëparshëm komunist s'kishte lejuar asnjë formë disidence. Si pasojë, në tërësinë e saj klasa politike mbetet e prirur të shohë shpesh herë më shumë prapa sesa përpara.

Kriza e vitit 1997 shprehu qartë si nevojën e përsheptimit të krijimit të një klase të re politike, pa komplekset dhe shprehitë e së kaluarës, ashtu dhe nevojën e reformimit të partive politike ekzistuese. E majta, duke qenë tanimë në pushtet, duhet të mos mendojë se është plotësisht e reformuar dhe e çliruar nga e shkuara e saj politike. E djathta ndjen nevojën e riorganizimit, duke u mbështetur jo më mbi konceptin e shkatërrimit të kundërshtarit, por në koncepte politike të bashkëjetesës demokratike. Ndërkohë që ndjehet gjithnjë e më shumë nevoja e konsolidimit të qendrës, si një shprehje e moderacionit aq të nevojshëm në një shoqëri politikisht të polarizuar.

### *Zgjedhjet: Tradita e dy të tretave*

Gjatë 7 vjetëve të pluralizmit qytetarët shqiptarë kanë marrë pjesë gati çdo vit në një proces zgjedhor (4 herë zgjedhje parlamentare, 2 herë zgjedhje lokale dhe një herë Referendum për Kushtetutën). Brenda 13 muajve, nga maji 1996 deri në qershor 1997 shqiptarët shkuan tri herë në kutitë e votimit. Më 26 maj 1996 në Shqipëri u zhvilluan zgjedhjet parlamentare, të parat që nga ardhja në pushtet e Partisë Demokratike më 1992. Procesi elektorale u shoqërua me parregullsi. Ditën e zgjedhjeve Partia Socialiste dhe partitë e tjera të opozitës u

*Tabela 10 - Rezultatet e Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 1996*

Partia	Votat	%	Nr. i Vendeve	%
Partia Demokratike	914, 218	55.50	122	87.0
Partia Socialiste	335, 40	20.40	10	7.0
Partia Social Demokrate	25, 019	1.50	-	-
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	66, 529	4.00	3	2.0
Partia Balli Kombëtar	81, 822	5.00	2	1.5
Partia e Legalitetit	34, 019	2.10	-	-
Partia Aleanca Demokratike	25, 679	1.50	-	-
Partia Republikane	94, 567	5.70	3	2.0
Partia Bashkimi Social Demokrat	32, 430	2.00	-	-
Partia Demokristiane	21, 068	1.30	-	-
Partia e Bashkimit për Demokraci	11, 789	0.70	-	-
Partia e Unitetit Kombëtar	3, 939	0.20	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>1, 344, 619</b>	<b>99.90</b>	<b>140</b>	<b>99.5</b>

\* turi i parë i votimit më 26 maj 1996; pjesëmarrja në votime: 89%  
 \* Burimi : Rilindja Demokratike 22.06.1996 dhe 03.07.1996

tërheqjen nga zgjedhjet duke i cilësuar të manipuluar. Ato njoftuan se nuk do t'rijninin legjitimitetin e Parlamentit të dalë nga këto zgjedhje. Më 28 maj policia përdori forcën për të ndaluar protestën e opozitës ndaj rezultatit të zgjedhjeve.

Vëzhguesit e huaj vërejtën manipulime të shumta në procesin elektoral të 26 majit. Raporti i ODIHR kritikonte ashpër Qeverinë për dhunimin e procesit elektoral, për falsifikime dhe frikësim të votuesve, por ngarkonte me përgjegjësi edhe opozitën për tërheqjen nga zgjedhjet. Qeveria amerikane nuk pranoi të njihje legjitimitetin e zgjedhjeve dhe kërkoi përsëritjen e tyre.

Disa parti si Aleanca Demokratike, Partia Social Demokrate, Partia Demokratiane, Legaliteti, sipas rezultateve zyrtare, nuk mundën të përfaqësoheshin në Parlament, pasi morën më pak se 4 % të votave. Socialistët, si dhe një numër partish të tjera refuzuan të shkojnë në Parlament. Ata u rikthyen atje vetëm në prill 1997, pas marrëveshjes së 9 marsit dhe krijimit të Qeverisë së Pajtimit Kombëtar. Zgjedhjet lokale të 20 tetorit 1996 u konsideruan nga vëzhguesit ndërkombëtarë si një hap pozitiv përpara në krahasim me zgjedhjet e majit, pavarësisht nga parregullsitë që u konstatuan. Ligji i ri elektoral u përmirësua dhe opozita nuk u pengua të zhvillojë mitingjet e saj elektorale.

Konflikti mes Qeverisë shqiptare dhe ODIHR lidhur me Raportin e kësaj të fundit për zgjedhjet e majit, çoi në tërheqjen e ODIHR nga vëzhgimi i zgjedhjeve lokale. Këshilli i Evropës mori rolin drejtues në vëzhgimin e procesit elektoral. Në këto zgjedhje Partia Demokratike fitoi mbi 80 % të vendeve në pushtetin lokal.

### Misioni ALBA

Në prill 1997, pas kërkesës së ngutshme të Qeverisë së Pajtimit Kombëtar, të kryesuar nga Bashkim Finco, për ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare, që do të parandalonte zgjerimin e konfliktit në Shqipëri, një forcë ushtarake prej rreth 7000 trupash zbatoi në brigjet shqiptare.

Operacioni me emrin Alba u udhëhoq nga vendi fqinj, Italia, por në të morën pjesë edhe ushtarë nga Greqia, Turqia, Franca, Spanja, Austria, Rumania dhe Danimarka. Ndryshe nga praktikat e njohura të krijimit të një force

ndërkombëtare, për herë të parë në Shqipëri, kjo forcë u krijua kryesisht me ushtarë që vinin nga vende fqinje ose nga vende që kanë pasur implikime të ndryshme politike në këtë vend. Me përjashtim të Spanjës dhe Danimarkës, të gjitha vendet pjesëmarrëse në operacionin Alba kanë luajtur rolë të ndryshme në historinë e Shqipërisë nga Pavarësia saj në fillim të shekullit deri më sot.

Vendimi i marrë nga Bashkimi Evropianë Perëndimor për të marrë mandatin e OSBE në rastin e dërgimit të forcës shumëkombëshe në Shqipëri pasqyroi ndarjet në gjirin e BE. Vendosja nën kapotën e OSBE-së dhe më pas, autorizimi i Këshillit të Sigurimit të Reflektos gjithashtu faktin se, ndërsa s'pranuan të dërgojnë trupa, SHBA dhe Rusia nuk pranuan të mbeteshin jashtë negociatave diplomatike. Topi kaloi në fashën e OSBE-së, e cila megjithëse një famëlye e gjatë, arriti t'i kapërcëjë një shtet ngurrmet dhe t'i hapë dritën jeshile misionit të parë ushtarak në historinë e organizatës. Ish-kancelari austriak Vranicki, i dërguar i posaçëm i OSBE-së në Shqipëri, mundi të marrë miratimin e raportit të tij dhe të bindë edhe skeptikët në gjirin e organizatës. Ndër to, bente pjesë sidomos Rusia, e cila kishte bërë të qartë se asnjë veprim ushtarak nuk do të ishte i pranueshëm për të, pa miratimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në New York u thye çdo rekord, kur brenda disa orëve të së Premtes së Pashkëve, Këshilli i Sigurimit miratoi kërkesën e paraqitur, me 14 vota pro dhe një abstenim. Kina, ish-aleatja historike e Shqipërisë komuniste, mblyti njërin sy dhe nuk vuri vetën ndaj kërkesës, megjithëse kjo binte ndesh me parimin e saj për mosndërhyrje në punët e brendshme të vendeve të tjera.

Dërgimi i Forcës Ndërkombëtare të Mbrojtjes Alba, ishte shprehje e shqetësimit se konflikti shqiptar mund të përhapet në pjesë të tjera të rajonit, sidomos në Kosovë. Ndërsa mandati i Albës ishte jo fort i qartë, çka bëri që shqiptarët t'i quajne ushtarët e saj "turistë të armatosur", Alba ndikoi fuqishëm në aspektin psikologjik. Mund të thuhet se më e rëndësishme nga ajo çka bënin 7 mijë ushtarët e huaj ishte prania e tyre në një vend ku shteti kishte rënë. Një vit pas zgjedhjeve të majit, më 29 qershor 1997, shqiptarët ia drejtuan përsëri kurrë të votimit. Zgjedhjet u zhvilluan në kushtet e gërdjes së jashtëzakonshme, e cila ishte në fuqi edhe ditën e votimeve. Numri i madh i armëve në duart e shqiptarëve përbente një kërcënim për procesin elektoral. Partia Demokratike nuk mundi të zhvillojë fushatë elektorale në Jug të vendit, për shkak të situatës së acaruar në disa rajone. Ndërkohe, megjithë një numër incidentesh që u vonë re gjatë fushatës elektorale, data e zgjedhjeve ishte relativisht e qetë. Krahas votimit për kandidatët për Parlamentin e ri, u zhvillua edhe votimi për formën e regjimit, monarki apo republikë. Zgjedhjet e 29 qershorit 1997 ishin zgjedhjet më të vëzhguara nga Komuniteti Ndërkombëtar, pas atyre të Bosnjës më 1996. Mbi 500 vëzhgues, të shoqëruar e të mbrojtur nga 7000 trupat e Forcës Ndërkombëtare të Mbrojtjes, Alba, vëzhguan procesin elektoral në të gjithë vendin. Në përfundim, vëzhguesit ndërkombëtarë i deklaruan zgjedhjet si "të përshtatshme dhe të pranueshme". Megjithë kushtet e vështira në të cilat u zhvilluan, rezultati i tyre reflektoi vullnetin politik të shqiptarëve. Presidenti Berisha, i rizgjedhur për një mandat të dytë pesëvjeçar, më 3 mars 1997, një ditë pas kishte vendosur gërdjen e jashtëzakonshme, e pranoi rezultatit e zgjedhjeve dhe disa ditë më pas dhe dorëhoqjen. Parlamenti i ri zgjedhi President të vendit, Rexhep Mejdani, ish-Sekretar i Përgjithshëm i PS, i cili më pas u tërhoq nga udhëheqësia në parti.



**Tabela 11 - Rezultatet e Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 1997**

Partia	Votat	%	Nr. i vendeve	%
Partia Demokratike	690,003	52.71	101	65.1
Partia Socialiste	336,167	25.82	**24	15.5
Partia Social Demokratike	32,537	2.49	9	5.8
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	37,191	2.71	4	2.5
Partia Balli Kombëtar	30,693	2.34	3	1.9
Partia e Legalitetit	42,567	3.28	2	1.3
Partia Aleanca Demokratike	35,598	2.73	2	1.3
Partia Republikane	31,573	2.41	1	0.6
Partia Bashkimi Liberal	10,457	0.80	1	0.6
Partia Demokratikane	12,728	0.98	1	0.6
Partia e Bashkimit për Demokraci	10,997	0.84	1	0.6
Partia Agrare	10,421	0.80	1	0.6
Partia e Unitetit Kombëtar	3,784	0.76	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>1,308,023</b>	<b>100.00</b>	<b>155</b>	<b>99.5</b>

\* turi i parë i votimit më 29 qershor 1997; Pjesëmarrja në votime 72.96 %

\*\* Sipas parimit proporcional Partia Demokratike fitoi dhe 27 vende të tjera (nga të cilat tri ia dha Partisë së Bashkimit Liberal dhe Partisë Demokratikane)

Burimi: Rezultatet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Korrik 1997.

Edhe pas zgjedhjeve të fundit, në Shqipëri nuk u prish tradita e dy të tretave. Më 1991 komunistët fituan dy të tretat e vendeve në Kuvend Popullor. Më 1992 demokratët fituan përsëri dy të tretat. Më 1996 demokratët, pas zgjedhjeve të diskutueshme të majit morën përsëri dy të tretat. Më 1997 ishin socialistët që fituan mbi dy të tretat. Ky fakt flet për lëvizje të mëdha të elektoratit sa nga njëri krah në tjetrin, për një shoqëri ende të pastabilizuar politikisht. Organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike, në përputhje me standartet perëndimore, mbetet testi nëpër të cilin do të duhet të kalojë deri në fund të shekullit demokracia e re shqiptare. Përvoja e deritanishme tregon se roli i OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në vëzhgimin e proceseve elektorale vazhdon të mbetet jetik.

### Të Drejtat e Njeriut

Viti 1997 ishte një vit tragjik dhe i shqetësuar për shqiptarët. Gjendja e të drejtave të njeriut në vend gjatë këtij viti njohu një përkeqësim të ndjeshëm. Muajt e kaosit dhe të anarkisë që përjetoi Shqipëria shkaktuan deri në fund të qershorit të po këtij viti, kur u mbajtën zgjedhjet e parakohshme politike, mëse

2.000 të vrarë, si dhe një numër mjaft të madh të gjymtuarish dhe të plagosurish. E drejta e jetës për shqiptarët u kërcënua seriozisht. Në fakt, që nga zgjedhjet e diskutueshme të majit 1996, kritikantët e organizmave ndërkombëtare për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri kishin ardhur duke u shtuar. Kritikantët kryesorë kishin të bënin me të drejtat e opozitës, privimin e saj nga e drejta e manifestimit, kontrollin thuajse të plotë të medias elektronike nga ana e Qeverisë, rastet e dhunës kundër gazetarëve etj. Po ashtu, kritika të shumta kishte për gjendjen e pakënaqshme të sistemit të drejtësisë si dhe për rolin e SHIK-ut, policisë sekrete shqiptare, që akuzohej për shmangie nga roli që i caktonte ligji, duke u përdorur për të luftuar opozitën politike. Gjendja u rëndua shumë në muajt e parë të vitit 1997, me shpërthimin e protestave, pas rënies së skemave piramidale. Më 2 mars 1997 Parlamenti shpalli ligjin e gjendjes së jashtëzakonshme, i cili ndalonte tubimet publike dhe vendoste censurën mbi gazetatat, gjë që, praktikisht solli ndalimin e botimit të pothuajse gjithë gazetave. Që natën e parë të shpalljes së ndalim qarkullimit, njerëz të pidentifikuar dogjën selinë e gazetës më të madhe të pavarur "Koha Jonë", në Tiranë, e cila kishte qenë kritike ndaj qeverisjes. Më 9 mars 1997 u arrit një kompromis mes forcave kryesore

politike që solli dorëheqjen e Qeverisë, shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, si dhe formimin e një Qeverie të Pajtitit Kombëtar, me ministra të propozuar nga 10 parti politike. Megjithatë, në muajt e ardhshëm në mbarë vendin vazhdoi të mbretëronte kaosi dhe anarkia e plotë, duke sjellë rrezikimin serioz të jetës, sigurisë dhe pasurisë së qytetarëve. Mungesa e plotë e rendit pati për pasojë një shtim të madh të kriminalitetit. Sistemi i drejtësisë ishte krejtësisht i paralizuar. Nga 36 gjykata që kishte gjithsej vendi, 15 ishin shkatërruar plotësisht, bashkë me një pjesë të madhe të dokumentacionit. Burgjet u shpërthyen dhe të gjithë të burgosurit u larguan, duke e shtuar edhe më pasigurinë në vend. Deri në fund të vitit 1997 ishte ende herët për të gjykuar rekordin e të drejtave të njeriut gjatë qeverisjes së koalicionit të udhëhequr nga socialistët, që dolën fitues nga zgjedhjet e qershorit 1997.

Megjithë përpjekjet dhe ndonjë përmirësim, gjendja e rendit dhe e sigurisë në vend mbetet problemi kryesor. **Ndonëse në fund të vitit 1997 thuhet të gjitha gjykatat ishin hapur dhe funksiononin në mbarë vendin, gjendja e sistemit të drejtësisë mbetet ende e pakënaqshme.** Një hap pozitiv që u përshëndet si nga grupet e të drejtave të njeriut ashtu edhe nga organizatat e mediave ishte abrogimi i ligjit të diskutueshëm të shtypit. Me daljen e një numri të madh radioshe dhe televizionesh private, lokale, mund të thuhet se në median elektronike gjendja është përmirësuar. Opozita aktuale është ankuar për kontrollin e televizionit shtetëror nga Qeveria dhe ka kritikuar rastet e pushimit nga puna të njerëzve në administratën publike për motive politike. Pavarësisht nga gjendja e pasigurisë në vend, për një periudhë relativisht të gjatë nuk janë raportuar raste serioze të shkeljeve të të drejtave të pakicave etnike që jetojnë në Shqipëri.

Një numër projektesh të grupeve të të drejtave të njeriut dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare synojnë edukimin e shqiptarëve me konceptet e të drejtave të njeriut. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Qendra e të Drejtave të Njeriut

dhe grupe të tjera që veprojnë në vend, krahas kqyrjes së gjendjes së të drejtave të njeriut dhe reagimit ndaj shkeljes së tyre, kanë iniciuar projekte për t'i edukuar qytetarët me ndjeshmërinë ndaj të drejtave të njeriut, ose për të njohur të drejtat e tyre në momentin e arrestimit apo të ndalimit nga policia. Për herë të parë, në shkollat shqiptare është futur në programet shkollore edukimi më të drejtave të njeriut dhe janë hartuar tekste shkollore. Nga ana tjetër, një sërë botimesh në fushën e të drejtave të njeriut, sidomos përkthimi i dokumentave kryesore ndërkombëtare në këtë fushë, që në Shqipëri kanë munguar plotësisht, i kanë shërbyer këtij procesi edukativ.

### *Media: Mbijetesë e vështirë*

Zhvillimi i medias së shkruar vazhdon të mbetet një proces kontradikor. Që nga rënia e komunizmit, media është zhvilluar me një larmi që ka ardhur gjithmonë duke u shtuar. Në të njëjtën kohë, qarkullimi i përgjithshëm i kopjeve është ulur. Një pjesë e madhe e popullatës, sidomos në zonat rurale, vazhdon të mos marrë gazeta të shtypura. Në fillim të vitit 1998, trembëdhjetë gazeta të përditshme botoheshin në Tiranë secila me tirazh nga 1 000 deri në 30 000 kopje. Problemi kryesor për këtë tirazh kaq të ulët me një total 85 000 kopje në ditë, mbetet kostoja e lartë e prodhimit dhe e shitjeve e krahasuar me të ardhurat mesatare të klientëve. Nga ana tjetër, zhvillimi i varfër i tregut të reklamave nuk i lejon gazetave që të ulin çmimet. Githashtu, gjendja e keqe e rrugëve dhe e infrastrukturës vazhdon të mbetet pengesë për zhvillimin e një rrjeti shpërndarës përtej qyteteve kryesore.

Shteti nuk e subvencionon më shtypin përveç gazetave javore të ushtrisë dhe të arsimitarëve. Në nëntor të vitit 1997, shumica e prodhuesve të gazetave ndërprejnë punën për një javë duke kërkuar uljen e taksave me argumentin që, në qoftë se gazetave taksoheshin si bizneset normale, atëherë gazetave shumë shpejt do të mbyllnin dyert. Një strukturë e re taksash për shtypin është propozuar nga Ministria e Financave, por ende nuk është miratuar

***Megjithë përpjekjet dhe ndonjë përmirësim, gjendja e rendit dhe e sigurisë në vend mbetet problemi kryesor***

nga Kuvendi Popullor.

Shtypi rajonal pësoi humbje të ndjeshme. Asnjë gazetë ditore nuk shpjet jashtë Tiranës. Edhe numri i të përjavshmeve rajonale ka rënë ndjeshëm si pasojë e turbullirave të marsit 1997. Vetëm një duzinë qytetesh kanë gazetat e tyre të përjavshme me një qarkullim të dobët zakonisht prej disa mijëra kopjesh. Pesë gazeta minoritetesh vazhdojnë të publikohen në Shqipëri, që përbëhen nga e përjavshmeja "Zëri i Omonias" dhe "Llailko Vima" të minoritetit grek, e përmuajshmeja "Amaro Dives" e komunitetit Rom, dhe gazetat mujore "Fircea" dhe "Vëllazërimi" të komunitetit Arumun. Të gjitha këto gazeta po publikohen në mënyrë të parregullt si pasojë e vështirësive logjistike në rritje, sidomos pas marsit të vitit 1997.

**Në përgjithësi shtypi shqiptar vazhdon të mbetet i dominuar nga konfliktet politike të vendit dhe më shumë se përfaqësues i opinionit publik, paraqitet si zgjatim i politikës.** Në ndryshim nga shtypi, transmetimi me radio dhe televizion është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme që pas zgjedhjeve të qershorit 1997. Parlamenti i zgjedhur në maj të 1996 miratoi një ligj të ri mbi privatizimin e medias televizive dhe të radiove në sesionin e tij të fundit më 14 mars 1997. Ky ligj i dha dritën jeshile në mënyrë formale privatizimit të radio stacioneve dhe krijimit të stacioneve private të radiove. Ky ligj shpreh se stacionet e krijuara kishin një vit kohë për të regjistruar operacionet e tyre në mënyrë që të legalizoheshin plotësisht. Në të vërtetë ky ligj nuk u zbatua dhe Këshilli Kombëtar i Medias së Transmetimit që parashikohej nga ligji nuk u krijua. Komisioni parlamentar i mediave e justifikoi vonesën duke thënë që ky ligj nuk parashikonte reformën e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), që do të transformohej nga një institucion shtetëror në një institucion publik të transmetimit televiziv. Në fillimet e vitit 1998, Kuvendi Popullor filloi të pëgatise pas një debati publik një version të ri të ligjit mbi transmetimin që pritet të miratohet gjatë 1998.


Pavarësisht nga vonesat në procesin e

licensimit, stacione të vogla radioje dhe televizioni të paregjistruara kanë mbirë që nga qershori i 1997-ës. Tani ka më shumë se 20 stacione private radio në të gjithë Shqipërinë dhe me pak stacione televizive shumica e të cilave janë rajonale. Pas zgjedhjeve të qershorit 1997, stacione radios private kanë filluar të transmetojnë në mënyrë të ndjeshme lajme dhe informacione, si edhe debate të ndryshme. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e stacioneve televizive filluan të transmetonin lajme të zgjeruara sepse shumica transmetojnë filma të kopjuar ose video muzikore. Pak stacione kanë personel të mjaftueshëm për të mbledhur lajme në mënyrë të zgjeruar. Në të njëjtën kohë ndërlihdja ndërmjet medias nuk është e tillë që të inkurajojë shkëmbim informacioni. Megjithëse shumë stacione private filluan të përmirësonin mjediset e transmetimit duke instaluar transmetues më të fuqishëm dhe antena me vendndodhje më të mirë, asnjë nga stacionet nuk ka një publik mbarëkombëtar. Veçanërisht i keq është transmetimi në zonat malore.

Edhe RTSH ka pasur ulje shumë të ndjeshme në numrin e publikut, si pasojë e shkatërrimit të disa stacioneve transmetues. Rajonet e prekura nga ky shkatërrim nuk kanë patur mundësi të marrin asnjë lloj transmetimi, qoftë edhe ai privat. RTSH llogarit që një e treta e vendit nuk është në gjendje të marrë transmetim nga ky stacion që vazhdon të mbetet stacioni më i madh dhe mbizotërues në Shqipëri.


Që nga vera e vitit 1997, gazetaria e RTSH është përmirësuar në disa aspekte. Moment i rëndësishëm i gazetarismit profesional përfshin prezantimin e disa debateve mbi çështjet aktuale shoqërore dhe politike. Në anën tjetër, **lajmet mbeten të dominuara nga raportimi i zgjeruar i veprimtarisë e aktiviteteve të qeverisë**, shpesh pa marrë parasysh rëndësinë e lajmit. Në vend të redaktimit profesional të lajmeve në një kohështrirje të përshtatshme, gazetarët vazhdojnë të përpiqen të krijojnë një drejtpeshim politik në sajë të kushtimit të kohëzgjatjes për politikanët. Struktura administrative dhe operuese e RTSH ka kontribuar në këtë

Figura 20 - Efekti i Medias ne Jeten e Shoqerise Shqiptare




Burimi: Instituti i Medias

Figura 21 - Sa Shpesh e Lexoni Gazeten?



Burimi: Instituti i Medias

Figura 22 - Sa Shpesh e Blini Gazeten?




Burimi: Instituti i Medias

dilemë. Në përshtatje me amandamentin për ligjin e transmetimeve, aktualisht në përgatitje, parlamenti është zotuar të inkurajojë një reformë të tërë në RTSH, duke përfshirë edhe çështje praktike, si struktura e personelit të brendshëm. Një numër programesh trainimi për gazetarët janë zhvilluar në Shqipëri nga Instituti i Medias, Fondacioni Soros dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Aktualisht, ka dy lidhje satelitore të internetit në Shqipëri, të cilat ofrojnë shërbim të plotë të internetit vetëm për një numër të kufizuar të institucioneve dhe organizatave që janë të lidhura në këto sisteme në mënyrë të vazhdueshme. Nga këto, ai që u instalua më herët ishte serveri i ofruar nga UNDP më 1995. Ai ka 5 linja për postë elektronike dhe ka lëshuar me


qeradhënie shërbimin e internetit për 4 organizata. Zakonisht, ky server është përdorur edhe si postë elektronike. UNDP-ja ofron këtë shërbim për parlamentin, organizata qeveritare dhe joqeveritare si dhe agjencitë e OKB-së në Shqipëri. Lidhja më e fuqishme me Internet është vendosur nga Fondacioni Soros, në maj 1997. Sistemi i këtij Fondacioni pajis me shërbim të internetit dhe postës elektronike pjesën më të madhe të departamenteve të universiteteve të ndryshme. Mbi 500 terminalë janë përcaktuar për të qenë në funksionim në universitete, presidencë dhe në disa ministri. Kuvendi Popullor dhe Biblioteka Kombëtare do të jenë të lidhur më 1998. Fondacioni i Hapur i Shoqërisë Civile "Soros" ka planifikuar të japë shërbim të internetit edhe për gazetat dhe

**Figura 23 - Burimet e Informacionit**



Burimi: Instituti i Medias

**Figura 24 - Cilesia e Informacionit**



Burimi: Instituti i Medias

radiot e pavarura shqiptare. Në plane për të ardhmen përfshihet dhe pajisja e OJQ-ve me këtë shërbim. Nuk ka shërbyes komercial të internetit, por Telekom i po planifikon ta ofrojë këtë shërbim brenda vitit 1998.

### ***Kriza e Institucioneve: Shpërbërja e Shtetit***

Rivendosja e pronës private dhe e ekonomisë së tregut, krijimi i shtetit ligjor dhe i institucioneve demokratike në Shqipëri kanë kaluar përmes një procesi me shpërthime. Brenda pak viteve është përsëritur dy herë gjendja e anarkisë dhe e kaosit, në vitin 1991 dhe 1997. Kjo gjendje në vitin 1997 çoi në shkatërrimin e shtetit dhe të institucioneve të tij, ushtrisë, policisë, shërbimit informativ, gjykatave, prokurorive, burgjeve, në tronditjen e rendit dhe shkatërrimin e një pjese të konsiderueshme të pasurisë publike dhe private.

Vështirësitë e tanishme të Shqipërisë kanë edhe një shpjegim historik. Gjatë historisë së tyre shumëshekullore shqiptarët kanë jetuar shpesh nën autoritetin e perandorive universale si ajo romake, bizantine dhe osmane. Ata kanë mundur të krijojnë shtetin e tyre vetëm në periudha historikisht të shkurtëra. Në këto rrethana të shqiptarët u kultivua ndjenja e armiqësisë ndaj shtetit dhe ligjeve të tij, sepse shteti ishte i huaj për ta, jo vetëm nga origjina, por edhe nga qëndrimi ndaj tyre. Shteti i huaj shihte të shqiptarët një mundësi për të mbledhur rekrutë të mirë, si dhe taksa e tatime, por nuk donte dhe s'ishte në gjendje të mbronte nënshtetasit e tij.

Më pas, si sundimi autoritar i Mbretit Zog, ashtu edhe regjimi totalitar komunist, nuk arritën dot të ndryshojnë konceptimin e shtetit si një forcë të huaj, duke e parë nëpunësin e shtetit jo si një shërbyes civil, por si person nga i cili mund t'i vijë e keqja ose përfitimi.

Me rënien e komunizmit Shqipëria humbi shumicën e simboleve dhe institucioneve kolektiviste. Rënia e tyre e gjeti tejet të varfër, jo vetëm ekonomikisht e shpirtërisht, por edhe institucionalisht. Asaj i mungonte një kujtesë e fortë

historike dhe një frymë nacionaliste për të ndërtuar një diktaturë si ajo e Jugosllavise; i mungonin, gjithashtu, ato fidane të institucioneve demokratike - siç i kishin vende si Polonia, Çekia apo Hungaria - për të zhvilluar një shtet demokratik. **Revolucioni demokratik në Shqipëri erdhi kryesisht në sens negativ, si nevojë e shkatërrimit të institucioneve komuniste, ndërkohë që s'ishte përgatitur asnjë lloj strukture institucionale që t'i përgjigjej kërkesave për ndërtimin e një shoqërie demokratike. Ai nuk ishte as revolucioni i një klase të caktuar shoqërore e cila, pasi është fuqizuar ekonomikisht, kërkon edhe pushtetin politik. Komunizmi në Shqipëri nuk vdiq "nga suksesi i vet", sikurse thuhet për feudalizmin në Evropë, por nga dështimi i vet.**

Drama e kolapsit të shtetit më 1997, ashtu si dhe drama të tjera që shqiptarët kanë përjetuar në këtë shekull, është pasqyrë e vështirësisë për të kapërcyer vakuomet e historisë, e pamjaftueshmërisë së atyre "lëndëve lidhëse", siç janë feja, kultura apo ndërgjegjja historike e përbashkët, etj., me një fjalë e dobësisë së gjithë atyre institucioneve që karakterizojnë një vend modern.

Me këto vakuume historike u gjet Shqipëria pas rënies së komunizmit. Në këto kushte, implementimi i institucioneve demokratike i shëmbëllente mbjelljes së fidaneve në një terren të varfër dhe të vështirë për kultivimin e tyre. Mëdyshja që shfaqej ishte: a do të ishin të përshtatshme për shqiptarët institucionet demokratike perëndimore dhe, a do të mund të lulëzonin e të ishin efikase, në një truall ku s'kanë lindur organikisht, por janë trapiantuar artificialisht? Thënë me fjalë të tjera: a do të përputheshin sistemi i marrëdhënieve shoqërore, mentaliteti e mënyra e konceptimit të jetës nga shqiptarët, me institucionet evropiane, të cilat, nga ana e tyre, janë rezultat i një evolucioni të gjatë emancipues? A janë shqiptarët të aftë për ta strukturuar shoqërinë, sistemin institucional, sipas modeleve evropiane apo këto modele do të dilnin të papërshtatshme për ta?

Duke ndjekur modelet perëndimore, në

***Revolucioni demokratik në Shqipëri erdhi kryesisht në sens negativ, si nevojë e shkatërrimit të institucioneve komuniste, ndërkohë që s'ishte përgatitur asnjë lloj strukture institucionale që t'i përgjigjej kërkesave për ndërtimin e një shoqërie demokratike.***

Shqipëri, pasi ra komunizmi u njoh pavarësia e tre pushteteve, pluripartitizmi, liria e shtypit, liria fetare, filluan të lindin organizatave joqeveritare etj. Pluripartitizmi u shoqërua me lindjen e shumë partive dhe organizatave politike shumica e të cilave më së shumti përbëheshin nga grupe të vegjël individësh. Liria e shtypit u shoqërua me lulëzimin e menjëhershëm të dhjetëra gazetave. Liria fetare u shoqërua jo vetëm me rihapjen e objekteve të kultit të tre feve tradicionale: myslymane, ortodokse dhe katolike, por edhe me ardhjen e shumë feve të tjera të panjohura deri më parë.

**Karakteristikë e këtij copëzimi të shoqërisë shqiptare ishte mungesa e një lënde lidhëse midis tyre, mungesa e një shtrirjeje dhe impakti të thellë në popull, si dhe fakti që kryesisht ato lindën dhe u mbajtën gjallë financiarisht në sajë të ndihmave të huaja.** Ndërkaq jeta politike dhe shoqërore vazhdoi të dominohet gjithnjë e më fort nga një parti dhe kjo nuk doli dot nga qorrsoakaku i metodave tradicionale të qeverisjes autoritariste, gjë që e ngadalësoi zhvillimin e institucioneve dhe të pluralizmit demokratik. Partitë opozitare vazhduan të ekzistojnë, por konceptimi i politikës si konflikt e jo si dialog, si dhe ushtrimi i diktatit të mazhorancës bëri që partitë politike opozitare, si parlamentare, ashtu dhe jashtëparlamentare, të kishin praktikisht një ndikim minimal në vendimet politike të vendit. Kontrolli mbi pushtetin gjyqësor bëri që ky pushtet të mos luante rolin që duhet të luajë në një demokraci për funksionimin normal të shtetit ligjor. Prirjet për të kufizuar lirinë e shtypit dhe sidomos kontrolli shtetëror mbi median elektronike erdhën duke u rritur. Ndërsa **Organizatave Jo Qeveritare përgjithësisht ishin të vogla dhe të parëndësishme për të ushtruar rolin e drejtpeshimit të pushteteve.** Më pas rënia e piramidave çoi në revoltën masive deri në kolapsin e shtetit. Shqiptarët e krahasojnë këtë kohë me atë të Luftës së Parë, kur shteti i porsakrijuar u shndërrua në udhëkalim ushtrish gjithfarëshe. Përgjatë tre muajve, nga marsi deri në zgjedhjet e 29 qershorit, Shqipëria jetoi

në këtë gjendje kaosi dhe anarkie që solli si pasojë vrasjen e mbi 2000 vetëve (shifrat e sakta ende nuk dihen), grabitje, vjedhje, shkatërrime, rrëmbime të panumërta si dhe tentativa eksodi, disa prej të cilave përfunduan tragjikisht, si ajo e anijes së mbytur në Kanalin e Otrantos.

Ajo çka ra në sy gjatë këtyre tre muajve ishte një papërgjegjshmëri e skajshme shoqërore, e cila u shfaq në dy trajta, njëra më dramatike se tjetra: në njërën anë, papërgjegjshmëria e politikanëve për të sakrifikuar interesat pushtetorë ose partiake në dobi të zgjidhjeve të shpejta politike, në anën tjetër, papërgjegjshmëria e popullit ndaj vlerave të përbashkëta, paaftësia e tij për t'u organizuar në mbrojtje të shkollave, bankave, spitaleve, urave, muzeve që ai i vetë i kishte ndërtuar me aq mund e sakrificë.

### *Sfida e Çarmatimit*

Sipas një ankete të realizuar nga një prej revistave kryesore të vendit në tetor 1997, nga 1000 njerëz të intervistuar 960 prej tyre konsideronin si problemin më të rëndësishëm dhe prioritar të shoqërisë shqiptare, atë të rendit. Është mëse se e qartë se rëndi përbën theksin e Akilit të mbarë shoqërisë shqiptare. Pa arritur sigurinë publike në vend s'mund të flitet për një zhvillim normal të shoqërisë shqiptare, për dalje nga kriza, për rimëkëmbje të ekonomisë dhe për investime. Me sa duket goditja e rëndë që i dhuroi ngjarjet e fillimit të vitit 1997 sigurisë publike në Shqipëri, kanë lënë pasojë që do duhet kohë të korrigojohen.

Është e vërtetë se pas zgjedhjeve të qershorit 1997, pati përpjekje serioze për ta kthyer gjendjen në normalitet, duke rreorganizuar forcat e policisë në mbarë vendin, duke vënë në funksionim organet e drejtësisë, duke eliminuar një sërë bandash dhe duke vënë në punë burgjet. U arrit, po ashtu, të arrestoheshin e riburgoseshin disa kriminelë të arratisur gjatë trazirave të marsit 1997. Megjithatë, gjendja e sigurisë publike vazhdon të mbetet shqetësuese.

Sigurisht, gjendja e pakënaqshme e sigurisë publike është e lidhur me një sërë faktorësh ekonomikë e socialë. Por ajo është, padyshim, e lidhur ngushtësisht me një nga pasojat më të rënda që la pas kriza e marsit 1997: me armatosen masive të popullsisë. Prania e një numri tepër të madh armësh në duart e popullsisë, një pjesë jo e vogël e të cilave në duart e kriminit, përbën një kërcënim real për stabilitetin dhe zhvillimin normal të shoqërisë shqiptare.

Në këtë shikim, bilanci i mujit mars 1997, kur brenda dy javësh u shkatërruan krejtësisht 287 depo të ushtrisë, ndërsa 1011 të tjera u shkatërruan pjesërisht, vazhdon ta mbajë peng shoqërinë shqiptare. Sipas një përlogaritjeje të Ministrisë së Mbrojtjes, gjatë marsit 1997 u rrëmbën nga depot ushtarake, afro 656 mijë armë të tipeve të ndryshme, mbi 1 miliard e gjysmë fisheke, 3.5 milion granata dore, një milion mina etj. Sipas Ministrisë shqiptare

Mbrojtjes dëmi llogaritet në afro 800 milione dollarë. Është tepër e vështirë të thuhet se sa prej armëve të trëmbëzta gjenden ende në duart e popullsisë. Nga kjo shtifër duhet llogaritur ato që në riktërve në depot ushtarake gjatë këtyre kohëve, met që nga përdorimi ose pakujdesia kanë dalë dhe funksionimit dhe janë bërë të papërdorshme, met që kanë dalë jashtë kufijve të Shqipërisë duke u marrë tregtinë ilegale të armëve. Armët e këtyera depozitohen në depo llogariten rreth 97 mijë, pa minat dhe hoket. Duhet thënë se numri më i madh i armëve endet në zonat rurale, si dhe në rrethinat e qyteteve.

Ndonëse është folur shumë dhe janë organizuar të sërë vepimtarish, ku është diskutuar çështja e armatimit të popullsisë, duhet thënë se në të vërtetë ekziston një program konkret për çarmatimin e popullsisë, gjë që duket edhe nga rezultatet e kërkimeve në këtë drejtim. Megjithatë janë kulluar shumë modele e variante, që nga caktimi i fëmijëve deri të mundësia e blerjes së armëve, në luftë me vete e vetme e luftës kundër armatimit të popullsisë, mbetet konsiderimi i armëmbajtjes pa si një krim, i dënueshëm penalisht, e shoqëruar me një detyrë të kontrollit të kufizuara në mjediset shtetërore. Me këtë logjikë të gjithë personat që ken me armë të paligjshme ndalohen nga policia dhe i dërgohen gjykatës. Opozita shqiptare paraqet vizione tjetër për këtë çështje: sipas saj fillimisht duhet bërë regjistrimi i armëve dhe kënia e tyre nëpër tpi, të paktën për fazën e parë. Një tjetër faktor deri diku ka ndikuar negativisht në çështjen e lodhjes së armëve është edhe mungesa e mjeteve evonjshme financiare për të mbështetur një projekt i tillë kompleks. Sipas përfillimeve të Ministrisë Drejtuese shqiptare një projekt efektiv për matimin do të kërkonte, të paktën, mbi 10 milion dollarë amerikanë.

Çështja e çarmatimit dhe e rikthimit të sigurisë lloko në vend mbetet njëra nga sfidat kryesore me të vështira të qeverisë shqiptare.


#### 4.4. Decentralizimi i Pushtetit Lokal

Statusi aktual dhe perspektiva e decentralizimit të pushtetit dhe në veçanti qeverisja lokale në Shqipëri është produkt i dinamikës së faktorëve politikë, ekonomikë e socialë të tranzicionit, si dhe i historisë, traditës, kulturës dhe psikologjisë sociale.

Tipari kryesor i organeve të qeverisjes lokale ishte niveli i ulët i autonomisë politike, përkundërt nivelit të lartë të kompetencave dhe funksioneve ekonomike e sociale.

Ndarja territoriale përbëhej nga Prefekturat dhe nënprefekturat, qarqet, bashkitë dhe komunat. Drejtuesit lokalë përcaktoheshin nga një sistem i kombinuar emërimi dhe zgjedhjeje ku emërimi ishte mbizotërues. Kështu ndërsa bëheshin zgjedhje për anëtarët e këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë/komunës emërohej me dekret mbretëror me propozim nga qeveria. Në fshatra vepronte institucioni i kryeplakut që emërohej gjithashtu. Shkalla e autonomisë administrative ishte në nivele të moderuara. Sidoqoftë autoriteti i shtetit

Figura 25 - Shkalla e Autonomisë së Pushtetit Lokal





nëpërmjet prefekturave ishte mjaft i fortë. Organi qeveritar që kontrollonte veprimtarinë e pushtetit lokal ishte Ministria e Brendshme. Kompetencat e natyrës ekonomiko-sociale ishin mjaft të zgjeruara. Organet lokale, veçanërisht bashkitë, realizonin disa shërbime publike, administronin një buxhet të financuar në mënyrë të ndjeshme nga taksat lokale dhe posedonin prona apo administronin pasuri natyrore. Administrata lokale ishte e pakët në numër, por efiçente.

Gjatë periudhës 1944 - 1990 dominoi plotësisht tipari centralizues e vertikal i qeverisjes lokale, aq sa edhe kuadri ligjor dhe kushtetues i cilësonte si "organe lokale të qeverisjes" duke i konsideruar ato si pjesë të piramidës kompakte shtetërore. Organet lokale të qeverisjes ishin këshillat e rretheve si nivel i parë dhe këshillat e qyteteteve/fshatrave si nivel i dytë. Në qytete vepronin edhe njësi më të vogla të quajtura këshillat e lagjeve. Organe lokale të pushtetit zgjidheshin me votime formale, njëherë në katër vjet por as që mund të bëhej fjalë për autonomi politike apo administrative. **Funksionet e shumta ekonomiko-sociale që realizonin këto organe bënin pjesë në ndarjen vertikale të detyrave dhe kompetencave në një shtet të centralizuar. Buxheti i tyre ishte tërësisht i mbuluar nga buxheti i shtetit dhe me procedura dhe zëra rigorozisht të përcaktuar nga mënyra e përdorimit.** Pushtet më i lartë dhe me më shumë funksione konsiderohej Këshilli i Rrethit. Këshilli i qytetit/fshatit konsiderohej niveli më i ulët i pushtetit. Ndër detyrat më kryesore të Këshillit të Rrethit ishin realizimi i planeve të prodhimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe kooperativave bujqësore.

Në vitin 1991 organet e qeverisjes lokale u ringritën të bazuara në të njëjtën formulë të krijimit të Qeverisë së Stabilitetit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjithë forcave politike.

Në qershor 1992, në prag të zgjedhjeve lokale, **Parlamenti i dominuar nga Partia Demokratike aprovoi ligjin mbi pushtetin lokal, i cili për herë të parë njohu konceptin e autonomisë politike, administrative dhe ekonomike të organeve të pushtetit lokal, i krijonte ato në dy nivele të pavarura njëra nga tjetra, si dhe krijoi premisa për zgjerimin e shpejtë të kompetencave dhe funksioneve të këtyre organeve.** Ky ligj me pak ndryshime është në fuqi edhe sot.

Nryshimi i raportit të forcave në favor të Partisë Socialiste në zgjedhjet lokale dhe marrja nga kjo parti e kontrollit të pjesës më të madhe të bashkive, komunave dhe këshillave të rretheve shkaktoi një tkurrje të vullnetit politik të pushtetit qëndror për vazhdimin me ritmet e parashikuara të reformës në pushtetin lokal. Në disa drejtime u shfaqën tendenca të qarta centralizuese, si në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë.

Sigurimi i të ardhurave për organet e pushtetit lokal në masën 95 % varet nga Buxheti i Shtetit, ndërsa struktura e shpenzimeve mbetet rigorozisht e kontrolluar nga Ministria e Financave. Shpenzimet në buxhetin e shtetit për pushtetin lokal janë luhatur në nivelin e 4-5 % të Buxhetit të Shtetit dhe kanë ardhur në ulje relative nga viti në vit. Organet e pushtetit lokal nuk zotërojnë asnjë pronë të patundshme.

Ndarja territoriale më shumë se në kriteret ekonomike, sociale e të traditës u ndikua nga tendenca centrifugale rajonale të mbështetura politikisht, produkt i së cilës ishte krijimi i 36 rretheve nga 26 të trashëguara nga sistemi i mëparshëm. Një ndarje e tillë ka patur ndikimet e veta në efiçencën e qeverisjes lokale. Prandaj duhet shtuar si domosdoshmëri hartimi i një strategjie kombëtare, e cila të shërbejë si bazë për decentralizimin, duke filluar nga ndarja administrative me kriteret të studiuara, nga përcaktimi i njësive administrative ku do të përqëndrohen kompetencat, dhe deri në kuadrin ligjor e

**Tabela 12 - Rezultatet e Zgjedhjeve për Pushtetin Lokal**

Viti	Bashki		Këshilla Rrethi			
	PD	PS	Të tjert	PD	PS	Të tjert
1992	20	23	1	18	17	1
1996	59	4	2	33	2	1

Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**Tabela 13 - Buxheti për Pushtetin Lokal**

	1995	1996	1997	1998
Shpenzime (në milion lekë)	16,961,478	19,281,878	18,699,630	199,97,372
Të ardhura (në milion lekë)	221,072	903,156	629,226	
Buxheti i shtetit (në milion lekë)	77,134,000	85,245,000	101,594,000	163,570,000
Buxheti lokal përkundrejt buxhetit të shtetit (në %)	22%	23%	18%	12%

*Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*

rregullues të funksionimit të pushtetit lokal.

Organet e prefekturave të ligjëruara në vitin 1995 dhe konfliktet e herë pas herëshme të tyre me organet e qeverisjes lokale me përkatësi partiake të kundërt, kanë qenë shprehës të konflikteve politike. Shqipëria megjithëse anëtare me të drejta të plota në Këshillin e Evropës që nga viti 1996, nuk arriti ta nënshkruajë Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale.

**Në Shqipëri vërehet dukshëm një opinion pro rritjes së kompetencave dhe shkallës së autonomisë së organeve të pushtetit lokal.** Për këtë janë ndërmarrë disa studime, janë zhvilluar disa seminare e konferenca në të cilat është arritur një konsensus i kënaqshëm, veçanërisht për problemin e pronave dhe decentralizimit fiskal, të kompetencave në fushat e politikës sociale dhe ekonomike. Po rishikohen ligjet në fuqi dhe po përgatiten një tërësi ligjesh të reja. Donatorët e huaj po e mbështesin fuqishëm këtë proces. Programi i Qeverisë aktuale parashikon nënshkrimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Lokale brenda vitit 1998, duke i paraprirë miratimit të kushtetutës, në të cilën synohet të sanksionohen parimet e themelore të kësaj karte. Sidoqoftë, ky nuk duket të jetë një proces i shpejtë dhe i lehtë për t'u realizuar. Në nivelin lokal, ndjenja e komunitetit të qeverisjes nuk është ende sa duhet, për shkak të përvojës së gjatë totalitare të programimit dhe të zbatimit thellësisht të centralizuar. Kjo do të kërkonte nisma të shoqërisë civile për ndërgjegjësimin e njerëzve për ta marrë mbi vete qeverisjen lokale. Nga ana tjetër, rritja e autonomisë lidhet me decentralizimin e fondeve e të

procedurave të grumbullimit dhe përdorimit të tyre. Niveli i ulët dhe jo i barabartë i zhvillimit rajonal, ka si rrjedhojë një situatë financiare të varfër të rajoneve, është një nga pengesat kryesore me të cilat do të përballet decentralizimi i fondeve.

***Në Shqipëri vërehet dukshëm një opinion pro rritjes së kompetencave dhe shkallës së autonomisë së organeve të pushtetit lokal.***

**Tabela 14 - Ndarja administrative dhe popullsia**

Prefektura	Rrethi	Bashkia Kryesore			
	Emri	Popullsia (ne mije)	Siperfaqja (ne km2)	Emri	Popullsia (ne mije)
Berat	Berat	137	915	Berat	61
	Kucovë	40	112		
Diber	Skrapar	44	775		
	Peshkopi	92	761	Peshkopi	19
	Mat	75	1,028		
Durrës	Bulqizë	44	718		
	Durrës	163	455	Durrës	104
	Krujë	60	372		
Elbasan	Elbasan	216	1,290	Elbasan	105
	Gramsh	42	695		
	Peqin	30	191		
	Librazhd	75	1,102		
Fier	Fier	210	850	Fier	70
	Lushnjë	137	712		
	Mallakastër	36	325		
Gjirokastrë	Gjirokastrë	61	1,137	Gjirokastrë	31
	Tepelenë	42	817		
	Përmet	37	929		
Korçë	Korçë	172	1,752	Korçë	75
	Pogradec	72	725		
	Devoll	38	429		
	Kolonjë	25	805		
Kukës	Kukës	78	956	Kukës	25
	Tropojë	44	1,043		
	Has	21	374		
Lezhë	Lezhë	65	479	Lezhë	17
	Kurbën	51	235		
	Mirditë	50	867		
Shkodër	Shkodër	196	1,631	Shkodër	95
	Malësi Madhe	44	897		
	Pukë	47	1,034		
Tiranë	Tiranë	569*	1,193	Tiranë	345*
	Kavajë	85	393		
Vlorë	Vlorë	171	1,609	Vlorë	86
	Sarandë	54	730		
	Delvinë	30	367		

\* Këto janë të dhënat e disponueshme zyrtare, ndërsa veçem popullsia e Qytetit të Tiranës vlerësohet të jetë rreth 600,000 - 700,000.

Burimi: INSTAT

## KAPITULLI 5 DEBAT I HAPUR

### ISMAIL KADARE, Shkrimtar

Karakterizimi i dramës së marsit 1997 në Shqipëri i shpëton çdo skeme të njohur të një përmbysjeje shteti në Evropë, madje edhe në Ballkan, rajon me një histori tejet të ndërlikuar, të njohur për ngjyrimet groteske të ngjarjeve. Kësaj drame i mungon logjika e brendshme, koherenca dhe personazhet qendrore, ngaqë gjithë rrjedha e saj ishte kundërtëne.

Në çdo përmbysje shteti janë dy forca që përplasen, nga të cilat, njëra më e fortë ose më me shans, e thyen tjetrën. Në rastin e përmbysjes shqiptare të dy forcat që u ndeshën, ose që bënë lojën e ndeshjes, shteti nga njëra anë dhe kundërshtarët e hamendësuar të tij, nga ana tjetër, nuk bënë gjë tjetër, veçse, si në një pasqyrë, imituan njëra-tjetrën. Ata bënë veprime simetrike, me fjalë të tjera, në vend që të ndesheshin me njëra-tjetrën, sipas një tradite të njohur, e gjetën të udhës të thejnë makinën shtetërore e bashkë me të, gjithçka që u doli përpara. Palët kundërshtarë, megjithë urrejtjen e shfrenuar për njëra-tjetrën, u rreshtuan kështu, si të ishin një ushtri e vetme, në të njëjtin uragan kaotik. Me logjikë të turbulluar nga tërbimi, frika dhe paniku, secila palë kujtonte se kaosi ishte streha e shpëtimit.

Kjo, me sa duket, është aryeja që vështirësoi karakterizimin e këtyre ngjarjeve. Ato nuk mund të quhen revoltë popullore, ndonëse u duk se nisën si e tillë, as mund të quhen luftë civile e aq me pak revolucion demokratik i vonuar. Ato filluan si një zemërim i vonuar i atij që luan kumar, që pasi ka humbur paratë, i shtyrë nga dikush kujtohet se mund ta projektojë tërbimin e vet mbi dikë, e në këtë rast ky dikush ishte shteti. Ishte ky zemërim i verbër, që nostalgjikëve komuniste iu kujtoi romantikën e bolshevizmit, dhe që iu ngjalli, në fillim të zbehtë e më pas të fortë, shpresën për të marrë pushtetin me dhunë. Në anën tjetër, qëndronin ata që në përpjekje për të qëndruar me çdo çmim e kusht në pushtet zgjodhën për aleat dhunën dhe kaosin. Anija e shtetit shqiptar u gjend kështu midis revoltës kaotike, rebelimit komunist dhe anarkisë. Pa u bërë asnjëra zotëruese, ata u shëmbën bashkarisht me shtetin shqiptar. Rasti i Shqipërisë, sado grotesk të duket, është shembull i rrezikshëm për një pjesë të Evropës.

Karakterizimi i krizës së pranverës së vitit 1997 në Shqipëri ka ngjallur dhe vazhdon të ngjallë diskutime e debate mes politikanëve, gazetarëve, politologëve dhe intelektualëve shqiptarë. Karakteri kompleks i krizës e ka bërë të vështirë dhënien e konkluzioneve përfundimtare. Në qarkullim, brenda dhe jashtë vendit, janë disa koncepte që përpiqen të karakterizojnë krizën shqiptare, që pat pushtuar për mëse dy muaj ekranet në mbarë globin. Çfarë ishte ajo që ndodhi: Anarki? Luftë Civile? Rebelim Komunist i Armatosur? Revolucion Demokratik i Vonuar? Revoltë Popullore? Puç Ushtarak? Apo diçka tjetër? Apo të gjitha këto së bashku në të njëjtën kohë?

Padyshim do të duhet kohë që t'i jepet përgjigje kësaj pyetjeje. Kjo faqe e Raportit të Zhvillimit Njerëzor nuk synon aspak të japë një përgjigje, por vetëm të bëjë prezent, nëpërmjet prononcimit të disa intelektualëve dhe të analistëve shqiptarë, disa nga opinionet që janë në qarkullim, duke synuar të nxisë një debat të hapur dhe të vlefshëm për këtë çështje kaq komplekse.

## **EATOS LUBONJA, Shkrimtar**

Ajo çka ngjau është një vorbull komplekse në të cilën mund të gjejmë gjithfarë lëvizjesh e shpjellash, prandaj mund të bësh interpretime të ndryshme. Megjithatë, në vija themelore, pa ngurrim them se drama shqiptare e gjysmës së parë të vitit 1997 mund të ndahet në tre akte: protestat paqësore, revolta e armatosur në Jug dhe degradimi i vendit në anarki. Gjithçka filloi me protestat paqësore ndaj mashtrimit piramidial, për të cilin njerëzit konsideronin si përgjegjës kryesor shtetin. Krahas zemërimit ndaj mashtrimit piramidial në këto protesta zinte vend edhe zemërimi i akumuluar ndaj regjimit autoritar të ngritur nga Berisha, i cili kishte arritur një pikë kulminante me manipulimin e zgjedhjeve të 26 majit. Këto protesta u formuluan nga opozita në formën e kërkesës për dorëheqjen e qeverisë dhe krijimin e një qeverie teknike, e cila do të bënte transparencën lidhur me piramidat dhe do të përgatiste zgjedhjet e parakohshme. Intoleranca deri në ekstrem e pushtetit ndaj këtyre protestave, nëpërmjet refuzimit të çdo dialogu me opozitën, pastaj nëpërmjet dhunës policore, dhe më në fund, deklarimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe dërgimit të ushtrisë në Jug, bëri që kjo lëvizje paqësore të shndërrohej në revoltë të armatosur.

Anarkia shpërtheu në krejt vendin si pasojë e reagimit deri në dëshpërim të Sali Berishës dhe të njerëzve përreth tij ndaj kësaj revolte (armatosja e militantëve të PD-së, hapja e depove të armatimit në Veri dhe Tiranë, ku s'kishte pasur asnjë lloj trazire, tentativa për nxitjen e luftës civile Veri-Jug) si dhe e paaftësisë së opozitës dhe të revoltuarve për ta administruar revoltën dhe për të imponuar zgjidhje politike më të forta dhe më të menjëshme.

Viti 1997, me kolapsin e piramidave dhe degradimin i protestave paqësore në revoltë të armatosur dhe më pas në anarki është vit i dështimit të pesë vjetëve tranzicion paskomunist në Shqipëri. Më një anë mund të thuash se ky ishte fundi logjik dhe i pashmangshëm i një politike të mbrapshtë në të gjitha fushat, me asnjë tjetër mund të thuash se shumëçka në atë tragjedi mund të ishte shmangur nëpërmjet një vullneti më të mirë dhe vendosmërie më të madhe të politikanëve shqiptarë. Sidoqoftë, ky vit ishte një mësim i madh historik që e bën më të përgjegjshëm rifilimin thuajse nga e para të procesit të ndërtimit të një shteti demokratik dhe të një ekonomie të mirëfillte tregu në Shqipëri.

## **BESNIK MUSTAJAJ, Shkrimtar**

Shqipëria ishte ndër vendet e rralla në Evropë që nuk e kish parë ndonjëherë shtetin e vet të mbërthyer në darën thërmuese të ushtarakëve. Edhe kjo ndodhi gjatë pranverës së vitit të kaluar. Qysh javën e parë të trazirave, në krye të turmave dolën një tufë kolonclësh e gjeneralësh, më të shumtë të liruar nga reforma e nisur në ushtri pas zgjedhjeve të marsit 1992. Me rolin që luajtën ata u dhanë ngjarjeve karakterin e një puçi ushtarak, duke zhvlerësuar ose edhe më keq, duke tradhëtuar, protestën e drejtë të atyre që kishin humbur paratë në piramidat financiare. Sidomos në rrethet e përfshira në vorbull, kishte me shumicë kolonclë e gjeneralë të tillë. Janë disa fakte që meritojnë të përmenden.

Në fund të vitit 1991 Shqipëria kishte 8 herë më shumë ushtarake se Austria. Shpenzimet për ushtrinë, të shprehura në përqindje nga buxheti i shtetit, ishin dukshëm më të larta në Evropë. Pagahej një oficer për tre ushtarë, pra, shumë larg standarteve të demokracisë. Reforma e nisur me ligjin që detyronte emërimin e një civilin në krye të ministrisë së mbrojtjes, do të shkonte përpara duke çmobilizuar pamëshirshëm një masë të madhe ushtarakësh. Kështu, dy vjet më pas, kishte më shumë kapitenë, kolonclë e gjeneralë në rezervë se me uniformë. Klasa e

re politike në fuqi nuk diti asnjëherë ta vlerësonte rrezikun që përmbante ky realitet, për pasojë, akuzat e parë pa lidhje me tronditjet financiare, që iu bë Presidentit Berisha, ishte: shkatërrimi i ushtrisë.

Për të kuptuar pse morën ushtarakët me aq devocion udhëheqjen e turmave të zemëruara, është mirë të kujtohet se nga vlini ata. Kishin një origjinë familjare të pastër komuniste dhe ishin të formuar në një shkollë të ideologjizuar deri në ind, ku teoria e artit usharak njësohej me teorinë e revolucionit. Në rastin që po flasim, pakënaqësia e natyrshme e ushtarakëve për ndërprerjen e karrierës përputhej me vendosmërinë e Partisë Socialiste për ta shfrytëzuar në të gjitha mënyrat zemërimin e njerëzve të dëshpëruar nga humbja e kursimeve. Pra, kemi më tepër se një bashkim politik, kemi një bashkim të mirëfilltë interesash vetjake të ushtarakëve me opozitën e majtë.

Do të duhet kohë të dalin në dritë dokumentet për të sqaruar marrëdhëniet, që kanë mbajtur gjatë atyre javëve dramatike ushtarakët me drejtuesit e partive të majta e veçanërisht me socialistët, cilët ishin kryesorët në ato që ndodhën. Por një gjë më duket e qartë, pa ndërhyrjen e ushtarakëve shumë ngjarje do të kishin rejedhur ndryshe. Politikanët nuk do të kishin guxuar kurrë t'i ndërseinin turmat mbi depot e armëve.

## Prof. REXHEP QOSJA, Akademik

Ç'ka ngjau në Shqipëri? Puç ushtarak? - siç shkruan disa gazetarë të huaj! Luftë qytetare? - siç u mendua shumëkënd! Rebelim i banditëve të kuq? - siç i quajti protestauesit në fillim të protestave të tyre Sali Berisha dhe siç nxituan t'i quajnë, nën ndikimin e tij, edhe prijësit e disa partive politike shqiptare në Kosovë!

Në Shqipëri, në të vërtetë, u krye revolucion i vonuar demokratik, por ky revolucion i vonuar demokratik u bë mjerisht me mjete të palejuara, tragjike - me armë. Le të thuhet se përvoç të rinjve dhe, në përgjithësi popullit, në të morën pjesë, më shumë u më pak, edhe ushtaraket e oficerët, diku-diku, madje edhe policët.

Megjithëse shumë shpejt u derdh në kaos dhe në anarki më të, anë e kënd Shqipërisë, u shpërbë, së paku njëherë për njëherë, regjimi autoritar i Sali Berishës, që mbahej me teknologji pushtetore staliniste dhe pinoçiste. Me këtë revolucion të vonuar demokratik u anuluan zgjedhjet e falsifikuara të 26 majit 1996, të cilat pesë vjet pas përmbyesjes së komunizmit e rikthyen sistemin njëpartiak me shumë të këqija të tij duke legalizuar

autoritarizmin si fat të Shqipërisë.

Pohimin se në Shqipëri u bë revolucion i vonuar demokratik e bëjnë të ligjshëm: e para, krijimi i organeve të reja të pushtetit bashkiak në gjithë Shqipërinë; e dyta, krijimi i Qeverisë së Pajtimit Kombëtar dhe, e treta, miratimi i kursit të politikës së pajtimit në vend të politikës së mospajtimit dhe të konfrontimit brendakombëtar që ndiqej.

Në Shqipëri ngjau revolucion i vonuar demokratik, sepse ajo që u degjenerua pas përmbyesjes së komunizmit më 1990 dhe 1991, u mënjana tani, por në Shqipëri njëkohësisht ngjau tragjedi. Të gjitha ndryshimet politike dhe shoqërore që bëhen me armë, e kjo domethënë me dhunë, janë tragjedi. Revolucionet gjithmonë dhe gjithkund janë tragjedi njerëzore.

Si u shkaktoi kjo tragjedi? Kur filluan të krijohen shkaqet e saj? Kush i sollë më së shumti shkaqet e kësaj tragjedie? Cilët janë shkaktarët kryesorë të kësaj tragjedie? Këto janë pyetje tepër të rëndësishme, të cilat është shumë e nevojshme t'iu përgjigjen intelektualët shqiptarë. Këto janë pyetje tepër të rëndësishme për të cilat është e nevojshme të jepen përgjigje sa më parë. Këto janë pyetje tepër të rëndësishme për të cilat duhet të jepen përgjigje objektive, vetëm objektive dhe të ndershme.

Sepse përgjigjet e anshme, partiake, të pandershme, për pyetjet e rëndësishme që shtron jeta kombëtare, na kanë çuar aty ku jemi.

Sepse prej këtyre përgjigjeve varet shumë ardhmëria politike e popullit shqiptar. Sepse, përgjigjet e anshme, përgjigjet partiake, përgjigjet e përcaktuara prej interesave, vetjake a grupore frymëzojnë ndarjet e përçarjet.

Është shpërbërë një regjim autoritar, është shpërbërë një diktaturë presidenciale, është shpërbërë një regjim i korruptuar, por është shpërbërë me mjete tragjike: shqiptari ka marrë armën kundër shqiptarit, janë vrarë dhe plagosur qindra shqiptarë; janë bërë rrënime të mëdha materiale; janë bërë rrënime në ideologjinë e përbasëshmërisë sonë të ndërtuar prej fillimeve të Rilindjes - në shqiptarizmin; janë prodhuar pasoja, pa dyshim të mëdha, që mund të lënë vrragë të thellë në jetën politike, në jetën shpirtërore dhe morale të kombit shqiptar, që i çënojnë, sot nuk mund të dihet për sa kohë, mundësitë për zgjidhje të drejtë të çështjes shqiptare në përgjithësi, kurse të çështjes së Kosovës në veçanti; janë prodhuar të dhëna që mund të lënë pasoja në pamjen e botës për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

## MERO BAZE, Gazetar

Në pranverën e vitit 1997 në Shqipëri u rrëzua shteti. Duke qenë se rrëzimi i një shteti nuk është një fenomen ciklik në shoqëri, mungon dhe një përkulzim i vetëm për mënyrën se si ai rrëzohet. Kështu që me këtë rast të gjitha mënyrat që e rrëzuan shtetin shqiptar janë eksperimente ende pak popullore dhe të papërkulitura. Deri në momentin e rrëzimit të shtetit, në Shqipëri kishte një pakënaqësi në rritje ndaj qeverisë, e cila pasi mori ngarkesën e plotë politike u bë shpërthyes dhe e papërbalueshme nga shteti shqiptar. Situata kishte ligare të një revolucioni, por jo elementë të luftës civile, ishte nën një kontroll të qartë politik, por nuk u arrit të kontrollohej fizikisht në terren. Pas rënies së shtetit dhe fillimit të zgjidhjes politike të 9 marsit, më shumë se sa qeverisja e re, në vend ndjehej rënia e shtetit, e cila karakterizohet natyrisht nga anarkia dhe dalja jashtë kontrollit e situatës në vend.

Nëse duhet gjetur një fjalë e vetme për atë që ndodhi, duhet të mbetemi vetëm në fjalën se më 1997 në Shqipëri u rrëzua shteti. Gjithçka tjetër ngjën kontradiktore dhe e zburimshme, pasi i tillë është ky fenomen në vetvete. Historisë botërore i mungojnë studime të qarta dhe përvoja në administrimin e këtij fenomeni jo shumë të njohur. Asnjë vëzhgues nuk duhet fajësuar nëse është ngatërruar me ngjarjet shqiptare, pasi së paku askush prej atyre që jetojnë në këtë shekull, nuk

u ka rënë rasti të shikojnë se si prishet një shtet si kuti kartoni.

Duke u përpjekur të përshkruajmë mënyrat se si u rrëzua shteti shqiptar, duhet të arrihen përfundime të rëndësishme dhe ndoshta historike për arsyet e rrëzimit të tij. Klasa politike shqiptare duhet ta ketë vitin 1997 si një eksperiment të hidhur të keqpërdorimit të pushtetit politik dhe potencialit politik. Kur klasa politike në një vend vë në lëvizje energji të pakontrolluara, si nga pushteti, ashtu edhe nga opozita, atëherë krijohen premisa reale për rrëzimin e shtetit. Ndërkohë, pushteti politik në Shqipëri provoi se e ka gati të pamundur të kontrollojë vendin, duke iu shmangur dëgjueshmërisë ndaj faktorëve ndërkombëtarë.

Nga ana tjetër duhet pranuar se kultura politike e shoqërisë shqiptare është në një nivel ende larg të qenit një shoqëri e pjekur politikisht me reformat e tregut dhe pluralizmin politik. Mungesa e kësaj kulture bën që në Shqipëri të ketë një hendek mes të pranuarit formalisht të një niveli të përparuar politik, siç është shoqëria demokratike dhe koncepteve jodemokratike që kanë për zhvillimin e kësaj shoqërie. Fakti që fitet qoftë dhe formalisht, për revolucion dhe jo për evolucion të shoqërisë shqiptare është një dëshmi se niveli politik i shoqërisë ka një distancë të ndjeshme nga deklarimi formal politik. Kërcënimet revolucionare që përpiqen të afrojnë këtë distancë janë në fakt kërcënime reale për shoqëritë në zhvillim.

## FENOMENI VRANITSKY

Në kulmin e krizës së marsit 1997 në aeroportin e Tiranës zbriti për herë të parë ish-kancelari i Austrisë, Franc Vranicki. Vranicki kishte marrë mandatin e OSBE-së për të negociuar zgjidhjen e krizës. Me ndërmjetësimin e Vranickit u realizuan një numër marrëveshjesh mes forcave politike shqiptare. Brenda katër muajve, Vranicki erdhi 9 herë në Shqipëri.

Një vit pasi i dërguari i posaçëm është larguar, në Shqipëri vazhdon të mbetet i pranishëm Fenomeni Vranicki, që nënkupton prirjen e klasës aktuale politike shqiptare për të zgjidhur mosmarrëveshjet nën arbitrimin e jashtëm. Në shënimet e mëposhtme, Franc Vranicki flet për krizën shqiptare që ai negocioi me talent dhe sukses:

"Në mars të vitit 1997 institucionet shtetërore të Shqipërisë ishin përmbysur pothuajse tërësisht. Revolta të shtytura nga falimentimi i disa skemave piramidale përfshinë të gjithë vendin. Në qoftë se këto revolta duken si reagim i tepërt e pak i çuditshëm është e mjaftueshme të kujtojmë madhësinë e këtyre skemave. Në një vend me pak më shumë se tre milion banorë vjedhja e afro 1.5 miliard dollarëve ishte katastrofike. Të gjitha seksionet e shoqërisë u prekën. Shumë njerëz humbën rrogat e situara nga vite pune në vende të tjera, shumë të tjerë humbën shtëpitë ose kursimet të vëna me mundin e një jete. Policia dhe ushtria ishin të pafuqishëm. Mijëra shqiptarë vërshuan në Itali dhe Greqi. Kur OSBE më kërkoi që të ndërmjetësoja midis partive, shumë pak veta mendonin se do kishte përsëri zgjedhje. Shqiptarët vetë ishin skeptikë se si mund të respektohej një proces i tillë demokratik në mes të anarkisë e rrëmujës. Megjithatë nuk kishte rrugë tjetër. Ne nuk mund t'i injoranim problemet që ekzistonin dhe duhej të jepnim ndihmën tonë. Shqipëria është anëtare e OSBE-së dhe e Këshillit Evropian e angazhuar për vlerat demokratike që OSBE-ja përfaqëson.

Problemet në Shqipëri kishin edhe një dimension rajonal me mundësi zgjerimi dhe në vende të tjera. Fatmirësisht ky rrezik nuk u materializua asnjëherë. Kjo që po ndodhte ishte një krizë akute e brendshme e një prej shteteve anëtare.

Shqiptarët kishin humbur besimin në sistemin e tyre. Shumë vetë ndjeshin sikur ua kishin vjedhur votat në zgjedhjet e fundit. Vërtet skemat piramidale ishin shkëndija që i dha zjarrin situatës, por benzina ishte zhgënjimi politik. Shumë shpejt u zbulova se shqiptarët ishin shumë cinikë për çdo gjë që kishte të bënte me qeverinë. Për sa mendonin ata, qeveria kishte qenë shumë neglizhente dhe nuk i kishte mbrojtur nga firmat piramidale. Shumë

mendonin se qeveria ishte bashkëpunëtore në zhdukjen e parave. Ata do t'i mbanin pushkët për të zgjidhur problemet që kishin.

Ishte e qartë që rregulli nga jashtë nuk mund t'u imponohej shqiptarëve. Vetëm një nisje nga fillimi do të ndalonte zhytjen edhe më thellë në rrëmujë. Pas diskutimeve të gjata partitë ranë dakort që duhej të mbaheshin zgjedhje të reja për një parlament të ri.

OSBE-ja premtoi në mars të ndihmonte dhe të mbikqyrte procesin e zgjedhjeve. Forca Ndërkombëtare e Mbrojtjes u krijua për të siguruar një ambient të qetë për misionet internacionale. Mosbesimi ndërmjet partive ishte shumë i thellë. Pikërisht në këtë pikë komuniteti ndërkombëtar në përgjithësi dhe OSBE-ja në veçanti duhet të bënin ç'ishte e mundur për të treguar që zgjedhjet e reja do të ishin shumë më të mira se ato të fundit. Na duhej të kishim besimin e njerëzve në procesin e zgjedhjeve, ndaj dhe morëm pjesë në të gjitha fazat.

Për disa muaj me rradhë perfaqësuesit e OSBE-së punuan intensivisht me autoritet shqiptare për të përgatitur zgjedhjet. 500 vëzhgues ndërkombëtarë mbikqyrën procesin në të gjithë vendin. Kushtet nuk qenë ideale me sigurinë që ishte një problem i vazhdueshëm. Pa ndihmën e Forcës Ndërkombëtare të Mbrojtjes nuk do të kishim depërtuar dot në disa zona. Por, në qoftë se do të kishim qëndruar vetëm në Tiranë, a do ta kishte besuar njeri se kishim mbikqyruar zgjedhjet? Ishte shumë e rëndësishme që të ishim aktivë në të gjithë vendin. Dhe u bëmë të tillë sidomos në jug ku edhe nisën rrëmujat e para.

Kur mendoj se çfarë ndodhi në Shqipëri vitin e kaluar dhe atmosferën e mosbesimit që gjeta vetëm pak muaj më parë, habitem se si vajtën zgjedhjet kaq mirë. Heronjtë e vërtetë të kësaj ngjarjeje janë shqiptarët e thjeshtë që hodhën votën e tyre dhe treguan se kur iu dha rasti, ata donin të rivendosnin normalitetin në vend dhe të përmirësonin figurën e Shqipërisë nëpër botë. Këta njerëz vepruan në mënyrë të qetë dhe paqësore dhe 73% e popullatës votoi. Me përjashtim të pak incidenteve të pakëndshme, 29 qershori ishte një ditë e zakonshme zgjedhjesh, jo shumë e ndryshme nga ditët tona të zgjedhjeve. Koordinatorja ndërkombëtare, zonja Lalumiere e quajti procesin të vlefshëm. Partitë e humbura dhe fitimtare iu nënshtuan këtij gjykimi. Për Shqipërinë ky ishte triumf me të cilin mund të krenohet edhe komuniteti ndërkombëtar.

Ndërsa Shqipëria po punon që të ndërtojë një të ardhme më të mirë për veten e saj, ne duhet të jemi të gatshëm për ta ndihmuar."

## Vendi i Kallashnikoveve. A ekziston Shqipëria Tjetër?

Të përpiqesh të shkruash për Shqipërinë Tjetër voçanërisht sot kur imazhet e medias në mbarë botën fatkeqsisht, kanë vënë shenjën e barazimit ndërmjet shqiptarëve dhe barbarëve të rinj, mund të tingëllojë si një aventurë nacionaliste, ose më e pakta, si propagandë. Megjithatë, nuk është kurrë as vonë as keq të shtrohet pyetja: A ekziston Shqipëria Tjetër?

A është Shqipëria vetëm vendi i kallashnikoveve, vendi i "boat people", vendi i gjakmarrjes, vendi i piramidave, vendi i rrugëve me gropa? A ka diçka tjetër, përveç këtyre, në atë që media e ka pagëzuar tashme si Far West-i evropian?

A ka njerëz të tjerë nga ky vend që nuk quhen as Fatos Nano dhe as Sali Berisha? A ka në Shqipëri njerëz të tjerë, përveç atyre që shkojnë në mitingje elektorale? Me fjalë të tjera, a ka ndonjë shqiptar që të mos jetë "rebel komunist" ose "hajdut demokrat"?

A ekzistojnë vajzat e bukura, vjershat e dishurisë, mbremjet e verës, librat, pikturat? Apo kemi të bëjmë me një shkretëtirë kulturore dhe intelektuale, ku gjithçka është tharë dhe ka vdekur? A ekziston pra, një Shqipëri Tjetër?

Zakonisht shqiptarët për të treguar Shqipërinë Tjetër, pra Shqipërinë kulturore, ose atë që quhet civilizim shqiptar, nxitojnë të përmendin disa emra. Në fillim emrin e Nënë Terezës që u lind në një familje shqiptare në Shkup dhe që, pavarësisht se fiste vetëm pak fjalë shqip, nuk ngurronte ta quante Shqipërinë "atdheu ynë" dhe bashkë me pasaportën indiane mbante edhe një pasaportë shqiptare. Më pas emrin e Ismail Kadarese, shkrimtari shqiptar librat e të cilit gjenden vitrinave të librarive të Parisit, Madridit, New Yorkut. Më pas edhe disa emra të tjerë, më pak të njohur, por kjo nuk ka rëndësi. E rëndësishme është që Shqipëria Tjetër ekziston.

Ajo ka ekzistuar gjithmonë. Në natën e gjatë osmane, mes trysnise së frikshme të një makine të shtrembë ushtarake, shqiptarët krijuan atë që quhet letërsia e vjetër shqipe, ose letërsia katolike shqipe, që më tepër se letërsia ishte një memorie ose një kundërhistori, ndaj fesë së krishterë, një ndër gjuhët më të vjetra të kontinentit. Priftërinjtë shqiptarë që mbanin emrat Budi, Bogdani, Buzuku krijuan ndoshta të parën Shqipëri Tjetër, e cila jetonte sovranë, e paprekshme, e pa influencueshme nga një perandori e frikshme.

Shqipëria komuniste e nisi marshimin e saj triumfalist në 1945 duke kërkuar të shikatojë pikërisht atë që ishte më e rrezikshme për të, Shqipërinë Tjetër. Tjetra ishte jo vetëm e panevojshme, por edhe e rrezikshme, Tjetra ishte shmangie nga rreshi, dalje nga vija, influencë kapitaliste, indiferentizëm mikroborgjez, të gjitha të papranueshme në Republikën e Bunkerëve. Shqipëria Tjetër duhej zhdukur sepse asaj i

mungonte fryma revolucionare, entuziazmi i aksioneve, ëndrrat kooperativiste. Por, Tjetra mbijetoi. Indiferente, jooptimiste, jorevolucionare, po gjithsesi mbijetoi.

Mes qindra mijëra volumeve të letërsisë socialiste u shfaqën librat e Ismail Kadarese, libra që u kujtuan shqiptarëve Shqipërinë Tjetër, të përjetshmen, sovranen, indiferenten, libra që gjithashtu krijuan Shqipërinë Tjetër, të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, kur kjo gjë ishte më e vështirë se kurrë. Jo vetëm "Pallati i ëndrrave" apo "Viti i mbrapshtë" i Ismail Kadarese, por edhe "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" i Dritëro Agollit, romanët e Petro Markos dhe të Kasëm Trebeshioës, poezitë e Fatos Arapit dhe të Bardhyl Londos janë pjesë e këtij kontributi.

Në qoftë se deri 7 vjet më parë klisheja më e përdorshme në artikujt për Shqipërinë ishte "këshajella e fundit staliniste në Evropë", sot ajo është zëvendësuar me "kallashnikov-land", pra me tokën e kallashnikoveve. Padyshim, kallashnikovi ka marrë një rol të rëndësishëm në jetën shqiptare, por vizatimi i shqiptarit si një qenie që vetëm pi duhan dhe shkrep kallashnikovin, është i sipërfaqshëm, për të mos përdorur një term të ashpër. Natyrisht, dikush do të ishte i interesuar t'i shtonte shqiptarit të sotëm edhe një qeleshe, dhe nëse do të ishte grua, patjetër edhe një ferecë, për të mos shkuar më larg.

Kur në mesin e viteve '80 Ismail Kadareja shkroi romanin "Viti i mbrapshtë" dikush pat thënë në një kafene të Tiranës se ky libër duket si një version ironik i historisë së Shqipërisë, Viti i mbrapshtë 1913 duket se u rikthye në 1997. Ndonese "Viti i mbrapshtë" nuk hyn në zhandrin e utopive sociale ala Oruell, Wells apo Bredberi, më tepër sesa version ironik i historisë së Shqipërisë, ky libër vetëm me 70 faqe duket se ishte një prognozë historike e së ardhmes së saj. 13 vjet nga fillimi i shekullit tonë dhe 3 vjet nga mbyllja e tij, shqiptarët paradoksalisht gjenden në të njëjtin udhëkryq të rrezikshëm. Dhe më e rrezikuara nga të gjitha është pikërisht Shqipëria Tjetër, Shqipëria kulturore, Shqipëria Intelektuale, Civilizimi Shqiptar. Praga hirit të piramidave të rrënuara, qëndrojnë shqiptarët e lodhur me vendin e tyre, i cili më shumë se si atdhe, duket si një "tranzit" në udhëtimin drejt Evropës. Të ikim, të ikim nga ky vend, për fat të keq ky refren është kthyer në një epidemi kombëtare, që nuk njih moshë. Të ikim, s'ka rëndësi se ku. Por, Tjetra vazhdon të mbijetojë. E heshtur, e çarmatosur, refuzuese, e trishtë. Gati e padukshme, por mbijeton. Tek ata që ndërtojnë diçka, tek ata që botojnë çdo ditë nga një libër, tek ata që kthehen, kur tërjerët ikim, tek ata që vuzjnë edhe për penat që priten brutalisht, tek ata që heshtin dhe refuzojnë zhurmat e mitingjeve që nuk pushojnë, tek ata që lutën për një Shqipëri normale. Nëse sot Tjetra është e padukshme, nëse me siguri ajo do të shfaqet plotësisht.

*Kallashnikovi ka marrë një rol të rëndësishëm në jetën shqiptare, por vizatimi i shqiptarit si një qenie që vetëm pi duhan dhe shkrep kallashnikovin, është i sipërfaqshëm*



# ANEKS - TE DHENA STATISTIKORE

**Tabela 15 - Popullsia Mesatare Vjetore - (në mijë)**

VITET	POPULLSIA GJITHSEJ	MESHKUJ	FEMRA	QYTET	FSHAT	DENDESIA
1923	804	...	...	128	676	28
1950	1,215	624	591	249	966	42
1960	1,607	828	779	474	1,133	56
1970	2,136	1,097	1,039	680	1,456	74
1980	2,671	1,378	1,293	897	1,774	93
1990	3,286	1,686	1,600	1,176	2,080	114
1992	3,190	1,589	1,601	1,165	2,024	111
1993*	3,167	1,566	1,601	1,314	1,852	110
1994*	3,202	1,586	1,616	1,345	1,857	111
1995*	3,249	1,608	1,641	1,381	1,868	113
1996*	3,283	1,624	1,659	1,445	1,838	114
1997*	3,324	1,629	1,695	1,526	1,798	115

\*) Vleresim i INSTAT -it

**Tabela 16 - Levizja Natyrore e Popullise**

VITET	LINDJE TE GJALLA	VDEKJE	SHTESA NATYRORE	MARTESA	DIVORCE
1950	47,291	17,215	30,076	12,341	976
1960	69,686	16,775	52,911	12,571	850
1970	69,507	19,774	49,733	14,449	1,625
1980	70,680	16,981	53,698	21,729	2,024
1990	82,125	18,193	63,932	28,992	2,675
1991	77,361	17,743	59,618	24,853	2,236
1992	75,425	18,026	57,399	26,405	2,361
1993	67,730	17,868	49,862	25,963	2,251
1994	72,179	18,342	53,837	27,895	2,108
1995	72,081	18,060	54,021	26,989	2,333
1996	68,358*	17,600**	50,758	27,690**	1,901
1997	595,41	18,224	41,317	24,111	1,430

\*) vleresuar nga Ministria e Shëndetësisë

\*\*\*) Të dhëna operative

**Tabela 17 - Zgjatja Mesatare e Jetes (ne vite)**

VITET	Gjithsej	Meshkaj	Femra
1950-51	53.5	52.6	54.4
1960-61	64.9	63.7	66.0
1980-81	69.5	67.7	72.2
1989-90	72.2	69.3	75.4
1990-95*	71.4	68.5	74.3

\*) Vlerësim i INSTAT

**Tabela 18 - Popullsia dhe Forcat e Punes - (në mijë)**

	1993	1994	1995	1996	1997
Popullsia	3,167	3,202	3,249	3,283	3,324
Popullsia në moshë pune	1,763	1,786	1,820	1,850	1,861
Forcat e punës	1,364	1,423	1,309	1,274	1,301
Shkalla e pjesëmarrjes në punë në %	77	81	73	69	70
Të punësuar	1,063	1,161	1,138	1,116	1,107
Të papunë të regjistruar	301	262	171	158	194
Niveli i papunësisë në %	22	18	13	12	14.9

**Tabela 19 - Punesimi**

	Në mijë			në %		
	1995	1996	1997	1995	1996	1997
Të punësuar gjithsej	1,138	1,116	1,107	100	100	100
Sëktori shtetëror	276	239	226	24.2	21.4	20.4
Sëktori privat bujqësor	750	761	761	65.9	68.2	68.7
Sëktori privat jo-bujqësor	112	116	120	9.9	10.4	10.9

**Tabela 20 - Punesimi Gjithsej sipas Klasifikimit NACE**

	Në mijë				në %			
	1994	1995	1996	1997	1994	1995	1996	1997
Gjithsej	1,162	1,138	1,116	1,107	100	100	100	100
Bujqësi dhe peshkim	780	778	777	771	67.1	68.4	69.6	69.6
Industri nxjerrëse	20	21	18	16	1.8	1.8	1.6	1.4
Industri përpunuese	81	65	62	58	7.0	5.7	5.6	5.2
Prodhim En. elektr. ujë	9	9	10	14	0.8	0.8	0.9	1.3
Ndërtim	18	21	22	15	1.6	1.9	1.9	1.3
Tregti	32	51	58	47	2.8	4.5	5.2	4.2
Hotele Restorante	10	11	20	10	0.9	1.0	1.8	0.9
Transport Komunikac.	28	30	27	27	2.4	2.6	2.4	2.4
Arsim	55	53	46	49	4.7	4.7	4.1	4.4
Shëndetësi	32	26	23	25	2.8	2.3	2.0	2.3
Të tjera	96	73	62	75	8.3	6.4	5.5	6.7

**Tabela 21 - Papunesia e Regjistruar, Papunesia Afatgjate dhe Niveli i Papunesise**

		1995	1996	1997
Të papunë të regjistruar gjithsej	në mijë	171	158.2	193.5
Të papunë afatgjate	në mijë	124.3	120.2	162.6
Niveli i papunesisë	%	12.9	12.3	14.9

**Tabela 22 - Pagesa e Papunesise, Paga Minimale Zyrtare dhe Pensionet - (në lekë)**

	1993	1994	1995	1996	1997
Pagesa e papunesise	1,237	1,920	2,150	2,150	2,150
Paga minimale zyrtare	1,200	2,400	3,300	4,400	4,400
Paga mesatare mujore	3,084	4,778	6,406	8,638	9,558
Pensioni maksimal					
Qytet	1,710	3,840	4,400	5,920	6,500
Fshat	750	750	750	1,138	1,248

\* Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror

**Tabela 23 - Ndryshimi Mesatar Vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Pagës në Sektorin Publik - (në %)**

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Ndryshimi i IÇK	35.5	226	85 *	22.5	7.8	12.7	42.07
Ndryshimi i pagës	27.5	145.3	72.8	54.9	34.1	34.8	10.65
Rritja reale e pagës*	-5.9	-24.8	-6.6	26.4	24.4	19.6	-22.12

\* Llogaritet si raport i indeksit të pagës mesatare me indeksin e çmimeve të konsumit

**Tabela 24 - Pensioni Mujor i Pleqerise - (në lekë)**

	1993	1994	1995	1996	1997
Pensioni minimal					
Qytet	1,075	2,200	2,710	3,750	3,750
Fshat	528	700	700	1,075	1,075
Pensioni maksimal					
Qytet	1,710	3,840	4,400	5,920	6,500
Fshat	750	750	750	1,138	1,248

**Tabela 25 - Familjet qe Perfitojne Ndhjme Ekonomike - (në mijë)**

	1993	1994	1995	1996	1997
Gjithsej	153.0	145.0	134.9	143.5	145.9
1 pjesëtar	13.1	12.2	10.7	10.4	10.5
2 pjesëtarë	21.7	20.4	18.8	17.7	15.9
3 pjesëtarë	30.1	29.1	28.2	29.7	28.6
4 pjesëtarë	34.2	33.4	33.2	37.4	41.8
5 pjesëtarë	22.6	21.0	19.8	21.7	23.3
6 pjesëtarë	14.3	13.1	11.5	12.6	12.7
Mbi 6 pjesëtarë	16.9	15.8	12.6	14.0	13.1

**Tabela 26 - Familjet qe Perfitojne Ndhme Ekonomike sipas Prefekturave - (në mijë)**

	1994	1995	1996	1997
<b>Gjithsej</b>	<b>145.0</b>	<b>134.9</b>	<b>143.5</b>	<b>145.9</b>
Berat	8.4	8.6	9.3	10.3
Dibër	21.5	17.7	17.8	16.5
Durrës	6.0	5.4	4.8	5.2
Elbasan	18.8	18.9	19.9	20.7
Fier	6.2	3.1	5.8	7.2
Gjirokastrë	2.8	2.1	2.4	2.6
Korçë	11.1	11.2	11.3	12.3
Kukës	14.9	11.3	14.8	12.4
Lezhë	9.9	9.4	9.0	9.7
Shkodër	17.2	20.3	23.6	21.5
Tiranë	22.1	21.2	19.8	19.4
Vlorë	6.2	5.7	5.2	8.1

**Tabela 27 - Evolucionit i Indeksit te Çmimeve te Konsumit (IÇK) dhe Grupet e tij Kryesore - Rritja vjetore (në %)**

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
<b>Gjithsej</b>	<b>2.5</b>	<b>104.1</b>	<b>236.6</b>	<b>30.9</b>	<b>15.8</b>	<b>6.0</b>	<b>17.4</b>	<b>42.07</b>
Ushqim, Pije, Duhan	3.6	111.1	256.4	27.0	7.3	6.4	20.0	45.76
Veshje dhe këpucë	2.3	111.5	169.8	11.8	4.9	8.7	15.6	41.8
Qira, ujë, lëndë djeg. energji	-4.7	15.1	274.7	116.3	122.1	3.1	21.4	29.09
Artikuj shtëpiakë dhe mirëmb.	0.0	117.4	288.6	0.6	-1.3	0.6	5.3	46.6
Kujdes mjekësor	0.0	0.0	183.3	20.6	48.2	24.4	9.5	19.03
Transport dhe komunikacion	4.4	22.9	225.1	141.1	44.7	5.3	3.7	33.54
Argetim, arsim, kulturë	0.0	102.9	156.3	54.6	-2.1	13.8	7.0	27.16
Kujdes personal	0.0	394.9	147.3	19.1	7.5	5.9	6.0	48.44

**Tabela 28 - Institucionet e Arsimit**

	Viti arsimor		
	1994 -1995	1995 -1996	1996 -1997
Kopshite në arsimin parashkollor	2,668	2,670	2,656
Shkolla 8 vjeçare	1,782	1,797	1,799
Shkolla të mesme	472	430	408
Shkolla të larta	10	10	11

**Tabela 29 - Edukatorët, Mesuesit dhe Pedagoget - (në numër)**

	Viti arsimor		
	1994 -1995	1995 -1996	1996 -1997
Arsimi parashkollor	4,428	4,416	4,463
Arsimi 8 vjeçar	30,893	31,369	30,926
Arsimi i mesmë	6,365	6,321	6,118
Arsimi i lartë (Grupi mësimor-shkencor efektiv)	...	1,594	1,562

**Tabela 30 - Nxenes dhe Studente te Regjistruar - (në numër)**

	Viti arsimor		
	1994 -1995	1995 -1996	1996 -1997
Fëmijë në kopshte	80,384	84,536	84,232
Nxënës dhe studente të regjistruar gjithsej	672,898	678,082	687,130
Arsimi 8 vjeçar	550,737	558,101	560,731
Arsimi i mesëm	93,830	89,895	93,058
E mesme e përgjithshme	73,216	71,391	76,424
E mesme profesionale	20,614	18,504	16,634
Arsimi i lartë civil brenda vendit	28,331	30,086	33,341
Sistemi i ditës	17,792	17,325	17,094
Sistemi i korrespondencës	10,539	12,851	16,247

**Tabela 31 - Tregues te Arsimit**

	Viti arsimor		
	1994 -1995	1995 -1996	1996 -1997
Nxënës për një klasë	23	27	28
Arsimi 8 vjeçar	29	29	32
Arsimi i mesëm			
Nxënës për një mësues	18	18	18
Arsimi 8 vjeçar	15	14	15
Arsimi i mesëm			

**Tabela 32 - Produkti i Brendshem Bruto sipas Degeve Kryesore te Ekonomise - (Në milion lekë)**

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
<b>Gjithsej (me cmime korrente)</b>	16,813	16,404	50,697	125,334	184,393	229,793	280,998	337,114
Industri	6,252	5,260	8,548	17,362	23,112	26,943	35,137	41,782
Bujqësi	6,762	6,967	27,491	68,484	100,755	125,435	148,318	188,698
Ndërtim	1,114	1,085	3,867	11,344	17,721	23,621	32,107	37,896
Transport	550	537	1,520	3,876	6,213	8,118	9,226	9,239
Të tjera	2,135	2,554	9,271	24,268	36,592	45,677	56,210	59,498
<b>GDP për frymë (mijë lekë)</b>	5.1	5.1	15.9	39.6	57.6	70.7	85.6	102.1
<b>Gjithsej (me cmime konstante)</b>	16,813	12,105	11,235	12,309	13,331	15,107	16,482	15,325
Industri	6,252	3,882	1,894	1,705	1,671	1,771	2,013	1,899
Bujqësi	6,762	5,141	6,092	6,726	7,284	8,246	8,494	8,578
Ndërtim	1,114	801	857	1,114	1,281	1,553	1,840	1,723
Transport	550	396	337	381	449	534	529	420
Të tjera	2,135	1,885	2,055	2,383	2,646	3,003	3,608	2,705
<b>GDP për frymë (mijë lekë)</b>	5.1	3.7	3.5	3.9	4.2	4.6	5.0	4.6

Burimi: MKZHT, Njësia e Makroekonomisë

**Tabela 33 - Struktura e Degeve ne Krijimin e Produktit te Brendshem Bruto (PBB) - (ne %)**

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Industri	37.2	32.1	16.9	13.9	12.5	11.7	12.5	12.4
Bujqësi	40.2	42.5	54.2	54.6	54.6	54.6	52.8	56.0
Ndërtim	6.6	6.6	7.6	9.1	9.6	10.3	11.4	11.2
Transport	3.3	3.3	3.0	3.1	3.4	3.5	3.3	2.7
Te tjera	12.7	15.6	18.3	19.4	19.8	19.9	20.0	17.6

Burimi: MKZHT, Njësia e Makroekonomisë

**Tabela 34 - Rritja Vjetore e Produktit te Brendshem Bruto sipas Degeve (ne %)**

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Gjithsej ( me çmime konstante)	-28.0	-7.2	9.6	8.3	13.3	9.1	-7.0
Industri	-37.9	-51.2	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6
Bujqësi	-24.0	18.5	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0
Ndërtim	-28.1	7.0	30.0	15.0	21.2	18.5	-6.3
Transport	-28.0	-14.9	13.0	18.0	18.8	-1.0	-20.5
Te tjera	-11.7	9.0	16.0	11.0	13.5	20.1	-25.0

Burimi: MKZHT, Njësia e Makroekonomisë

**Tabela 35 - Bilanci i Buxhetit te Shtetit - (ne milion leke)**

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Të ardhurat e buxhetit	8,291	5,168	13,308	33,476	46,833	54,409	52,907	60,351
Në përqindje ndaj PBB-së (cm.korente)	49	32	26	27	25	24	19	17.8
Shpenzimet e buxhetit	10,869	8,565	21,317	50,678	60,984	74,154	87,593	100,748
Në përqindje ndaj PBB-së (cm.korente)	65	52	42	40	33	32	31	30
Defiçiti i Buxhetit të Shtetit	-2,578	-3,397	-8,009	-17,202	-14,151	-19,745	-34,686	-40,398
Në përqindje ndaj GDP (cm.korente)	15.3	20.7	15.8	13.7	7.7	8.6	12.3	12

Burimi: Ministria e Financave

**Tabela 36 - Bilanci i Pagesave - (ne milion USD)**

	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Llogaria Korente	-50.8	14.7	-42.7	-14.6	-107.2	-271.2
Eksporti i Mallrave, f.o.b.	70.0	111.7	141.3	204.8	243.7	158.6
Importi i Mallrave, f.o.b.	-540.5	-601.6	-601.0	-679.8	-920.5	-693.5
Bilanci tregtar	-470.5	-489.9	-459.7	-475.0	-676.8	-534.9
Shërbimet:kredi	20.3	77.5	83.1	97.0	129.2	64.1
Shërbimet:debitore	-89.2	-162.0	-171.5	-156.3	-188.9	-114.9
Te Ardhurat:kredi	2.6	64.9	55.6	70.8	83.6	61.6
Te Ardhurat:debi	-37.7	-31.0	-41.5	-28.5	-12.1	-11.9
Transferta Private	150.0	274.8	374.1	348.9	476.0	235.7
Transferta Shtetërore	373.7	280.4	117.2	128.5	83.5	29
Investime Direkte	20.0	58.0	52.9	70.0	90.0	47.5
Investime Portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitale të tjera	10.7	52.1	11.6	-93.1	-20.9	98.2
Sektori Rezident Shtetëror	55.0	106.9	119.0	-24.6	68.4	49.4
Bankat Tregtare	-59.6	-43.5	-80.2	-56.9	-79.6	82.1
Sektorët e Tjerë	15.3	-11.4	-22.3	-11.6	10.5	-33.3
Gabime dhe Harresa Neto	44.8	-9.9	33.0	57.1	96.5	157.1
Bilanci i Përgjithshëm	24.7	114.9	54.8	30.6	47.1	43.8
Rezervat						
Rezervat	-24.7	-114.9	-54.8	-30.6	-47.1	-43.8
Përdorim Kredish dhe Huash nga FMN	13.9	16.6	22.2	11.1	0.0	12.2
Detyrime ndaj Autoritete të Huaja Monet.	...	...	...	...	...	...
Financime të Jashtëzakonshme	...	...	...	...	...	...
Për t'u pasur në Vëmendje						
Ndryshimi total në Rezerva	-24.9	-114.9	-54.8	-30.6	-39.5	28.3
nga të cilat: Rivlerësim	...	-3.8	7.3	5.1	-7.2	-15.5

*Burimi: Banka e Shqipërisë*

**Tabela 37 - Tregues të Shërbimit Spitalor**

	1994	1995	1996	1997
Spitale	51	51	51	51
Shtretër gjithsej	9,661	10,371	10,319	10,321
Shtime gjithsej	281,990	288,856	289,268	301,087

**Tabela 38 - Tregues të Shërbimit Spitalor pa Shtretër**

	1994	1995	1996	1997
Qendra mjekësore pa shtretër	2,733	2,507	2,437	2,439
Nga këto:				
- Poliklinika	58	53	53	53
- Qendra shëndetësore	702	622	637	639
- Ambulanca	1,973	1,832	1,747	1,747

**Tabela 39 - Tregues te Sherbimit Preventiv**

	1994	1995	1996	1997
Konsultore të Nënës	2,091	2,097	2,073	2,073
Qendra të Planifikimit Familjar	80	83	92	92
Konsultime në Qendrat e Planifikimit Familjar	49,140	49,801	63,565	65,301
Gra që aplikojnë metoda kontraceptive	8,306	5,367	33,129	35,871
Konsultore të Fëmijëve	2,268	2,167	2,167	2,167
Farmaci dhe agjenci farmaceutike	364	---	743	743

**Tabela 40 - Kurset e Kembimit te Lekut me Monedhat e Huaja - (Mesatarja e periudhës)**

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Lekë/USD	8.9	24.2	75.0	102.1	94.7	92.8	104.5	148.9
Lekë/DEM	4.7	8.2	47.1	61.7	58.3	64.8	69.5	85.7
Lekë/GRD 100	---	---	---	44.6	39.1	40.1	43.4	54.5
Lekë/ITL 1000	6.4	11.0	59.1	65.1	58.7	57.0	67.7	87.4

Burimi: Banka e Shqipërisë

**Tabela 41 - Bilanci i Energjise Elektrike - (ne milion kwh)**

	1995	1996	1997
Burime gjithsej	4,616.8	6,263.5	5,895.1
Prodhimi	4,477.9	5,778.8	5,183.8
Me termocentrale	172.2	206.3	157.5
Me hidrocentrale	4,305.6	5,571.4	5,025.6
Me të tjera (nd.pilot)	0.0	1.1	0.7
Importi	138.9	484.7	711.3
Përdorimi gjithsej	4,616.8	6,263.5	5,895.1
Eksporti	213.0	1,407.5	839.2
Humbje në rrjet	2,347.3	2,547.6	2,913.1
Përdorur nga konsumatorët e vendit	2,056.5	2,308.5	2,142.8
Nga e cila :			
Industri	503.5	540.8	364.6
Bujqësi	39.1	46.2	26.2
Popullata	882.5	1,093.5	1,104.8
Të tjera të paspecifikuara	629.4	628.0	647.2

**Tabela 42 - Mjete te Transportit Rrugor**

	1996	1997
Gjithsej	116,906	126,007
Vetura pasagjerësh	67,278	76,364
Autobusa e mikrobusa	7,612	8,741
Kamiona e kamionçina	27,774	30,228
Traktorë rrugorë	2,838	3,192
Motoçikleta e triçikla	7,907	3,694
Rimorkio	3,497	3,788



**Tabela 43 - Transporti Ajror Nderkombetar**

	1995	1996	1997
Shoqëri ajrore	12	12	13
Fluturime	2,817	3,790	3,388
Mallra (Tonë)	585	873	794
Posta (Tonë)	98	143	149
Pasagjerë	213,343	283,010	242,435

**Tabela 44 - Indeksi i Kostos ne Ndertim (ne %) - Tremujori I, 1993 = 100**

Emërtimi	Peshat	Trem IV 1995	Trem IV 1996	Trem IV 1997
Gjithsej (I+II+III+IV+V)	100	151.39	159.66	176.88
I. Shpenzime direkte	73.72	154.85	162.28	186.04
1. Shpenzime materiale(a+b+c)	65.75	142.27	148.14	164.72
a. Materiale ndërtimi	62.77	143.22	149.25	165.7
b. Materiale elektrike	0.98	110.23	110.51	118.69
c. Materiale hidrosanitare	2	127.95	131.74	156.52
2. Shpenzime për pagat	4.03	390.54	432.19	569.88
3. Shpenzime transporti	2.18	111.11	106.03	144.38
4. Shpenzime makinerie	1.75	139.07	141.71	154.31
II. Shpenzime plotësuese	8.11	152.49	160.29	175.44
III. Fitimi i parashikuar	12.27	151.41	153.61	143.37
IV. Ngritje kantjeri	4.7	67.83	114.82	45.61
V. Tatim qarkullimi	1.2	258.68	232.46	482.55

**Tabela 45 - Qarkullimi i Mallrave ne Tregetine e Jashtme - (ne milion leke)**

Viti	Eksport Tregetar	Importi ne vlere	Ndryshimi ne %	Eksp/Imp	Ndihmat
1993	12,500	42,982	-30,482	29	15,355
1994	13,386	51,913	-38,527	26	5,105
1995	18,710	60,312	-41,602	31	5,835
1996	22,001	94,947	-72,946	23	3,113
1997	21,044	92,299	-71,255	22	2,722

The background of the entire page is a dark, textured image of a human figure, possibly a man in a suit, overlaid with a grid of thin, light-colored lines. The figure is positioned centrally, with the grid lines forming a pattern that suggests movement or a specific pose. The overall color palette is dark, with shades of brown, black, and grey, contrasted by the light grid lines and the white text.

UNDP

RAPORTI I ZHVILLIMIT  
NJERËZOR NË SHQIPËRI

1998